

Jeta Arbëreshe

e-mail: jetarbreshe@libero.it - <http://digilander.libero.it/jetarbreshe> (Mondo Italo-Albanese)

Del nga tre muaj - Trimestrale della Minoranza linguistica storica Albanese d'Italia - Eianina / Purçill (Cs- Italia)

Spedizione in A.P. - TAXE PERÇUE - art. 2 comma 20/c - L.662/96, Aut. n. DCO/DC/CS/101/2003, valida dal 06/03/03

Përmbajtja / Sommaire

LETËR DREJTORIT

Ina Arapi (*Arbërishtja edhe për Shqiptarët*) faqe 2

EDITORIALI

Drejtori (*Lexha do ndërruar, Vendimet e Intersinodit botuar*) faqe 3

KORRESPONDENCA NGA KATUNDET ARBËRESHË

Vincenzo Straticò (*Ku vate furnoj Karnivalli i Ungris*) faqe 4

Patrizia Figlia (*Shpitë e ra nëng i duan*) faqe 4

Lucia Cardamone (*Llexha 482 bën dhjetë vjet*) faqe 5

Daniela Moccia (*Libri mbi Kollexhin Korsini*) faqe 5

Rino Greco (*Arbëresh, Kalëndar e Lakre*) faqe 6

TEKSTE POPULLORË NGA KATUNDET ARBËRESHË

Kostandin Bellushi (*Pasjuna e Zotit Krisht*) faqe 7

Zef Beccia (*Vetë të Pashkit*) faqe 7/9

Vittoria Oliverio (*Pirozhi*) faqe 8

Agostino Giordano (*Idjomatizme*) faqe 9

Costantina Florio (*Prallëza e pëlhurës*) faqe 10

Carlo Trupo (*Vjershe*) faqe 10

QISHA BIXANTINE ARBËRESHE

A.G. (*Intervistë zotit Manuell Xhordano – Katundi e Zakonet*) faqe 11

POEZI ARBËRESHE

Demetra G. Schirò (*Guri i Shën Mërisë e Dhitrjes*) faqe 12

Giovanni Pace (*Senaturit Vasil Xhordano*) faqe 12

Cosmo Rocco (*I këndova*) faqe 12

POEZI SHQIPE

Alisa Velaj (*Kufij, Shpirtëra, Aventura, Temjan*) faqe 13

Zhani Korçari (*Arbëreshët*) faqe 13

Çezar Rica (*Shtetësia, Historia e Shqipërisë*) faqe 13

JO VET ARBËRISHT

Pierfranco Bruni (*La presenza futurista nella letteratura Arbëreshe*) faqe 14

NJË PËRRALLË ROMANE

Arbri Roman (*Jeta, Zëmra e Dheu*) faqe 15

STUDIME MBI BOTËN ARBËRESHE

Italo C. Fortino (*Dhimitër Kamarda i shkruan De Radës*) faqe 16

Klara Kodra (*Poetika e Vinçens Belmonte-s*) faqe 17

Laura Smaqi (*Bota Arbëreshe si esenca e Botës Shqiptare*) faqe 18

Baviola Shatro (*Tris(h)tia në kthim të pandalë*) faqe 19/25

Edmond Çali (*Disa vjersha të De Radës me shënime*) faqe 20/ 25

Binard Bilota (*Rrëfimeza e gjindjes çë kulton si zū t'paren hër...*) faqe 21

Zef Chiaromonte (*Viti 1968 dhe depërtimi i nocionit Kosovë tek Arbëreshët*) faqe 22-23

STUDIME MBI BOTËN SHQIPTARE

Fatmir Halimi (*Kosova dhe Letërsia Shqipe*) faqe 24-25

Dhori Q. Qirjazi (*Gjurme të Arvanitishites në greqishten*) faqe 26

Larisa Kaminskaja, Aleksandër Novik (*Shqiptarët e Ukrainës*) faqe 27

RECENSIONI

Bahri Beci (*Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*) faqe 28-30

EMIGRACIONI SHQIPTAR

Paskuale don Ferraro (*Integrimi kishtar e emigrantëve shqiptarë në Itali*) faqe 30

ARBËRISHTJA O SHQIPIA

Vincenzo Cucci (*La contestata Dottrina Altimariana*) faqe 31

LIBRE, REVISTA, CD

faqe 32

Arbërishtja edhe për Shqiptarët

I nderuar z. Giordano, kisha shumë kohë që s'kisha lexuar gjë arbërisht, prandaj dy numrat e fundit të "Jetës Arbëreshe" që m'i dërguat me internet i lexova me shumë kënaqësi. Gazeta juaj është shumë interesante, sidomos për ne që e njohim botën arbëreshe vetëm nga larg. Aty ka shumë gjëra që të futin në mendime. Shumë interesant për mua si gjuhëtare është shkrimi i don Giovanni Giudice-s në nr. 59/2008. Ideja e tij se "kety vremi ty shkruemi si fjasmi të horyt tona" më duket shumë e drejtë. Edhe unë mendoj se arbërishtja e shkruar nuk duhet të largohet shumë nga gjuha që flet gjindja nëpër katunde. Po të ndodhë kështu njerëzit vetvetiu nuk do të kenë më dëshirë për ta shkruar gjuhën e tyre, sepse gjithkush e ka të vështirë të shkruajë në një gjuhë që është pothuajse e pakuptueshme për të. Por ajo çka mund të bëhet është pastrimi i arbërishtes nga italianizmat e shumta, megjithëse kjo duket si e pamundur. Unë vetë i takoj një brezi që e ka përjetuar një gjë të tillë edhe në Shqipëri. Kur isha e vogël përdorim shumë fjalë italisht si *inisiativë, inauguroj, lavatriçe*, etj. Kur u propozuan nga gjuhëtarët shqiptarë fjalët shqipe *nismë, përuroj, makinë larëse* etj. pak veta besonin se këto fjalë do të hynin me të vërtetë në gjuhë. Kurrë nuk e kam besuar se do të arrija të thoja ndonjë ditë *përgatis* në vend të

pregatis, por ja që sot më vjen më mbarë të përdor të parën sesa të dytën. Mund të bëhen përpjekje për të zëvendësuar fjalë të tilla si *mai, bellu, xhunj, xhemellohen, xhemellaxh, finestar, sballjar, pensoj, dhistin, gjudiqime*, etj., të cilat e pengojnë shumë një shqiptar për të kuptuar një tekst arbërisht. Edhe nëse e di italishten nuk arrin ta kapësh menjëherë që *braçarti* ka lidhje me *abbraciarti*. Po të ekzistojë në arbërisht fjalë *qafë* - dhe jam e sigurt që ekziston - pse të mos përdoret dhe atje fjala *përqafoj*? Po kështu mund të thuhet *gaboj* për *sballjar* e *mendoj* për *pensoj*, meqë janë të njohura fjalët e prejardhura prej tyre *gabim* e *mendim*. Gazeta juaj mund të ndihmonte shumë dhe të jepte një shëmbull të mirë në këtë drejtim.

Nga ana tjetër duhet të fillojnë sa më parë përpjekjet në të gjitha shkollat shqiptare në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni etj. që nxënësit që në moshë të vogël të familjarizohen edhe me fjalë e shprehje arbërishte. Pse të mos i dinë edhe shqiptarët e tjerë fjalë të tilla të bukura e të vjetra shqipe si *hera, i sprasëm, shëndreu, delar, mjelsor, njize, ndih* etj. ? Ne sot po mësojmë gjuhë nga e gjithë bota, pse të mos mësojmë që në shqipen e vjetër thuhet *gjillir* për *jetoj*? Në fund të fundit fjala *gjellë* nuk është e panjohur për ne. Ç'punë

na prish të mësojmë dhe nja 100 fjalë arbërisht e disa ndërtime morfologjike e fenomene fonetike që shqipja e sotme nuk i ka? Nëse kjo do të fillonte të bëhej që në shkollë fillore, do ta lehtësonte shumë komunikimin e shqiptarëve me arbëreshët. Dhe kështu më së fundi do të arrinin të hiqnin dorë edhe nga ai zakoni i keq i "përkthimit" të De Radës nga shqipja në shqip, zakon që ju me shumë të drejtë e kritikoni në gazetën tuaj. Do të kishim mundësi që t'i këndonim e shijonim edhe këngët e bukura arbëreshe.

Arbërishtja mund të ndihmojë edhe për ta pasuruar gjuhën letrare shqipe. Shumë bukur do të ishte sikur të arrinin të rigjallëronim fjalët me prapshitesa zvogëluese, të cilat gjuha shqipe moderne i ka humbur. Në poezinë shumë të bukur "Kalimera e Natallvet" nga Bernardo Bilotta në nr. 60/2008 ka shumë fjalë të tilla të bukura si *natez, shpellez, duarzit, këmb'zit*.

Më e rëndësishmja është se do të arrinim atë që na e do zëmbra të gjithëve: t'i siguronim arbërishtes, këtij thesari të pazëvendësueshëm gjuhësor e kulturor për të gjithë shqiptarët, një jetë të gjatë e të lumtur!

Duke ju uruar gjithë të mirat!

Dr. Ina Arapi

Lektore e gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës

Da molto non leggevo qualcosa di arbëresh e Jeta Arbëreshe mi ha molto interessato e fatto riflettere. Ha ragione don Giovanni Giudice quando dice: "Dobbiamo scrivere come parliamo nei nostri paesi": l'arbëresh scritto non dovrebbe differenziarsi troppo dall'arbëresh parlato; ma quello che si può fare è ripulire l'arbëresh dai molti italianismi. Anche in Albania abbiamo avuto lo stesso problema e i linguisti sono corsi ai ripari. Gli italianismi, poi, non aiutano gli albanesi a capire il testo arbëresh: lì dove esiste il corrispettivo arbëresh va usato al posto dell'italianismo. E Jeta Arbëreshe può fare molto in questo senso. Sarebbe augurabile, poi, che nelle scuole albanesi d'Albania, di Kosova e di Macedonia i ragazzi cominciasero a familiarizzare con parole ed espressioni arbëreshe, che fanno parte della nostra lingua albanese antica. E così la finiremmo col tradurre il De Rada dall'albanese in albanese, e potremmo cantare e gustare i bei canti arbëreshë. L'arbëresh - questo tesoro insostituibile linguistico e culturale per tutti gli albanesi - potrebbe così arricchire la lingua letteraria albanese, incominciando magari dai suffissi diminutivi, che l'albanese moderno ha perso (B.Bilotta usa molte parole simili nei suoi scritti). Facendo così, assicureremo una vita più lunga all'arbëresh stesso. (Redaz.)

Jeta Arbëreshe



Trimestrale di Cultura
e Informazione Arbëreshe,
in Italia e nel Mondo

Revistë tremujore e Shoqatës Kulturore "Jeta Arbëreshe", Purçill/Eianina (Cs-Italia)

Drejtor përgjegjës: **Agostino Giordano**

Drejtori, Redaksi dhe Administratë/Direzione, Redazione, Amministrazione: via G. Marconi, 30 - 87010 Eianina-Purçill (Cs-Italia) - Tel. 0981-32539 / 340-8452364; e-mail: jetarbeshe@libero.it - <http://digilander.libero.it/jetarbeshe>
Projekt grafik/Progetto grafico: Vittorio Giordano
Ku shtypet/Stampa: AGM srl, Telefax 0981-491957 - e-mail: info@agm.calabria.it

Abonime/Abbonamenti: (4 numeri): Italia €20 (Institucjona €40), Europa e America €30

Ku dërgohen turrësht/Versamenti: sul ccp. n. 12994760, intestato a: Associazione Culturale "Jeta Arbëreshe" - 87010 Eianina/Purçill (Cs), o sul libretto bancario nr. 0015524 - iban IT26F088728067000000009621 - della Banca di Credito Cooperativo della Sibaritide-Spezzano Albanese - 87012 Castrovillari (Cs)

Regjistrim/Registrazione: Tribunale di Castrovillari (Cs), nr. 4/2001 del 28-12-2001

Artikuj, Dorëshkrim e Fotografji, edhe ndëse s'botohen, nën gjepin paprë /Articoli, Manoscritti e Foto, anche se non pubblicati, non si restituiscono

Drejtorja nënq është përgjegjëse për përmbajtjen e artikujvet të nënshkruar/La Direzione non è responsabile del contenuto degli articoli firmati

Gjithë të drejtat të rezervuara / Tutti i diritti riservati

Lexha do ndërruar, Vendimet e Intersinodit botuar

Simbjet Lexha 482/99 - ajo që ndihën Minoritetet Etno-gjuhësorë të Talljes sa të rrojën, me të folmet e zakonet e tyre - bën dhjetë vjet. Mirë, kjo Lexhë do ndërruar. Arbërishtja (= të folmet e Arbëreshëve) - për të rronjë vërtet - ndë skollë do mësuar menatet, tek orari kurrikullar, si italishtja e matematika, jo pas mjezditës; e do mësuar te gjithë skollët arbëreshe e gjithë nxënësve arbëreshë: me dashjen o pa dashjen e prindërve. E mësonjësit - arbëreshë e me titull - kanë ' jenë mundësisht të katundit: sepse do mësuar e folmja e katundit. Po skollat e katundevet arbëreshë kanë ' jenë të bashkuara njera me jetrën, krei i skollës ka të jetë arbëresh e profesorët kanë ' foljën arbërishten, sepse, si thot Lexha, s'ka të jipet vet "mësim i arbërishtes", po Arbërishtja ka të jetë "strument mësimi" i të tjerave materje ("strumento di insegnamento", Lexha 482/99, art.4). E pra Universitata e Rai-Tv publike kanë ' ndërrojën trû: e para ka të kuptonjë se kjo Lexhë ruan Arbërishten, jo gjuhën shqipe; e dija ka t'i hapënj dyert, me dashje o pa dashje, programevet në gjuhë arbëreshe. Dhe turresët e kësaj Lexhë kanë i venë atyreve që shërbejnë me të vërtetë për të mirën e Arbëreshëve dhe të Arbërishtes. Arbëreshët duan të drejtat që ka, për sh., minoriteti gjuhësor tedesck i Bolxanit: jo më shumë e jo më pak. Do të thomi, me këtë, se Lexha 482/99, mjerisht, ku është aplikuar e ku jo. Po Tallja është një Republikë e vetme? E Lexhat e Republikës s'janë aplikuar te gjithë territori nacional? Atëherë pse, për Minoritetet e veriut, Lexha 482/99 aplikohet (e turresët arrëjën me qerren) dhe për Minoritetet e jugut s'aplikohet (e turresët arrëjën me trastën)? Minoritetet s'janë gjithë të njëjta? E pse Minoriteti Arbëresh - ai që numëron më gjindë se gjithë - është trajtuar kështu lik? Kush e ka zgjidhur?

Simbjet Eparkia bixantino-arbëreshe e Ungrës bën nëndëdhjetë vjet. E duan tëhelqur gjë kunde: jo nëndëdhjetë, po sadopak nëndë. Duan nomëruar ata që e ëndërrtin, e dishtin dhe e nderuan, po edhe ata ç'e kundërshtuan dhe e shajtin. Do mbëshuar puna e peshkopëvet ç'u ultin mbi thronin e Ungrës: sa bënë për ritin bixantin e sa bënë për gjuhën arbëreshe. Pas 90 vjetsh ka lerja e kësaj Eparkí, nëng kanë ikonostazin vetëm 2 qysha (ndër 27 famullí): ajo e Fermës e ajo e Vakarcit. Pas 45 vjetsh ka Koncili Vatikan II, qyshat ku nëng thohet mesha arbëreshe janë më se dy. Shumë më se dy! Pse kështu? Pse u preferua më ikona se gjuha, më lëkura se zëmra? Vjen me thënë se shkopi i Peshkopëvet shërbei aq sa fare. Pra kanë bëhen kundet me dy Sinode: Sinodi eparkiall i vitit 1995, që adhë do aplikuar, e Sinodi Intereparksiall i Grotaferratës i vitit 2006, të t'cilit u buartin dhatat: edhe s'u botuan Direktivat! Ku e fshehtin Intersinodin?

Drejtori

Quest'anno, la Legge 482/99 - quella che tutela la sopravvivenza delle Minoranze Etno-linguistiche d'Italia con le loro parlate e tradizioni - compie dieci anni. Bene, questa Legge va cambiata. La lingua Arbëreshe (= le parlate arbëreshe) - per vivere concretamente - a scuola va insegnata la mattina, nell'orario curriculare, come l'italiano e la matematica, non dopo pranzo; e va insegnata in tutte le scuole arbëreshe e a tutti gli alunni arbëreshë: con, o senza, l'assenso dei genitori. E gli insegnanti - arbëreshë e con titolo - devono essere possibilmente del paese: perchè va insegnata/salvaguardata la parlata del paese. Ma le Scuole dei paesi arbëreshë devono essere accorpate l'una all'altra, il dirigente deve essere arbëresh e i professori devono parlare l'arbëresh, perchè, come dice la Legge, non si deve dare solo "insegnamento di lingua arbëreshe", ma la lingua arbëreshe deve essere "strumento di insegnamento" delle altre materie. E poi Università e Rai-Tv devono cambiare testa: la prima deve capire che questa Legge tutela la lingua Arbëreshe, non la lingua albanese d'Albania; la seconda deve aprire le porte, volente o nolente, a programmi in lingua arbëreshe. E i soldi di questa Legge devono andare a quelli che lavorano davvero per il bene degli Arbëreshë e della Lingua Arbëreshe. Gli Arbëreshë pretendono i diritti che ha, per es., la minoranza linguistica tedesca di Bolzano, nè di più nè di meno. Vogliamo dire, con ciò, che la Legge 482/99, purtroppo, dove è applicata e dove no. Ma l'Italia è un'unica Repubblica? E le Leggi della Repubblica non vengono applicate su tutto il territorio nazionale? Allora perchè, per le Minoranze del nord la Legge 482/99 si applica (e i soldi arrivano col carro) e per le Minoranze del sud non si applica (e i soldi arrivano con la bisaccia)? Le Minoranze non sono tutte uguali? E perchè la Minoranza Arbëreshe - la più numerosa - è trattata così male? Chi l'ha deciso? Quest'anno l'Eparchia bizantino-arbëreshe di Lungro compie novant'anni. E vanno tirate alcune somme: non novanta, ma almeno nove. Vanno contati quelli che l'hanno sognata, voluta e onorata, ma anche quelli che l'hanno contrastata e vilipesa. Va pesato il lavoro dei vescovi che si sono seduti sul trono di Lungro: quanto hanno fatto per il rito bizantino e quanto hanno fatto per la lingua arbëreshe. Dopo 90 anni dalla nascita di questa Eparchia, non hanno l'iconostasi solo 2 chiese (su 27 parrocchie), quella di Firmo e quella di Vaccarizzo. Dopo 45 anni dal Concilio Vaticano II, le chiese dove non si celebra la messa albanese sono più di due. Molte più di 2! Perchè così? Perchè si è preferita più l'icona che la lingua, più la pelle che il cuore? Vuol dire che che il bastone dei vescovi ha lavorato tanto quanto niente. Poi si devono fare i conti con due Sinodi: il Sinodo eparchiale di Lungro dell'anno 1995, che ancora dev'essere applicato; e il Sinodo Intereparchiale di Grottaferrata del 2006, del quale si sono perse le tracce: ancora non sono state pubblicate le Direttive. Dove l'hanno nascosto l'Intersinodo?

Ku vate furnoj Karnivalli i Ungris?

Vincenzo Straticò

ka Ungra (Cs)

E chà!... Ungir Karnivalli duket se virteta u furnua. O më mir, qindroj vet se kem divirtiremi, pir forcë, ma të pënxomi, fare! Stimoli pir tradicjunit është ‘ndutu i znobartur, më duket mua. Atë çë vivirti xheneracjuna ime, o çë vijin mbjatu apriesu, ishin mote të mir! Kostumet, rapresentaciunit (e gjindja i mban angora mend), u zgavalartin strumende e këndime e vjershe të vjetër, harëa të njëjtim e të zgjojim storjen tònë, të mbishkarjim gjith katundin, jàn shurbise llargu.

Gjindja çë arrivonej ka gjith anit t’Italisë, studjozrat të tradhicjunavet e t’etnomuzikoloxhisë, ndë vijin pupani, gjëjin vet një katund si tjetër të Kallabrjes me mashkare të rranxhartura, një tratër çë bën rrëmür me gjind ka jashti sipir pjot pokondri, grupe të stramballatur veshur si kàu-boi çë bëjin (sembri me pokondri) balli-di-gruppo e një xhurì me hundin e ngrëjtur e çë jep vote ndë buste të mbullijtura.

Jo, nëng vete mir këshù! Kem zgjofemi! SVEGLIA!! (jo ajò e shkreta t’Ungiris pir 35 vjet, nxjë maj!...).

U xura shum ka kush ish më i madh se u, e jam orgoglioso, e ringraxjar t’Inzot pir ktë.

Po i vura kufi se, kur këndomi me shokt tim vjershet e ajret tonë, gjindja e katundit batirin sembir duart e ndien sapurin e vjetir delle-affascinanti-sonorità të motit kur rrifef pexhu, ma mund jetë rrifef më mir. Jan vitra çë Ungir, ndë karnivall, ngë shifet një grua o vashiz o kratúr veshur me mbrolat arbëresh. Kem të kemi gjith turp! T’jert katunde ngë na shofjin fare. Ishim të pàrt e qindruam të llurtrimt. Ma të pàrt çë kan ken turp jan le Istituzioni. Civili e Religiose.

Fanatkra e incompetenti, ndi kit katund i shkret, riskjarjin (anxi jan po t’e bëjin se bun’e vete pirpara ai nëm çì na vùn ka shum mot. Donja se t’adunarshin pir ktën çë jam e thom.

Mund’jët se rreaxhirmi? Kush e di! Mund jetë! Forsi kish të bëjim ndënjë magari, ma asije e dreqët virteta. O, forsi, djalli ngë hin propju fare ndir këtë shurbise. Forsi himi një çik gjith, forsi ftesmi gjith. E jam e zë ka u çë shkruanj.

Eh già!... A Lungro il Carnevale sembra proprio esaurito. O meglio è rimasta solo la voglia di divertirsi per forza; ma idee no, non ce ne sono! Lo stimolo per la salvaguardia delle tradizioni mi sembra che venga addirittura snobbato. Quelli che ha vissuto la mia generazione, ed alcune successive, erano tempi! E che tempi! I costumi, le rappresentazioni (rimaste ancora famose), la riscoperta di strumenti e canti tradizionali, l’orgoglio di conoscere e rinverdire la nostra storia, il coinvolgimento di tutto il paese, sembrano cose lontane. La gente che arrivava da tutte le parti d’Italia, gli studiosi di tradizioni e di etnomusicologia, se tornassero, troverebbero ora solo un comune paese della Calabria. Tante maschere arrangiate, qualche rumoroso trattore che squallidamente fa le veci di un carro, balli di gruppo strampalati di persone tristemente vestite da cow-boys e una impettita giuria (nominata da chi?) che assegna voti in busta chiusa.

No, non va bene così! SVEGLIA!! (non quella famigerata di 35 anni, non sia mai!...). Io ho imparato tanto da chi era più grande di me e ne sono orgoglioso, e ringrazio il Cielo per questo. Mi accorgo, però, che quando cantiamo i nostri vjershë e le nostre arie con i miei amici, la gente del paese applaude sempre e riassapora le affascinanti sonorità di un tempo in cui si stava peggio, ma forse si stava meglio. Sono anni che a Carnevale, a Lungro, non si vede una donna, o ragazza, o bambina vestita con il nostro costume tradizionale. Vergognamoci tutti quanti! Gli altri paesi non ci vedono proprio. Eravamo i primi e siamo rimasti ultimi. Vergogna!! Ma le prime a doversi vergognare sono le Istituzioni. Civili e Religiose. Fanatici e incompetenti, in questo “maledetto” paese, rischiano (anzi, sono a buon punto) di far perdurare la maledizione in cui siamo incappati da troppo tempo ormai. Vorrei tanto che si rendessero conto di ciò.

E’ possibile reagire? Chi lo sa! Forse! Forse bisognerebbe fare qualche esorcismo, ma di quelli veramente efficaci. O forse il diavolo non c’entra in tutto questo. Forse c’entriamo un po’ tutti quanti, forse abbiamo tutti una parte di colpa. E comincio da me che sto scrivendo.

Shpitë e rea nëng i duan

Patrizia Figlia

nga Kajverici (Cs)

Ndë të shtatin e marsit bëri 4 vjet çë qe frana Kajveric. Bertolasi arruri ndë të gjashtin e marsit të thoj se mot e parë japin shpit gjithve. Vjet kish ardhur pameta e kish konsenjartur xonën industrjalle, ma edhe mosnjeri shurban atje. Gjith ata çë ka të kenë një llok ndë kapanun ngë zunë e shurbien e edhe marrin muaj për muaj solldet për se ngë gadhnjejnë më. Ngë dihet pse qe bën çerimonja uficjalle e pra ngë qenë më dhënë llokallet.

Kostrucionja e shpive ndë Qaneta vete përpara e ata çë shpinë atje nëng e duan ngë qenë maj gjeqjur, kauza e ktire kundër kostrukcionës e re vete përpara. Protecionja Çivile e istitucionat thonë se gjith kajvericiotët dejin këtë katund i ri, ma ki shurbes nëng është vurtet. Vet kur japin shpitë të ktij katundi adunaren se gjimstit e kajvericiotëve atje nëng venë e rrin. Thanë se ki katund ka të ishë një modell rikostrukcionje: kur japin shpitë adunaren se është një modell, manjë modell fallimendar.

Lo scorso 7 marzo è stato il quarto anniversario della frana di Cavallerizzo. Bertolaso, come promesso, è venuto a Cerzeto il 6 marzo per assicurare che, nonostante i ritardi, l’anno prossimo saranno consegnate le case a tutta la popolazione di Cavallerizzo. Anche l’anno scorso era venuto per la consegna della zona industriale, ma nessuno ancora vi lavora. Tutti coloro che avrebbero dovuto ricominciare la loro attività, bruscamente interrotta dalla frana, non hanno ancora avuto gli spazi nei capannoni. Questi ultimi, intanto, continuano a percepire i soldi per “il mancato guadagno”. Non si conosce il motivo per cui, dopo la cerimonia ufficiale, i locali non siano mai stati consegnati. La costruzione in località Pianette avanza, anche se coloro che non la vogliono non sono mai stati ascoltati e il loro ricorso al T.A.R va avanti. La Protezione Civile e le istituzioni continuano ad affermare che la decisione di delocalizzare è stata condivisa da tutta la popolazione, ma questo non corrisponde al vero. Quando ci sarà la

(ec te faqja 8)

Lexha 482/99 bën dhjetë vjet

Shkuan dhjetë vjet çëkur patim lexhen 482. Çë ndërroj? Ç' u bë? U bënë projekte sa të mirrçin tures çë kish të beznarjin sa të bëhej gjë të mirë për katundet arbëreshë; kish të bëhej gjë sa të mos bin'e birej gjuha jonë; kish të bëhej gjë sa të bin'e kuptojn gjithë arbëreshët se zakonat tona, gjuha jonë, historia jonë, janë shurbise çë kam vjoni me mall e dashuri, pse janë gjithë pasuria çë kemi. Pa ato ngë jemi faregjë, ngë jemi mosnjeri, bëhemi njerez pa ëmer e pa faqe. Turrest arvuuan, parë më shumë e pra ngaherë më pak. Gjithë katundet arbëreshë kanë një spurtjel gjuhësor, kanë ëmërat e udhave të shkruajtur arbërisht e lëtisht, u shkruajtjin libra, u mbaitin konvenje e manifestaciona, u bënë festa, filmëra e CD muzikorë, u lenë asoçiaciona, u bënë kursëra te skollet sa të mbësohoj gjuha arbëreshe atyre krjaturave çë prindët ngë do t'ja e mbësontjen më. Gjë u bë, po gjindja ngë ndërroj krie. Gjuha jonë nëng ë më gjuha e parë për djalërat çë lehen, është një gjuhë e huaj e, për këtë, ë më mirë se mbësohet ngllizi! Ka më utull! Bëmi festen e Halloween e pra nëng dimi pse mbami mend të vdekurit te moj i fjojarit; çë kam'e bëmi? Important është se për një ditë ngë bëmi skollë e ngë vemi e shurbemi ! Drejtori i *Jetes Arbëreshe* ka shumë mot çë më thoj sa të shkruaja gjë, po u ngë kisha ngulli, ngë më vej, e ngë më vini nxe faregjë të mirë sa të shkruaja. Nëng mundet të shihen tjeret çë duan se gjithë atë çë jemi ka të biret , se i ndjet si turp sa të thonë se janë arbëreshë (po nëng ë më turp të dhinehomi atë çë jemi e katanandërat tanë?), se ng'i fjasen gjuhen të bilëve pse ajo ngë vlen, se bënjen gjë vetim ndë mënd mbjonjen kushelët, po zëmren e kanë gjëtkë. Mos e kini me mua ndë fjas kështu, u thom vetim atë çë mendonj e çë vjen ka atë çë shoh e atë çë gjegjinj. Arbëresht nëng do të jenë më arbëreshë e ng'e kuptonjen se kështu janë dhestinartur të biren si buhoj çë ajri shprishen për dheun.

Lucia Cardamone

ka Shën Sofia (Cs)

Sono passati dieci anni da quando abbiamo avuto la legge 482. Cos'è cambiato? Cosa si è fatto? Sono stati fatti progetti per ottenere i soldi necessari a realizzare qualcosa di buono per i paesi arbëreshë, si doveva fare qualcosa per impedire che la lingua si perdesse, si doveva fare qualcosa per far comprendere a tutti gli Arbëreshë che le nostre tradizioni, la nostra lingua, la nostra storia sono cose che dobbiamo conservare con amore e passione perché rappresentano tutta la ricchezza che possediamo. Senza di loro non siamo niente, non siamo nessuno, diventiamo persone senza nome e senza volto. I soldi sono arrivati, dapprima di più e in seguito sempre di meno. Tutti i paesi arbëreshë hanno uno sportello linguistico, hanno il nome delle strade scritto in arbërisht e in italiano, sono stati scritti libri, si sono tenuti convegni e manifestazioni, si sono realizzate feste, film e CD musicali, sono nate associazioni, si sono tenuti corsi nelle scuole per insegnare la lingua arbëreshe a quei bambini i cui genitori non gliela vogliono più insegnare. Qualcosa si è fatto, ma la gente non ha cambiato testa. La nostra lingua non è più la lingua madre per i bambini che nascono, è una lingua straniera e, perciò, è meglio imparare l'inglese! È più utile! Facciamo la festa di Halloween e poi non sappiamo perché ricordiamo i defunti nel mese di febbraio: che importa? L'importante è che per un giorno non si faccia scuola o non si lavori! Il Direttore di Jeta Arbëreshe da molto tempo mi sollecita a scrivere qualcosa ma io non ne avevo voglia, non mi andava e non mi veniva in mente niente di buono da scrivere. Non è facile vedere gli altri che vogliono che tutto ciò che siamo si perda, che provano quasi vergogna a dire che sono Arbëreshë (ma non è più vergognoso rinnegare ciò che siamo e i nostri antenati?), che non parlano la lingua ai figli perché essa non serve, che fanno qualcosa solo se possono riempirsi le tasche ma il cuore l'hanno altrove. Non abbiatecela con me se parlo così, io dico solo ciò che penso e che deriva da ciò che vedo e che sento. Gli Arbëreshë non vogliono più essere Arbëreshë e non capiscono che così sono destinati a perdersi come la polvere che il vento sparge per il mondo.

Prezentaciona e librit mbi Kollexhin Korsini

Daniela Moccia

ka Shën Benedhiti (Cs)

Të dial 1 të muajin e marsit Shën Benedhit qe prezentartur libri çë shkruajti Maria Franca Cucci mbi Kollexhin Korsini me titullin: "Il Pontificio Collegio Corsini degli Albanesi di Calabria. Evoluzione storica e laicizzazione", i publikartur nga editori Walter Brenner. Kjo prezentacionë qe organizartur nga shoqata "Pro loco", bashkë me famulinë e katundit dhe shoqata e pensionatevet e u mba tek një sallë të pëllasit ku qe Kollexhi Korsini. Pas të falat e arkimandritës Donato Oliverio mori fjalën Italo Elmo çë tha se gjeti orixhinallin të Bullës "Inter multiplices". Apriasua foltinë prevesur Italo Sarro e prevesur Italo Fortino. I pari foli nga problemet çë u lenë mbrëndë kollexhin çë kur gjëndej Shën Benedhit e çë qenë dhopu edhe Shën Mitër ku qanu qanu kollexhi libori karakterit orixhinall; i diti foli nga kontributi çë kollexhi dha identitetit arbëresh e nga lidhjet ndër eksponentet të Illuminizmit dhe të Romantizimit me esponentet të kollexhit. Kjo skollë jipij skollenjevet një formacionë jo vetëm fillosofike e teolloxhike,

po më se më pas reformat çë bënë peshkopet Bugliari e Bellusci, ndë këtë kollexh mund hij kush do të kish një formacionë kllasike e jo vetëm fillosofike e teolloxhike. Pas profesoresha Maria Franca Cucci dhopu të falat e falendërimet proponirti të bi t'e lehej ndë pëllasin e kollexhit, çë bashkë me qishën e Shën Mërisë të Bo'konxijit janë pasuri istorike pë Shën Benedhitin, një muze istorik, kulturall e besimtar. I llurtmi, pas editorit Walter Brenner, qe zoti Giovanni Cassiano çë foli nga mësimi i këngavet liturgjike ndë kollexhin Korsini ku u le një traditë e vendit çë adhe gjëndet ndë ca katunde arbëreshë. Apriasu kori i Strigarit këndoç ca kënga besimtare e popullore. Shumë qenë njerëz çë muartin pjesë ndë këtë prezentacionë e ndë mest tjerat edhe zonja Anna Rodotà trashgimtar e familës Rodotà çë shërbeu për të lehej ki kollexh.

Arbëresh, Kalëndár e Lakre

Rino Greco

kana Munxhufunit (Cb)

Munxhufun, ka skolla, bashk ma turet aktivitate që bëhen, simit isht dhe një vend për arbreshin. Një shurbëtir që u zëh fi kur u hap skolla e që ndurisën gjithë vitin.

Ma profuret Rino Greco e Gabriella Fiocco, pas misdits, javet janë ma gjithë kulluret...

Java a kuqe për gjuhën arbresh, java a gjelber për pillën, java a bardhë për traditë, e shumë ture kulture për storje, ekonomia, feste, kënkët...

Kriaturet ta skollës bërën një abetar, shkrujtën poesiet, bërën rëtratet ta horës e ta vendëvet më të bukret ta nanish e ta njëve moti, ma kulluret që dujtën.

Kalëndari arbresh

Bashk ma këto inicjative Pro Lokja ta Munxhufunit bëri një Kalendar-Ricëtar 2009, ma rëtratet ta të sprasmjet kriaturet që u lehën ka hora: nga një muj, një kriatur pishkuriq bashkë ma një lakër që duprohet ka hora: vasalikota, rrigani, rozmarini, rushku, hitza, dafni, etj...

Ka Kalëndari janë edhe poesiet ta skollës ta Munxhufunit që flasnjen për lakret.

Vasalikota një herë ishi ka gjithë shpitë, anjari kishi një kup ku a mbilli për të ziji e për t'a vuj ka pumdorët, ka muj gushtit. Kur buret arenjen mbrëmnet kana përjashta nëng harojën kura ta bijën ka hora. Duprohshi edhe për aftën ta mivet e pihshi kur një nëng ishi mirë e kishi shumë fane.

Ma zëmren ta vaps veshi për rrigan ka stërporet. Ka trata bëshshën mace mace e lidshën koç për gjaposhit e vuhshën ku nëng ishi lihari. Kur rrigani ishi i thati, sdërmohshi ma duret e vuhshi ka kupi vitrjesh për të vlohshi për gjithë vitin. Rrigani vuhshi ka "panmolla", ka pumdorët nxallat, e duprohshi edhe për të mbujohshi kolla.

Një kënkë ta Munxhufunit, që flet për vajzetet, thotë:

"...e Munxhufuni gun shkurtur janë / e vinjën era mbë rozamarinë". Rozmarini ishi ka gjithë kopshtet, e nëng bëshshi misht si nëng ishi. Duhshi për të mirjen erën shqënt ka sënduqi bashk ma llavandën.

Munxhufun, gjahë ka Greçja, thritet Dafne.

Dafni ishi një lakër shumë a haristisura kana Shejtiti Apol që a kanjoiti për Ninfe për t'a mbuloi kana njetër Shejt që dish t'i bëj të keqin e që ka ai mot thritet ashtu.

Dafni Munxhufun vuhet ka shumë së ngrënjure e ka qiqret ma rër bashk ma skorçet ta narënxës.

Arbëreshit ta gjithë Italljes hanjën burajna bashk ma turet lakre pse vete mirë për të vashohet ethja, për kollën ka dimri e kur një isht keq. Munxhufun gjëndet ka shumë vende edhe ndë pak gjindë a njohënjën e a kaponjën.

Më shpejt që arej dimri ka gjithë shpit kish të nxirshi kamnea kana vatrës. Bëshshi një macë ma rushku, lidshi ma një tërkuz e një hipi ka pinxhet e një riji posht. Hipshi e kallohshi rushku për të ratohshi kamnea.

Shum të mirë ishën, e jan edhe nani, sparënjt rushku që hahen si lakre o vuhën ka uthulla o ka vajt për të hahen ka dimri.

Ka Vëjillja ta Natahëvet bashk ma peshk e turet lakre hahet karduni ka furi ma tul, djathë.

Pleqt, njëve moti, mirjën një kardun i madhi, vujën lulzen ka flaka e a vujën ka ndonjë gavër ta shpisë. Manatnen pas, ndë nxiri lulzën papë, ishi një bukur sinj.

Kur nëng ishen shumë sollde ka shpia, gratë vejen për lakre e çikorjet ishën ka gjithë an. Pak mish e peshk e shumë lakre, e ishën gjithë të bardhe e të kuqe; nani imi gjithë keq.

A Montecilfone a scuola, insieme ad altre iniziative, quest'anno c'è anche posto per la lingua arbëreshe. Un lavoro iniziato all'apertura dell'anno scolastico e che verrà portato avanti fino alla fine.

Con i docenti Prof. Rino GRECO e Gabriella FIOCCO, nel pomeriggio, le settimane acquistano colore...

La settimana rossa per la lingua, quella verde per il bosco, quella bianca per le tradizioni e altrettanti colori per storia, economia, feste e canti della tradizione....

I ragazzi hanno realizzato un abbecedari illustrato, hanno composto poesie, hanno dipinto foto del paese attuali e del passato con i colori della loro creatività.

Il Calendario arbëresh

Oltre a queste iniziative, la Pro Loco Munxhufuni ha realizzato il Calendario-Ricettario 2009, con le foto degli ultimi 12 nati nel paese; ogni mese un bimbo nudo posa con le erbe aromatiche in uso nel paese: basilico, rosmarino, ruscus, ortica, alloro...

Nel Calendario sono state inserite inoltre le poesie in rima scritte dagli alunni della scuola primaria che parlano delle erbe.

Il basilico un tempo era presente in tutte le case, ciascuno ne seminava in un vaso da utilizzare in cucina e per la salsa di pomodori preparata in agosto. Gli uomini la sera che tornavano dalle campagne non dimenticavano mai di portarne un po'. Veniva anche adoperato per combattere l'afra e si usava il decotto per curare l'ansia.

Nelle giornate più calde si andava a raccogliere l'origano nelle terre incolte. Si realizzavano mazzetti che venivano appesi a testa in giù nelle cantine all'ombra e al fresco. Quando l'origano era completamente secco veniva sfregato con le mani e poi conservato nei barattoli di vetro per tutto l'anno. L'origano condivide il pane inumidito con acqua, l'insalata di pomodori e si usava come rimedio naturale per la tosse.

Un canto di Montecilfone parla delle ragazze del paese:

"... e Montecilfone le ragazze hanno le gonne corte e profumano di rosmarino".

Il rosmarino si trova in tutti gli orti, non esiste arrosto senza di esso. Veniva usato anche per profumare i panni all'interno delle baule, insieme alla lavanda.

A Montecilfone, come in Grecia, l'alloro si chiama Dafne.

L'alloro era una pianta molto amata dal dio Apollo che per proteggerla da altri dei che volevano farle del male, l'ha tramutata in una Ninfea chiamata da allora Dafne.

L'alloro a Montecilfone si usa per molte ricette e nei ceci cotti al fuoco in sabbia di mare con l'aroma della buccia d'arancia.

Gli arbëresh di tutta Italia conoscono la borragine e la consumano mista con altre verdure perché ha poteri per l'abbassamento della febbre, per alleviare la tosse e per stato di malessere generale.

Prima che arrivasse l'inverno in tutte le abitazioni si procedeva alla pulizia del condotto del camino. Si raccoglievano rami di ruscus, si legavano con una fune lunga e si passava il mazzo realizzato nel camino per grattare via la fuliggine.

Molto buoni sono gli asparagi del ruscus, consumati come verdura o come sottaceti o sottoli per i pasti invernali.

Durante la Vigilia di Natale insieme al pesce non mancavano mai i cardi al forno gratinati con la mollica di pane e il formaggio.

Gli anziani usavano il cardo anche per presagire eventi, ne bruciavano con la fiamma il fiore e lo ponevano in una fessura esterna della casa, se il mattino dopo il fiore era risbocciato era di buon auspicio.

Quando in casa: mancava denaro, le donne andavano sovente alla raccolta delle cicorie. Con poca carne e pesce e molta verdura tutti scoppiavano di salute, invece ora siamo tutti malaticci.

Pasjuna e Zotit Krisht

(mblodhi) **dhjaku Kostandin Bellushi**

ka Pllatni (Cs)

Mallku më i ligu ndër suldet
i suli e i ndëndi një shkafet,
aq ja ndëndi fort e dal
se Krishtit ju dhëmb dhe nj'gangall;

Shën Pjetri me shpatë ndër duar
tufti veshin ma ja muar,
ndënj e foli Zoti Krisht
tha "vëri veshin tek a kish",

ja vu mirë e nëng ju ngjit ;
Shën Pjetri tue klar,
Shën Maria ja kumbanjar,
Tha: "Qetu, Pjetar, mos klaj
se Biri im u t'purdunar";
Zoti Krisht, kur doj t' vdini,
vate nd'kopshtit e thoj racjona
mos t'a vunxhoni "Ila tantaciona";

Dishipulit ishan e flajan nd'atë jetë
Zoti Krisht m'i thirri dreq,
thë: "Ngrëthi, Dishipul, mos flani më
se vijan Judhizit e na zën";

Porsa Dishipulit u zgjuan
dreq Judhizit arrivuan,
Tën Zon a lidhtin këmbsh e duarsh
te dera Pon' Pillatit a pres'ntuan;

Qelltin ka Pillati t'a librar

ai më fort a kundunar,
a xu Zonja Shën Mari
dreq vu vellin e zi;

Vat m'klisë nd'gjegjini meshë
shëjta meshë me dillicjuna,
kur duall shartoj
ju parpoq Shën Matallena;

Tha: "Ç'ke, oj Zonja Shën Mari,
e vet sembri me lot ndër si"?,
tha: "Ç'kam kem, Shën Matallena,
se bora Birin e tim";

U për t'pár nëng a pé
për t' gjegjurit e a gjegja,
se ish ka dera Pon' Pillatit
lipi nj'pikarr uji nj'herë

e i dhan ut hull e kamné;
u nis a Zonja Shën Mari,
tue klar me lot ndër si
dhe me vellthin e zi.

Vat ka dera Pon' Pillatit
tha: "Bir, bir, hapam ktët derë
se do të t' puthinj u tri herë".

"Mëmë, mëmë, u s'mënd a hap
se jam i lidhur këmbsh e duarsh,

po t'pregar t'vesh ka mjeshtarat furxhar
ç'jan e bëjan gozhdat për mua
mos t'i bëjan t'trasha e tglata
se duar e t'ima jan dillikata";

U nis a Zonja Shën Mari
tue klar me lot ndër si
dhe me vellthin e zi
vat ka mjeshtarzit furxhar
tha: "Oj mjeshtarzit furxhar,
u nj' fjalaz ju pregár, se jimi e bëni
gozhdat për Birin tim,
mos ja bëni t'trasha e t'glata
se duart e tij jan dillikata";

U përgjegji furxhari plak:
"S' kam nde hekur nde acar
mos kish t'ja bënja shtatë kandar".

A gjegji Zonja Shën Mari
e m'i ra tri herë zalí,
hëna e dialli m'u nxi;

I Jati, i Biri, Shpirti Shëjt
nani njetër herë
njera ka jetra jetë. Amin.

Vétë të Pashkit

(mblodhi) **Zef Beccia**

nga Kazallveqi (Fg)

*Njere ndo një vjet bë, ta ki katund, natna
të Shtun i Madhë, pas çë zgjidhëshin
kumborot, pë një tradhëcjuna e vjetra,
shumë veta tucëlloin ta derët t'mikëvet e
t'gjirivet, lipin vétë pë t'fëstëxhoin
Pashkët, e këndoin këtë kanxunë. Pë
t'rúanj, pë t'dërgonj tjerëvet e pë t'bë ta
vëlenj kjò tradhëcjuna, kjò kanxunë kleti
shkruror pë t' bënë një shurbes i miri. Nani
gjingjrat jan gjithë të ngosta, e ngë
këndonjën më pë t'lipin vétë. Çë mbëkat!
Këndoin a kështu.*

Bukra gjingjra, mbrëma mirë e Pashkit a
[mirë,

erdhen të këndoin gjiritë t'juajt,
zëmbillni këtë derë e ktò parathillë,
së no rrimi ktù prapa pë një muoj.

U xura ke sod isht të Shtun i Madhë,
nesër isht Pashkit isht a ftët,
u di ke gjithë hani vétë bashkë,
kush papjekur, kush të ziera e mua
masgë.

Këndon kallandrini ta kajolla,
këndon ta glëmbat taranjolla,
këndon sardelja sipër nga një dét,
nani ngrihan patrunat e na japnjin vétë.

U dua vétë sa një varrllot,
çë mbushnjin një tielja ma një bot,
u dua vétë çë më vljoa ti.

çë ma një bot mbushnjin një kusi.
Ni ngrihat lja "Rrëkuçi" tre mallkuor,
psë ndën shtratit ngë gjen këpuctë e
vjetër,
ni ngrihat shò "Vëxhellja" ma shëndet,
e ka gavuti na prëjon vétë.

U xura ke ti vura një jukanë,
e dollnë trëmbëdhjetë padhuân,
gjithë trëmbëdhjetë të bëtën vétë,
ngrehu e na prëjon shtatë o tetë.

E né ngë duomi shumë vë,
baston ke ju na jpnì njizët,
kështu mbushmi më shpétë këtë mëzët,
pë t'ngosmi këtë katër djalleta.

U dua vétë çë bënë pula a zeza,
ajò çë ti prura ka Nuçera,
u dua vétë çë bënë pula ma tupiqin,
ajò çë vëshehat ta një furriq.

E né ngë a bëmi pë profit,
pë horan jona isht një uzënxë a vjetër,
né ishim të vegla e na hiti ta zëmbra,
nani a vemi tue kënduor derë për derë.

U jam Franxhisku e ti jë Franxheskja,
u jam gjiza e ti jë frushelja,
ti jë ndrë Pashkë e u t' Shtun i Shejt,
ngë isht Pashkët ndë ng'na ipni vétë.
.....Lja Rrëkù, naten e mirë!

LE UOVA DI PASQUA - Fino a qualche
anno fa, in questo paese, la notte di Sabato
Santo, dopo che si scioglievano le campane,
per antica tradizione, molte persone
bussavano alle porte degli amici e dei
parenti, chiedevano le uova per festeggiare
la Pasqua., e cantavano questa canzone. Per
conservare, per tramandare e per valorizzare
questa tradizione orale, questa canzone è
stata scritta, con l'intento di fare una cosa
buona. Adesso le persone sono tutte sazie e
non cantano più per chiedere le uova. Che
peccato!

Cantavano così:

"Bella gente, buona sera e buona Pasqua, /
sono venuti a cantare i parenti vostri, /
apriteci questa porta e queste finestre, / se
no restiamo qui dietro per un mese.
Ho appreso che oggi è Sabato Santo, /
domani è Pasqua veramente, / io so che tutti
mangiate le uova insieme, / chi crude, chi
cotte ed a me niente.

Canta la calandra nella gabbia, / canta sulle
spina l'allodola, / canta la sarda su ogni
onda, / adesso si svegliano i padroni e ci
danno le uova.

Io voglio le uova grandi come un barile, /
che riempiono la pentola in una sola volta, /
io voglio le uova che tu mi hai conservato, /
che con un solo colpo riempiono una
caldaia.

(ec te faqja 9)

P i r o z h i

Vittoria Oliverio

ka Shën Kolli (Kr)

Nj'her ish nj'gra ç'kish nj'bir ç'quhej Pirozhi.

Nga dita e tërgohj te mali sa t'mbjithj dru.

Pirozhi vehj pa mah pse ng' i përqehj, e, kute mbjedhur drut thej:" Dhe mund shkeljin vet këto dru u voheja ka sipë e veja mbronda i proht i proht!"

Nj'ditë sheh te mali di kupile ç' fjojin posh diaghit e i duket keq pse thej se mund kishin vapë e i mblon me fjeta.

Kur kupilet xjohen thonjin:" Kush na ka bon hje! Ç'sot ata ç'thot ke t'bohet!" Kupilet ishin t'Mirat.

Nj'dit Pirozhi o von sipë druve sa t'i dhilj e gji te nj'her shkarpat zonjin e shkelnin! Gji me hare Pirozhi tehet mbronda.

Kur shkon ka shpia e rregjit e bija e sheh e i thot jomsë: "Ma! Vre Pirozhi sipë druve!"

Pirozhi përgjegjet e i thot: "Ng' mund dilje me barë ka mua!" Shkon nj'mue e e bija e rregjit del me barë.

Jati e përzon ka shpia e ajo, ç'dihj ata ç'i kish thon Pirozhi, vete jet me ato.

Gjithj ata ç' thej Pirozhi bohej, pse kish qon i bekuer ka t' Mirat.

Pirozhi e e bija e rregjit venjin e jesnjin te nj'shpi mbronda malit.

Nj'dit rregji iç shkelhj me kalin te mali, kur gji te nj'her sheh nj'shpi e bukur e shum e madhe e do t'dinj e kuti osht!

Shpia ish e bekuer e fjitj e thej:"Mos hir!"

Përgjegjehj kupila ka mbronda e i thej:" Leje t'hinj"

Rregji ng'e njeh t'bijen! Kupila dunaret se ai osht jati e i thot de do t'hanj me atore.

Kur vohen e hanjin, nj'brokë i vete te duaku!

Kur sosnjin t'hanjin, kupila thot: "M'lipset nj'brokë!", vren te duaku i rregjit e e gjen atje.

Rregji i thot: "U ng'e di kush m'e ka von te duaku! Ng' kam qon u ç't'e kam mar!"

Përgjegjet kupila e i thot: " Si ti ng'din kush ka von brokin te duaku jet, u ng'dija kush m'kish von me bar! U jam jet bijë e im shoq osht Pirozhi!"

E bija i rrfien se Pirozhi kish qon i bekuer ka t' Mirat e se nani kishin di bihj.

Rregji i thot te e bija se i dukehj keq ka ata ç'i kish bon e se ng'mund gjejh shoq mo i mir se Pirozhi e rregji prearet se gjeti t'bijen ç'kish bjer.

Una volta c'era una donna che aveva un figlio di nome Pirozhi.

Ogni giorno lo mandava in campagna a raccogliere le frasche.

Pirozhi andava senza voglia perchè non gli piaceva e, mentre raccoglieva la legna, diceva: "Se camminassero da sole queste legna, io mi mettevo di sopra e andavo a casa senza stancarmi!"

Un giorno vede nel bosco due ragazze che dormivano sotto il sole e gli fanno pena perchè pensava che potevano sentire caldo e le copre con delle foglie.

Quando le ragazze si svegliano dicono: "Chi ci ha fatto ombra? Da oggi quello che dice si deve realizzare!" Le ragazze erano le Fate.

Un giorno Pirozhi si mise sopra la legna per legarla e tutto ad un tratto la legna si mette a camminare! Tutto contento Pirozhi torna a casa.

Quando passa dalla casa del re, la figlia lo vede e dice alla madre: "Ma! guarda Pirozhi sopra la legna!"

Pirozhi risponde e gli dice: "Potessi tu uscire incinta con me!"

Passa un mese e la figlia del re si trova (esce?) incinta.

Il padre la manda via da casa e lei, che sapeva quello che gli aveva detto Pirozhi, va ad abitare con lui.

Tutto quello che diceva Pirozhi si realizzava, perchè era stato benedetto dalle Fate.

Pirozhi e la figlia del re vanno ad abitare in una casa dentro il bosco.

Un giorno il re stava camminando con il cavallo nel bosco, quando tutto ad un tratto vede una casa bella e molto grande e vuole sapere di chi è!

La casa era benedetta e parlava e diceva: "Non entrare!"

Rispondeva la ragazza da dentro e diceva: "Lascio entrare!"

Il re non riconosce la figlia! La fanciulla si accorge che lui è il padre e gli dice se vuole mangiare con loro.

Mentre iniziano a mangiare, una forchetta si infila nel sacco (del re)!

Quando finiscono di mangiare la fanciulla dice: "Mi manca una forchetta!"; guarda nel sacco del re e la trova lì!

Il re le dice: "io non so chi me l'ha messa nel sacco! Non sono stato io a prenderla!" Risponde la fanciulla e gli dice: "Come tu non sai chi ha messo la forchetta nel tuo sacco, io non sapevo chi mi aveva messo incinta! Io sono tua figlia e mio marito è Pirozhi!"

La figlia gli racconta che Pirozhi era stato benedetto dalle Fate e che ora avevano due figli. Il re dice alla figlia che sentiva pena per quello che aveva fatto e che non poteva trovare marito migliore di Pirozhi; e il re si compiacce di aver trovato la figlia che aveva perso.

Shpitë e rea

(vjen ka faqja 4)

consegna delle case qualcuno si accorgerà che metà della popolazione che risiedeva stabilmente a Cavallerizzo non andrà ad abitare in località Pianette. E' stato ribadito più volte che questo sarebbe stato un modello positivo di ricostruzione. Quando ci sarà la consegna delle case si potrà constatare che questo è un modello di ricostruzione, ma del tutto fallimentare.

BIBLIOTEKA e JETËS ARBËRESHE

E.Giordano : Vangjeli, i pjerrë arbërisht – 2006 – ff. 230	€ 10
E.Giordano : Mbledhje këndimesh arbëreshë – 2006 – ff. 160	€ 10
E.Giordano : Himne Bixantinë – 2005 – ff. 217	€ 10
E.Giordano : Gramatikë Arbëreshe – 2005- ff. 70 (fotok.)	€ 5
E.Giordano : Fjalor (Dizionario Arbëresh-Italiano / Vocabolario Italiano-Arbëresh) - edic. 2000 - ff. 715	€ 25
E.Giordano : Shpata e Skanderbekut di B.Bilotta – 1967 - ff. 217	€ 15
E.Giordano : Folklore albanese in Italia – Festeggiamenti Pasquali a Frascineto (1957) (fotok.)	€ 5
Jeta Arbëreshe (shtatë vjet: 2002-2008). € 300;	për Institucionet € 400
Jeta Arbëreshe - Pajtim vjetor (abbonamento annuale). . . € 20;	për Institucionet € 40
Zëri i Arbëreshvet (1972-82) – riv. cult. (1 num. fotoc.) € 250;	për Institucionet € 400

Idjomatizme *

(mbjotoh) **Agostino Giordano**

ka Purçilli (Cs)

ftesënj, v.intr = avere colpa; peccare
ftesen djalli e e zën me Krishtin, la colpa è del diavolo e se la prendono con Cristo, danno la colpa a chi non ce l'ha
ftesen kush nëng i tha mir "Kredhin", la colpa è di chi non gli ha recitato bene il "Credo", la colpa è del compare
ftesen gjith ai Pilikaçi!..., la colpa è tutta di quel Denudato, la colpa è di G.Cristo
fuqi-a, sf = forza
s'ka më fuqi, non ha più forza
furr-i, sm = forno
la bukt nd'furret e vate e e ndihu, ha lasciato i pani in forno ed è andato ad aiutarlo, ha abbandonato tutto per aiutarlo
për të, nëng sosen gjith furri Masarëshles, per lui non basta tutto il forno della massaia, è ingordo
nganòn furrin, inganna il forno, ha infornato meno pani perché ha perso tempo nell'infornare
mbjoj furr e mulli, ha riempito forno e mulino, l'ha fatto sapere a tutti
fytyrë-a, sf = faccia
ka nj'fytir!..., ha una faccia!..., è pallido
gajdhur-i, sm = asino
e la si gajdhur, l'ha lasciato come un asino, non gli ha dato retta
shllohet te ftiga si gajdhur, si butta nel lavoro come asino, è un gran lavoratore
është mish gajdhuri, è carne di asino, è duro
thurret si gajdhuri Palòtit, raglia come l'asino di Pagliotto, senza motivo
gajdhure-ja, sf = asina
ato duar i ke një kònder gajdhurje, quelle mani ce l'hai piene di sporcizia d'asina, sei sporco
vete si gajdhure pa kapister, vè come asina senza capestro, è scapestrata
rri sikur i hënger buken gajdhurja, sta come se gli avesse mangiato il pane l'asina (calco ital.), è triste
e nisen si gajdhurja te stala, lo fa andare

come asina nella stalla, lo comanda a bacchetta
bën zbfandùnin e biths gajdhures, fa lo smargiasso del sedere d'asina, si vanta senza avere, fa lo strafottente
vunanxjùze biths gajdhures!, è generosa come il sedere dell'asina, generosa a parole
është një gajdhur, jasht pagzimit; è un'asina, a parte il battesimo; serve a poco
ka më vixë ajo se gajdhurja, ha più vizi lei dell'asina, è molto vizziata
është dreq gajdhure masarije, è proprio asina di masseria, rozza
ngren këmbet si gajdhurja "Lla Fjakës", alza i piedi come l'asina di "La Fiacca", è debole
i erth munda gajdhures, le è venuta la monta all'asina, è in calore
galinàr-i, sm = gallinaio, pollaio; sedere
ja dirtoj ai galinàrin, glie l'ha aggiustato lui il sedere, gli ha dato quel che si meritava
garòç-i, sm = tronco infracidito; rimbambito
është vakùt si garòç ulliri, è vuoto come tronco infracidito di ulivo, senza vita
ki garoç!..., questo rimbambito!...
garxë-a, sf = mascella
i shtipi garxat, gli ha pestato le mascelle, l'ha menato
i mbjoj garxat, gli ha riempito le mascelle (col mangiare), l'ha sfamato
gas-zi, sm = riso
ju nis (pjasi) mb'gas, ha iniziato (è scoppiato) a ridere
i hiri gazi, gli è entrato il riso, non la smette di ridere
rri me buzen mb'gas, sta con la bocca sorridente
rri me gazin nd'buzzet, sta con il riso sulla

bocca
u lëshua mbë gas, si è abbandonato al riso
pruar buzen mb'gas, si è messo a ridere, l'ha preso in giro
gilpërë-a, sf = ago
zu me një gilpër; cominciò con un ago, cominciò da zero
duall ka gilpëra tij, è uscito dal suo ago, è opera delle sue mani
sheh edhe nj'malez gilpërje, vede anche una punta d'ago, vede bene
është i mir vet ai ç'del ka gilpëra tij, è buono solo quel che esce dal suo ago, è vanaglorioso
është i dal ka gilpëra, è cosa uscita dall'ago, è cosa nuova
girdhù-t, sn = granello; intelligenza
është pa girdhu nd'kriet, è senza granello in testa, non è intelligente
i ka di gjisht girdhu, ce l'ha due dita di granello, vale
girlàc-i, sm = collo, trachea
është i zën ndë girlact, è preso al collo, ha troppe cose da fare
ju zu ndë girlact, gli si è impigliata nella trachea, gli è andato storto
ja suall njera ndë girlact, glie l'ha portato fino alla trachea, l'ha fatto imbestialire
t'vë di gjisht ndë girlact!..., ti metto due dita al collo!..., ti affogo
golë-a, sf = bocca; parola
ka pjot golen me mëm e me tat, ha la bocca piena di mamma e papà, è rispettoso dei genitori
i erth gola, gli è rivenuta la parola, ha ripreso a parlare
nàni vdes e bier edhe golen, fra un po' muore e perde anche la parola

* **Më të shumet e këtre Idjomatizme m'i tha mëma ime, Anita Zabeles Markut, 89vjeçare.**

(ka më)

Vëtë të Pashkit

(vjen ka faqja 7)

Adesso si alza il signor "Enrico" brontolando, / perché vicino al letto non trova le ciabatte, / adesso si alza la signora "Luigia" con buona salute / e ci porge le uova per il buco (della porta = gattarola).

Ho appreso che hai messo una covata, / e sono nate tredici galline padovane, / tutte e tredici ti hanno fatto le uova, / alzati e porgici sette o otto. Noi non vogliamo tante uova, / è sufficiente che ce ne diate una ventina, / così riempiamo prima questo panierino, / per saziare questi quattro giovanetti. Io voglio le uova che fa la gallina nera, / quella che hai importato da Lucera, / io voglio le uova che fa la gallina con il tuppò, / quella che si nasconde in un buco. (...)

Noi non lo facciamo per profitto, / questa era l'usanza dei nostri antichi, / a noi da piccolini è entrata nel cuore, / adesso andiamo cantando di porta in porta. /

Io sono Francesco e tu sei Francesca, / io sono la ricotta e tu sei la "fucella" (contenitore), / tu sei Pasqua ed io Sabato Santo, / non è Pasqua se non ci date le uova.

..... Signor "Enrico", buona notte".

Prallëza e pëlhurës

(mblodhi) **Costantina Florio**

nga Qefti (Fg)

Ishi një herë një horë e vogël e vogël ku gjithë njerzit shurbejnë. Burrat vejnë jashtë e punojnë dherat e grat bëjnë shurbisat e shpisë e edhe shurbejnë me argalinë për të bëjnë pëlhurat. Te një bukur shpi me muret të zbardhura e me një parathire plot me lule, rroji një bukur vajzë, që ishi nuse e re e kish martuar një trim i mirë, punëtor e pa i folur.

Ki burrë i kish blerë për dhuratë së shoqes një argali, ashtu kur ai ishi e punoju jashtë, ajo mund shkoi në me atë tua menduar të shoqin e tua bërë ndonjë pëlhurë për shpinë e tire.

Te të parët ditë nusja zuri fill të shurbei pëlhurën te argalia; pas pak ditë pa ke lodhshi shumë e ng'j pëlqejti më të bëji atë shubërtirë e kish të çdo ditë tiri dica e jiki jashtë: nani veji e gjeji shoken e saj m' e ngushtë për të shihni që bëji; pas shkoji te kumbari për të diji si ndjeheshi; pas shkoji te ndrikua për të bëji një dorëz këshill, ashtu i shkoi dita e bëhshi natë.

I shoqi pa ke te argalia pëlhura ngë rritëshi, atëhera një mbrëmë e pjësi nusen psë ngë rritëshi ajo pëlhurë. E e shoqja shpejt ju përgjegji:

- Gjindjet të liga më morën shishë , për këtë pëlhura ngë ecën! Ka vete te kisha e ka parkalesinjë Zotin të më nxjerr shishën.

E ashtu bëri e zuri të veji te kisha kur ng'ishi mosnjari. Te kisha, te dora e djathtë ishi një kriqë e madhe me Krishtin të vdekur, e nusja, sa hiji, i përgjunjëshi përpara e i thoji:

- Krisht oj, të më rritet pëlhura! Krisht oj, të më rritet pëlhura!

E rriji orë e orë të thoji ashtu. Sakrëstani që e njëjhi mirë e diji kush ishi ajo, do dini që bëri një menatë? I pari ke kjo popa të përgjunjëshi përpara kriqes e zëjji fill të lipi ke t'i rritëshi pëlhura, ai u fsheh prapa Krishtit e, pas që ajo kish bëjtur pjëthjen e saj, ju përgjegji e i tha:

- Shurbë, shurbë, ashtu pëlhura rritet!

Nuses ng'j pëlqejti përgjegjia e Krishtit e tha:

- Për këtë të vuren te kriqa! Për këtë gjuhë e ligë që ke!

E kish të jiku si varë e ng'u pror prapë mangu për të bëji kriqën kur erruri te dera, para ke të dili te kisha.

E vërteta ngë mund thuhet, pse mosnjari do t' e gjejinj!

C'era una volta un paese piccolo piccolo, dove tutte le persone lavoravano. Gli uomini andavano in campagna e lavoravano i terreni e le donne facevano i lavori di casa e lavoravano anche al telaio per tessere le tele. In una bella casa con i muri imbiancati e con una finestra piena di fiori, viveva una bella donna giovane, che era sposata a un giovane buono, lavoratore e calmo. Questo giovane aveva comperato come dono alla moglie un telaio, così quando egli stava a lavorare in campagna ella poteva trascorrere il tempo con quello pensando al marito e facendo qualche tela per la loro casa.

Nei primi giorni la sposa iniziò a tessere la tela al telaio; ma dopo pochi giorni vide che si stancava molto e non le piacque più di fare quel lavoro e così tutti i giorni tessava un po' ed usciva fuori (di casa): ora andava a trovare la sua amica più cara e vedere cosa facesse, ora andava a trovare il compare per sapere come si sentisse, ora andava a trovare la comare per chiacchierare e così trascorreva la giornata e si faceva notte.

Il marito vedeva che nel telaio la tela non cresceva ed una sera chiese alla moglie perché non aumentava la tela. E quella presto gli rispose: - Le persone cattive mi hanno fatto il malocchio, perciò non cresce! Devo andare in Chiesa a pregare il Signore affinché mi tolga il malocchio.

E così fece, ed iniziò ad andare in Chiesa quando non c'era nessuno. In chiesa, sul lato destro (entrando), c'era una grande croce con Gesù crocifisso e la donna, appena entrava, si inginocchiava davanti e diceva:

- Cristo, fa' che mi cresca la tela! Cristo, fa' che mi cresca la tela!

E rimaneva ore ed ore a dire così. Il sagrestano che la conosceva bene e che sapeva chi era quella, volete sapere che fece una mattina? Prima che quella si inginocchiasse davanti alla croce ed incominciasse a chiedere che la tela crescesse, si nascose dietro al crocifisso, e, dopo che ella aveva fatto la sua richiesta, le rispose e le disse:

- Lavora, lavora, così la tela aumenta!

Alla donna non piacque la risposta di Gesù Cristo e gli disse:

- Per questo ti hanno messo in croce! Per questa lingua malvagia che hai!

E fuggì via come il vento. Non si voltò neanche per fare la croce quando arrivò alla porta, prima di uscire dalla chiesa.

La verità non si può dire, perché nessuno vuole ascoltarla!

Vjershe

(mblodhi) **Carlo Trupo**

ka Farneta (Cs)

Mjesnat këndon gjeli kalliu,
te dera të bukurat tha "zgjoju!";
ndë ajdhëtit¹ ndonj kundrät, ti majtohu²,
se ai që të doj të lëshoj.

Menat kam të ikanj, oj Rinë,
po kur të nisem, te dera dil:
se mos të pasha tij, u zëmran e shkel,
e lot' t e mij lanjan gur e udhë.

Ti ndë bën kundrät, drigojme thën,
se, mos të marrsha u, ndrikull të bënj;
amuri it të drigoj të fala,
t' i vu te nj' vë që e bëri pula.

Ti mollaz e lashët që je mature³
çë u dishëtim mirë na
çë kur ishim kriature⁴;

e pi pjest tënde pat 'gjegjja armura⁵,
ma kam bënj dhe më se sa bëra.

Të lë tija kur ta m' bënjan vëra,
ikanj kteja kur t' m' bjer mashkatura;
te dera jote u bëra nj' fos,
kush të shkonjë atje me thikt i vras:
ca i vras, ca i lë me kulët,
s' a ndikuronj se ndë filëqit vdes.

Ti mandasele⁶ që luan si bosht
e ktët kupile na e rrit' tim bashkë:
ti e rrite me fletë, me fashët
e u e rrita me vjeshët⁷.

Manat e ndanjam na,
pir ndëpir mest,
u marr kujmin lajt⁸:

e shalëzit e kraht,
edhe kriat e këmbët
e duarzit e sist;
e pjesan e tëj⁹,
u ju jap turrest;
e do t' e rrishtonj
gjithë u, ktët,
mollzan e lashët

- 1) ardhëtit;
2) marthoju;
3) ital. (per esigenze di rima) = "e pjekur";
4) fëmijë;
5) ital. rumori;
6) mattarella;
7) vjershët;
8) kurmin lart;
9) e tërë.

Intervistë zotit **Manuell Giordano**

Katundi e Zakonet

(interviston) **Agostino Giordano**

i nipi, ka Purçilli

- Çë mbani mend të Frasnitës të viteve '30? Si rrohej?

Katundi ish shumë më i vogël se nani. Shpitë ishen të vogla po gjindjat ishen shumë, sepse lehëshin më shumë, trimat shurbejen e punojen ndër dherat. Nëng ish emigrim ndë Europë, vet ndë Merket mund vehej, me thirrjen e ndënjij gjiriu; po s'kishen shumë turres për t'vëjen atjë.

- Gjindjat kishen gjithë shpi e dhera, si sot?

Jo gjithë kishen shpi, e, nd'ë kishen, ish e vogel e tërrane. Mbanj mend se ndër këto shpi të vogla rritëshin edhe 10-12 bil te një stanxje! Për dherat, më të shumet shurbejen ndër dherat e të tjeret mësegjithë ndër vreshtat, sepse ahiera Frasnita thërritej "katundi i veres". I veres ' mirë. Mink Braille farmaçist, çë kish një kandinë të madhe, i vu ëmrin veres tij "Pim pim" e "Merr trutë". Dherat ishen gjithë të punuara, aq ndë katund sa ndë malt, ku mbillej grurë, theker, krikomel, patana.; e këta dhera shurbëhëshin me shatin e me parmendën.

- Ishen shumë lëtinj ndë katund? Ka vijen? E si qellshin?

Lëtinjt ishen pak, jo shumë si sot. Vijen më të shumet ka Kasana e ka Hora (Kastrofila). Si vijen, kish të xëjen gjuhen arbëreshe, sepse atire i folje vet arbërisht; e ishen më gratë ç'e xëjen karrera e me pjaxhir, se sa burrat. Ishen edhe dica lëtinj çë dijen ashtu mirë arbërishten, e i dojen ashtu mirë zakonet arbëreshe, sa butthohëshin më arbëreshë se Frasnjotët! Frasnjotët, pra, martohëshin jo vet me arbëreshë të katundit e me ndonjë lëti, po edhe me të tjerë arbëreshë të katundevet afër: paremëparë purçulotë, e pra çivitjotë, shënavilotë, fermënjotë, pllatanjotë, etj.

- Kush ish podestàu i atij moti? Si rrohej nën fashizmin?

Për shumë vjet qe Antonio Fazio (Xhandoni), pas atij erth Domenico Bellizzi (Mikuci Minkandonit), çë shit verë. Nën fashizmin rrohej me ndonjë trëmbësi, sepse podestàu i thoj atyreve çë qellshin lik:"Shih se të kallarenj!" (dmth. "të vë nde filaqi", e filaqja gjëndeje ndë horet). Po nën fashizmin rrohej mbë paqë, sepse ishin më pak gjind të liq. Trimat kish të bëjen millitarin, Muzullini kish bëzonzj suldëtësh se t'mirrë Abisinien e t'zgjeronje kolloniet nd'Afriket. Thoj:"Ndër Kolloniet zgjerohet Atdehu!"

- Këndohej naten? E Kungulli?

Trimat mbjdhëshin me shokët e tire e vejen ture kënduar naten, e ndihjen ndonjë trim çë kish nusen, e vejen e i këndojen vjershe e graxeta malli. Ndër këta këngëtar s'mund mangonej vjershtari çë studjonej fjalet çë kish 'thojen. Hereherë ata të shpisë ngrëshin e ja hapjen e i jipjen të hajen e të pijen. Dica trima, naten e sprasme të marsit, vejen naten me kungullin, e rëfijejen të ligat çë ndënj vashëz kish bënë. Ishen sharje të trasha e nganjë i trëmbej "kungullit".

- E, kur martohëshin, këndohej "vjershi i nuses"?

Tek të martuarit bëshishin shumë shërbise ka ana nuses e ka ana dhëndrrit. Nusja ndreqnij stolitë ç'i jipjen prindët e i bënej finjen, me shokazit ç'e ndihjen. Ditën e martesës, tek të vaturit mbë qishë e tek të pjerrit ka qisha, i këndohëshin vjershe aq nuses sa dhëndrrit; e mbë tries, dhëndrri zënej "vjershin e trieses" "Kush

m'ë jëndi triesen..."

- Cilat ishen festat më të pritura? E si shkohëshin?

Ishen Natallet e Pashkët. Ndër Natalle bëshishin petulla e kruskul e skalleta e t'tjera ëmbëlsira, çë thërritëshin "haretë e Shën Bumbinit". Delaret vejen mbë qishë, naten e Natallet, ture i ratë karramunxavet, e pra i bijen edhe jashtë. Guanjunt i bijen fishketevet e fishkarolvet.

Ndër Pashkë hahej e pihej mirë, zëshshin vallet, nxihëshin lëtinjtë e pjeqt puthjen Kutullen.

- E ish festë kur pagëzohëshin?

Ish festë për fëmilen. Vejen mbi shpitë kumarë e ndrikulla e gjiri, e ndreqjen djalin o vashëzen; pra e mirrjen mbë dorë e - ture e ngrëjtur lart e lart – i urojen gjithë të mirat. Ndëse i pari bir ish mashkull ish më i gëzuar i jati; ndëse ish femer, kish më hare e jëma.

- Si bëhej festa e Pashkëve?

Pashkët ishen shumë të pritura. Gjithë vejen mbë qishë të veshur me stolitë më të mira, mësegjithë gratë. Më të shumet skomollisëshin e kungohëshin; prifti kish shumë ftigë, e, ndëse ish pjak, lodhej. Po, më se gjithë, gjindja prit të bëhej festa e Vallet. Bëshishin valle vet me gra, valle me vet burra e valle të përziera. Këndohëshin Rrapoditë e Skanderbekut (ka burrat) e Këngat e Kostondinit e të Jurëndinës (ka gratë). Vallet zëshshin aq me kamizolla umberje e rrazi sa me coha. E kush nëng kish kamizollen, vej e e mirr hua ka fëmilat më të bëgata. Pra nxihëshin lëtinjtë, bëjen Pjelzit e puthjen Kutullen.

- Ndër lipet, gratë i këndohej Valtimet?

Ndër lipet, i tërë katundi ish mbë lip. Vejen te shpia e të vdekurit e ngushëllojen gjiritë. Gratë e fëmiles këndohej vajtimet; o, ndëse s'dijen, thërrisjen një grua çë dij t'i këndonej e ish edhe vjershtare: e gjithë qajen ata ç'ishen mbë shpi, sepse këngëtarja zë fill gjithë jeten e të vdekurit. Mbanj mend se këngëtarja më njohura Frasnitë, ahirna, ish Roza Koçondinit.

- Sa mot shkohej ndë malt, gjatë vitit?

Ndë malt, çë verë, vejen ata çë kishen dherat, se t'i mbilljen; e ata çë prisjen dru për të ngrohëshin ndë dimër. Ndë mars o ndë prill vejen edhe ata çë bëjen gropa të mbëdha, i mbjohen me borë, e pra i mbulojnë me dushqë, e ndë verë vejen e mirrjen ata borë e ja shisjen kandiniervet, se t'i ftohjen veren atireve çë vejen e mburrillojen nder kartazit, kur prirshin ka dherat.

- Cilet ishen kronjet e Frasnitës e të Purçillit?

Frasnitë ishen kroj Kravarit (nën katund) e kroj Këmallit (afër qishës ' Shën Pjetrit). Kroj Këmallit kish ca ujë të le çë shëronej. Purçill s'ish një kroat, po një lum (lumi Ejanit), i thërritur Kroj Math, çë nxir 550 llitra ujë nga sekond! Gjithë vejen e mirrjen ujë atjë për të pirë, e për të lajen stolitë kur bëjen finjen. Purçilli kish edhe njeter kroat, i thërritur Kroj Fratanxhullit. Këta kronje lehshin gjithë ndër këmbët e malit Pulin. Me ata potisëshin edhe dherat e mbjellura me lakra, marrule, pumbadhore, karkavece, kungul, etj...

(2 - ka më)

Giuseppina Demetra Schirò

ka Hora e Arbëreshëvet (Pa)

Guri i Shën Mërisë e Dhitrjes

[...] *Fino ad oggi, coloro che passano di là, baciano devotamente la pietra, che nessuno oserebbe rimuovere, e recitano qualche preghiera: mentre i bambini, attraverso una piccola cavità, che in quella si riscontra, ed alla quale applicano prima l'occhio e poi l'orecchio, si illudono di vedere i luoghi dai quali mossero i loro antenati, in cerca di nuove sedi, e di udire la voce dei fratelli d'Albania.*

Kështu guri
 çë të kle otar
 shpirtin fëmijë
 qell në thjellësin
 e ishujve dhe flatrave
 sa të shohënj
 një klishecele
 të zbardhur me kërqere
 sa të ndienj
 isonin
 e brigjeve dritje
 e kur del jashtë
 si shtie në të errëtit
 rërë te zjarri i dhezur
 gjimsëhënje dhe purçisionësh
 prapa një ikonë
 gjer në pikën
 pa kthim

LA PIETRA DELL'ODIGITRIA - Così la pietra / che ti fu altare / l'anima bambina / porta nel sereno / di isole e di ali / per vedere / una chiesetta / intinta nella calce / per sentire / l'ison / di spiagge di luce / e quando emerge / come getta nell'oscurità / sabbia sul fuoco acceso / di mezzaluna e processioni / dietro un'icona / fino a un punto / di non ritorno

Giovanni Pace

Xhuanini Kaçafritullit, ka Purçilli (Cs)

Senaturit Vasil Giordano

Shumë t'urtë Arbëreshë dhá ki katund dhe u të shkruanj arbërisht një mall të kam: ata e nderuan po aq sa e di tërë jeta e u së jam i rremë, se është vërteta. Mua zëmren me hare m'e mbjon pjot se u, si ata, u leva purçilot: ka mot ç'ëmrin ja ndërroi në Ejaninë ai zoti i motit shkuar dhën Pjerin. Ndër njerzit çë katundin kanë nderuar ë fëmila e Xhordanvet lavdëruar: i sprasmi bir më i ndier është Vasili çë bëri e bën dritë po më se illi: Senatúr e zgjothtin ata Itall-Merikàn, e sot është ulet ndë Parlamend talljan. Ju thom çë nderë ai mua më dha e zëmren me hare ai pjot m'e la. Ish ndir njëzetekater t'muajit shëndrë kur vajt'e mora posten u njenjë: busten m'e hapa e timbri ish rroman: urimet e Natallvet të Vasilit Xhordan! Ki kundith më la mua shumë të gëzuar sa thash: kët t'mirë u kam e lë të shkruar. Nderove ngjezot tët at e mëmzen me hare, çë tij birith pjot urtësi të vunë mbi dhe: pir nënd muaj i mbshove mall ndë barkut asaj hajdhjare Anitës Zabeles Markut. Nëng thom pir atë vlla bular pjot urtësi, çë kur këndon mbë qishë të siell ngulli; nëng thom pir motrat çë kanë mall pazallë se kanë ndi shpi një Senatur kshtu t'rallë: një vlla çë s'gëndet, hajdhjar e me urtësi, çë gjithve, frasnjot e purçilot, bën simbatí. Këtë nderë mbànie shtrenjtë ju çë m'e kini, se nipa jini të zot Manolit e t'lal Gubinit. Vasili Buzdhelprit nderon Tallje e Arbëri: Merka e Kanadhàu m'i bëjen hajdhí.

(28-12-2008)

Cosmo Rocco (1925-2002)

poet popullor ka Strighari (Cs)

I KËNDOVA *

I k'ndova mallit
 i k'ndova gjelles
 i k'ndova udhes
 çë m'qellen ndë shpi.

I k'ndova motres
 i k'ndova vllaut
 i k'ndova mëmes
 p'r sa t'mira më dha.

I k'ndova mikut
 i k'ndova shokut
 i k'ndova pjakut
 atij t'mier** se ku ë.

I k'ndova diellit
 i k'ndova hënzes
 i k'ndova dheut
 çë buken m'e dha.

I k'ndova lumit
 i k'ndova dejtít
 i k'ndova shënjtit
 çë sh'ndeten m'e dha.

I k'ndova sheges
 i k'ndova molles
 i k'ndova vreshtes
 çë veren m'e dha.

I k'ndova bores
 i k'ndova dimrit
 i k'ndova veres
 çë lulen m'e dha.

* poezi e nxjerrë nga libri:
Cosmo Rocco, Vjershe, a cura dell'Amministrazione Comunale, Fondazione De Rada e Sportello Linguistico di S. Cosmo Albanese, tip. Tecnostampa, Corigliano Calabro 2004, pp.104-105
 ** t'mjerë.

HO CANTATO— Ho cantato all'amore / ho cantato alla vita / ho cantato alla strada / che a casa mi riconduce. / Ho cantato al sole / ho cantato alla luna / ho cantato alla terra / che mi ha dato il pane. / Ho cantato alla granata / ho cantato alla mela / ho cantato alla vigna / che mi ha dato il vino. / Ho cantato alla sorella / ho cantato al fratello / ho cantato alla mamma / per quanto bene mi ha dato. / Ho cantato al fiume / ho cantato al mare / ho cantato al santo / che mi ha dato la salute. / Ho cantato alla neve / ho cantato all'inverno / ho cantato all'estate / che mi ha dato il fiore. / Ho cantato all'amico / ho cantato al compagno / ho cantato al vecchio / che in pace riposa.

Alisa Velaj

pedagoge, nga Vlora (Shqipëri)

Kufij

Dielli verbon mes ishuj resh
ishujsh të tretshëm
ishujsh të ikshëm

Dielli përflaket në kreshta resh
kreshtash të tretshme
kreshtash të avullta

I dashuri i cigankes
me pishtar ndër duar
kërkon kasollen
ku ngrica shkrin gjymtyrëve...

Shpirtëra

Mbi ujëra enden pulëbardha të plagosura.
Trishtimi detar i qiellit.

Aventura

S'e kishte prekur kurrë fundin e vet.
Kur një ditë iu bë mbarë, i hipi të parës anije që gjeti në breg dhe
udhëtoi rreth botës për tre vjet, tre muaj e tre ditë.
Pak ditë parë mbërritjes, gjeti në një ishull të braktisur vëllanë e
vet binjak.

Zhani Korçari

u le në Jaxeri-Gizzeria (Cz), u rrit në Korçë (Shqipëri), rron në Romë

Arbëreshët

Qindra vjete kaluan
që braktisën Atdhënë
prej ditës që shkuan
për të mos ndruar fenë.

Kan' në zëmër një mall
porsi flake pa pushim
dhe në shpirtin një hall
për mërgimin pa kthim.

Ruajn' tradita gjyshërore
dhe një vale fisnike
dhe zakone krahinore
me trajta besnike.

Flasin gjuhën amtare
të lashtë e të shquar
të Shkabës Dykrenare
me dashje të pashuar.

Këngë, valle dhe tesha
të ditëve kremtore

janë për 'ta porsi vjersha
të rrënjës kulturore.

Kanë vajzat syzeza
si dhe djemtë, të zgjuar,
ata janë si djellreza
te latinët të dalluar.

Duan vëndin ku rrojë
me ndjenja bujare
dhe kurrë nuk mohojnë
originën shqiptare.

Janë stërnipët e ati Dheu
përtej detit "Jonë"
ku leu Skënderbeu,
"Fatosi Shqiponjë".

Ke nderin të jesh
në ballë të lavdisë
kur ndjehesh "Arbëresh"
ndër tokë t'Italisë.

Temjan

Lutem sërish pas heshtjes ose hesht prorre pas lutjes.
Zambaku i ëndrrave i është larguar prej kohësh ngjyrës së bardhë.
E bardha e borës, e bardha e petaleve... e deri tek e bardha e vezës.
Një korb më i zi se vdekja vjen rrotull zambakut dhe meket në
krahet e shtrëngatës.
Era e temjanit të tejshpon nuhatjen...

Çezar Rica

poet e gazetar nga Laçi, Kurbin (Shqipëri)

SHTETËSIA *

Unë jam nga ai vend
ku burojnë legjenda, ujë dhe fëmijë

HISTORIA E SHQIPËRISË

Kur të mbarohen heronjtë,
ti hesht frikshëm
dhe bën kurbane.

Ngrohtësia e aromës së kripur të gjakut tënd
të deh mes ekzazës dhe çmendurisë.

Heronjtë vdiqën, të dehur:
Kurbanët meritojnë përjetësinë, të çmendur.

HOROSKOPI

Më thanë je peshk i artë
dhe gjithë oqeanet e botës janë mbretëria jote

Por unë desha te fluturoja vetëm një herë,
mbi male, lumenj, fusha

Të qaja
dhe ju të shihnit lotët e mi
të më rridhnin për të dashurën time...

Jam peshk i arte,
por notoj në varrin e lotëve të mi

* *Këto poezi janë nxjerrë nga libri: Çezar Rica, Kopshti i trëndafilave të Shirazit – këngë dashurie për jetën dhe vdekjen -, Botimet Toena, Tiranë 2008, faqe 12,54.*

Djovasni

Jeta Arbëreshe on-line

<http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

La presenza futurista nella letteratura albanese

Pierfranco Bruni

ka Sullarënxa (Cs), poet, gazetar e shkrimtar

C'è un legame tra il Futurismo e la cultura albanese del Novecento? Il rapporto tra il Novecento letterario italiano e il mondo letterario albanese è stato sempre caratterizzato da forme di tentativo di comprensione e di riconoscenza da parte della letteratura albanese nei confronti del mondo occidentale e in particolare della letteratura italiana. Mi riferisco però a quella cultura albanese che si è distaccata da una eredità musulmana ed ha sposato, in termini di tradizione scanderbeciana, la testimonianza spirituale prettamente occidentale e cristiana, pur non perdendo mai i segni di un mosaico islamico che ha una sua portata al di là dell'aspetto prettamente religioso.

Un esempio tra tutti è la presenza di Gabriele d'Annunzio nella letteratura albanese e negli studi dedicati alla storia del rapporto letterario tra il Novecento albanese e quello italiano. Una prova ne sono gli scritti di Ernest Koliqi. Uno dei maggiori, se non il maggiore, storico della letteratura che con l'Italia ha sempre avuto dei legami esemplari. Vissuto per molti anni in Italia e italianizzato sino alla sua morte.

A D'Annunzio Koliqi deve molto, ma anche D'Annunzio deve agli studi di Koliqi, il cui modello letterario moderno, quello che è fuori dagli schematismi ideologici marxisti, è tutto intriso di un dannunzianesimo estetizzante (in positivo). Non potevano mancare le esperienze futuriste in Albania.

L'Albania ha avuto un altro "mito", nell'estetica letteraria, che è quello di Filippo Tommaso Marinetti. Non solo il Marinetti dei Manifesti, ma anche quello della parolibera e soprattutto quello che è riuscito a portare la teatralità nel linguaggio comune. Alla letteratura albanese si devono alcune poesie dedicate proprio al Futurismo e in particolare a Marinetti.

Poesie che sono state pubblicate sulla rivista "Poesia" diretta dallo stesso Marinetti e da Sem Benelli. Un esempio. Sul numero 5-6 del giugno-luglio del 1905 della rivista compaiono due poesie di anonimi albanesi scritte in lingua albanese e tradotte in francese.

Manca la traduzione italiana. Siamo in un contesto importante. Non c'è ufficialmente ancora il Futurismo.

Il Manifesto verrà pubblicato soltanto quattro anni dopo, ma insiste da un anno una rivista che diventerà l'organo ufficiale del Movimento. Si tratta di una rivista stampata a Milano, la cui redazione era in Via Senato, 2, e porta come sottolineatura, o come sottotitolo, "Rassegna Internazionale diretta da F.T. Marinetti - Sem Benelli - V. Ponti. Mi pare un dato significativo quello del rapporto, a priori direi, tra la letteratura italiana e gli scrittori e poeti

sottotitolo: "Chanson Albanaise inedite), tradotta in francese da Ary René d'Yvermont. La seconda porta il titolo seguente: "Sois le bienvenu". Il primo testo reca una dedica: "pour mon ami F.T. Marinetti". Peccato che i due testi sono firmati, nella versione albanese, da "Auteur inconnu". Ma ciò sta a dimostrare come vi era un frequente dialogo tra l'Albania e l'Italia proprio sul tema del Futurismo, e, tra l'altro, dimostra come la cultura albanese era a conoscenza del movimento Futurista, prima della pubblicazione dello stesso Manifesto su "Le Figaro" del 1909.

E' un dato veramente eccezionale, perché dimostra come il Futurismo e Marinetti siano penetrati in quelle culture mediterranee ed adriatiche, con le quali lo stesso Futurismo ha poi manifestato forti simpatie, ma in una stagione immediatamente successiva, già in fase di dibattito.

Il Manifesto Futurista, pur essendo stato pubblicato ufficialmente nel 1909, era stato redatto e pubblicato in Italia qualche anno prima. Non ci sono dubbi che abbia fatto da filtro la figura di D'Annunzio, anche se inconsapevolmente, perché D'Annunzio in Albania era visto come un innovatore e anche come un rivoluzionario, non solo dal punto di vista letterario e dei linguaggi ma anche politico.

La stessa funzione del Futurismo va, credo, in questa direzione. E la poesia dedicata all'amico Marinetti, scritta dall'autore sconosciuto, apre una prospettiva di interpretazione storico-letteraria interessante. Il Futurismo anche successivamente guarderà alle culture altre, quelle adriatiche e quelle soprattutto che portano istanze dal mondo orientale, con molto interesse. D'altronde anche l'arte albanese moderna, rivoluzionaria e sperimentale (nel solco delle avanguardie) risente, nell'impatto con la forma e con il colore, di una relazione con la funzione che ha avuto il Futurismo. La rivista futurista "Poesia", dunque, era conosciuta nella cultura albanese del 1905.

TU ES L'ÉTOILE

(Chanson albanaise inédite)

Pour mon ami F.T. Marinetti

Ti jee yyl é ti jee drit
Yli kjë delj ndaj të gdiit.
Zoti ynë të dhasht dit!
Fljasen gjithë bukurin tënde,
o shpyyrt.

Edhe szokjet kuur këendojën
Shokj me shokj po ligjërojën,
Po subëe gjuh te t'yre thojnë
Ë fljasen bukurin t'ëndë
O shpyyrt.

Me atë këshët fiijë fiijë
Tshë m'i bëjnë fakjes hije.
Posi dieli kuur bie
Fljasen gjithë bukurin t'ëndë
O shpyyrt

Me këshetin ljakje ljakje,
Kur m'a dreth è e vë mbi fakje,
Po si ljulje manushakje
Fljasen gjithë bukurin t'ëndë
O shpyyrt

(Auteur inconnu)

dell'Albania di inizio Novecento. C'era dunque un interesse particolare per il Futurismo. Queste due poesie, pubblicate sul numero citato, si intitolano (con titolo tradotto in francese): "Tu es l'étoile" la prima, con

Jeta, Zëmra e Dheu

Arbri Roman

ka Roma

Kozmai ish i ulur te der'e qishës me kryen tek ëndi, kështu ruhej nga ajri i ftoftë çë frij nga Sheshi i Popullit, ku arroj nga malet çë ndë këto ditë ishin të pështuara me borë. Diavasij një librëz i ri ç' i kish dërguar ajo grerëz e s'mbesës, Kologreja.

Kur pra arruvan Gjergji e Ndoni, ai dukej se flëj. Ata ruajtën këtu e këtë.

Kur e panë, Ndoni tha: "Pa shih, Kozmai flë e diavasën: si nga herë, bën dy shurbise bashkë!"

Ngrëjtja zërin Gjergji: "Kozmaj, Kozmaj! Çë na bën sonde ati gjith' i kurrusur me një libër ndë dorë? Do t'veshë ndë shkollë pameta?"

"Do t'ish mirë – u përgjegj – por jam plak. Ma kur kam mot djovasinj gjë; nani jam e ruanj këtë libër të ri çë më dërgoi Kologreja ime mbesë".

"Pamë se i vënje shumë ré librit, sa çë na dukej se flënje – i tha Ndoni ture shtënur diskursin mbë të qeshurit – Ma çë thotë ky libër i ri?"

"Më parë do t'thom se është' i shkruajtur arbërisht, pra se është' i shkruajtur ndë një gjuhë arbëreshe të lajtur e të krehur shumë herë; nga fjalë është te vendi i saj e s'mund të gjëndet në nj'etër vend. Është si një mozaik ku çdo gurez merr llokun e saj, kullër me kullër. E shkruajti shumë bukur autorja këtë libër poezie".

"Një grua shkruan poezi arbëreshe? – i shpëttoi si i trëmbur Gjergji: Pra lypu: "E kush është kjo grua e urtë? dhe çë thotë ky libër?"

Kozmai u përgjegj: "Autorja është një arbëreshe nga Çifti i Kalabrisë. Ja thonë Kate dhe shkruajti shumë poezi, të publikuara jo vetëm n'Itali, po edhe në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni. I dhanë edhe dica çmime, si "Qirium" e poetit të madh Naim Frashëri. Përkëtheu libra nga gjuha shqipe ndë gjuhën lëtishte, dhe nga lëtishtja ndë gjuhën shqipe. Ajo bin'e njohin poetët e sotshëm arbëreshë në Shqipëri".

"Sa mirë! – tha si me një shërtim Gjergji, ai çë vjen ka Hora e Siqelisë e pensoi Skiroin plak dhe Skiroin e ri. Lypu nj'etër herë: – "Ma çë thotë ky libër i ri?"

"Janë 36 poezi, të shkruara gjatë shumë vitëve; janë shkruajtur ndë të folmen e Çiftit, katundi i poeteshës, dhe i saj: Atje ajo ka zëmren, si thotë titulli i librit: "Zëmra e Dheu". Janë poezi me mall, me ndjenja dashurie për katundin, për njerzit e katundit, për grat e forta çë ruajtën dhe trazmetuan besën dhe vlerën e jetës. Kur arruajt ju, ishnj e djovasjua poezinë: "Te klisha e katundit". Gjegjëni çë na thotë neve çë djovasim: "Mos e shuani dritin e qirinjvet". Kozmai kish dashur t'e interpretoj kështu këtë vjersh të bukur: "Mos e shuani dritën e qirinjvet, ç'ju dheztin ditën e pagzimit". Ma ju duk se kjo idé s'ish në poezinë dhe e mbajti për të, te zëmra e tij. Sa shurbise të pathëna ruan zëmra!

Ndoni kish folur pak e fare. Nani mori e tha: "Duhet të jemi mirënjohës dhe kemi t'e haritisim poeteshen tonë, poeteshë ç'u njohnja, ma nëng dinja se shkruan kaq shumë e kështu mirë! "Zëmra e Dheu", me të vertetë, na mbajnë të gjallë mbi dhe. Kur ju thojti ato fjalë të bukura çë gjegja, u pensova atë çë na thot Bibla, do m'e thënë se njeriu vjen nga dheu, nga bota, dhe qëndron i lidhur dheut: për atë çë na duhet sa t'hami e për atë çë na duhet sa të rromi".

Kozmai, si i zgjuar nga një gjum i gjatë, tha: "Është mirë se edhe sot njeri shkruan poezi si këto".

Pra u dhanë dorë njeri jetrit e u ndajtin: një mori udhën e Grekvet, jetri atë ç'qellen te Sheshi i Spanjës e i treti vate nga Sheshi i Popullit.

Babuini, pak llargu, s'gjegji faregjë nga ata çë thanë sonde miqt'e tanë. E mbeti qet. Ma u e di: atij poezitë i pëlqejnë.

Cosimo era seduto alla porta della chiesa col capo sul battente, così si riparava dal vento freddo che soffiava da Piazza del Popolo, dov'è arrivato dai monti che in questi giorni erano ammantati di neve. Leggeva un libricino nuovo che gli aveva mandato quel calabrone della nipote, Cologrèa.

Quando poi arrivarono Giorgio e Antonio, egli sembrava che dormisse. Essi guardarono qua e là. Quando lo videro, Antonio disse: "Ma guarda, Cosimo dorme e legge: come ogni volta, fa due cose contemporaneamente!"

Alzò la voce Giorgio: "Cosimo, Cosimo! Cosa ci fai lì stasera, tutto accovacciato, con un libro in mano? Vuoi andare di nuovo a scuola?"

"Sarebbe bene – rispose – ma sono vecchio. Ma, quando ho tempo, leggo qualcosa; adesso sto guardando questo libro nuovo che mi ha mandato Cologrèa mia nipote".

"Abbiamo visto che ponevi attenzione al libro, tanto che ci sembrava che dormissi – gli disse Antonio, buttando il discorso sul ridere – Ma cosa dice questo libro nuovo?"

"Prima voglio dire che è scritto in arbëresh, e poi che è scritto in una lingua arbëreshe lavata e pettinata molte volte; ogni parola è al suo posto, colore con colore. L'ha scritto molto bene l'autrice questo libro di poesie".

"Una donna scrive poesie arbëreshe?! – gli scappò a un titubante Giorgio. Poi chiese: "E chi è questa donna saggia? E che dice questo libro?"

"Cosimo gli rispose: "L'autrice è un'arbëreshe di Civita, in Calabria. Si chiama Kate e ha scritto molte poesie, pubblicate non solo in Italia, ma anche in Albania, in Kosova, in Macedonia. Le hanno dato anche alcuni premi, come "la Candela" del grande poeta Naim Frashëri. Ha tradotto libri dalla lingua albanese a quella italiana, e dall'italiana in albanese. Lei fa conoscere i poeti odierni arbëreshë in Albania".

"Che bello! – disse come con un sospiro Giorgio, lui che viene da Piana, in Sicilia, e pensò a Schirò senior e a Schirò junior. Chiese un'altra volta: "Ma che dice questo libro nuovo?"

"Sono 36 poesie, scritte lungo molti anni; sono scritte nella parlata di Civita, paese della poetessa, la sua terra: lì lei ha il cuore, come dice il titolo del libro "Il Cuore e la Terra". Sono poesie appassionate, con sentimenti d'amore per il paese, per gli abitanti del paese, per le donne forti che hanno difeso e trasmesso la fede e il valore della vita. Quando siete arrivati voi, stavo leggendo la poesia: "Nella chiesa del paese". Sentite che ci dice, a noi che leggiamo: "Non spegnete la luce delle candele". Cosimo avrebbe voluto interpretarlo così questo bel verso: "Non spegnete la luce delle candele, che vi hanno acceso il giorno del battesimo". Ma gli sembrò che questa idea non c'era nella poesia e la tenne per sé, nel suo cuore. Quante cose inespresse conserva il cuore!

Antonio aveva parlato poco e niente. Adesso prese a dire: "Dobbiamo essere riconoscenti e dobbiamo ringraziarla la nostra poetessa, che io conoscevo, ma non sapevo che scrive così tanto e così bene! "Il Cuore e la Terra", in verità, ci tengono in vita sulla terra. Quando voi dicevate quelle belle parole che ho sentito, io ho pensato a quello che ci dice la Bibbia, cioè che l'uomo viene dalla terra e resta legato alla terra: per quello dobbiamo mangiare e dobbiamo vivere".

Cosimo, come risvegliato da un lungo sonno, disse: "E' bene che anche oggi qualcuno scriva poesie come queste".

Poi si dettero la mano l'un l'altro e si separarono: uno prese la via dei Greci, l'altro la strada che porta a Piazza di Spagna e il terzo andò verso Piazza del Popolo.

Il Babuino, poco lontano, non sentì nulla di quello che dissero i nostri amici. E rimase in silenzio. Ma io lo so: a lui le poesie piacciono.

Dhimitër Kamarda i shkruan De Radës

prof. dr. Italo Costante Fortino

Universiteti L'Orientale i Napoli

Carissimo De Rada,
Oggi stesso mando al Sig. Santori una copia della mia traduzione “Fylétia e Arbanoré” etc., ed all’Avv.° Toci G., supponendo che non l’abbiano ricevuta. Io non l’ho mandata che al pr. Dorsa, perché sapeva che la n(ostr)a principessa voleva spedirla a voi direttamente. Non so se il Nociti l’abbia avuta, ma siamo in tempo di mandargliela. Tempo fa lessi un v(ostr)o articolo sul giornale l’Omnibus di Napoli, concernente i Canti popolari Italo-Albanesi, e rilevai dallo stesso che quel foglio avea parlato ancora della mia Grammat(c)a. Mi fareste piacere di dirmi quando, e come, e per organo di chi ne scrisse, qualora me ne possiate dar contezza. E’ molto tempo che non ho v(ostr)e lettere, e le avrò carissime. Voglio sperare poi che mi direte qualche cosa del mio ultimo lavoro. So benissimo che le nostre idee sul modo di dare sviluppo alla lingua epirotica, non si combinano intieramente, pure la franca esposizione degli avvisi d’una persona che io stimo, ed è da molto tempo amica, mi sarà gradita ed utile. Avete ben veduto del resto che io non ho dato la preferenza esclusiva a nessun dialetto, ma tutti gli ho abbracciati in quello che giudicava buono e accettabile, ma ho avuto in mira più l’Albania intiera con l’Epiro, che le n(ostr)e povere Colonie. Vi sarà grata la notizia che vi do, aver io ricevuto una nuova traduzione (stampata a Costantinopoli, con lettere italiane modificate) dei 4 Vangeli, e degli Atti apostolici, fatta da un elbassanese, nel dialetto ghego centrale, che è quello di Elbassan (Albanopoli degli antichi). Io ne ho tratto la consolazione di vedervi la lingua migliore che quella di Scutari, o del ghego-settentrionale; e nulla ho trovato che non confermasse le opinioni espresse nei miei scritti. In un punto speciale ha superato la mia aspettazione, poiché non solo vi è qualche traccia del participio in mune, come nel gh(ego) settentr(ionale), p.e. pamune, bamune, in luogo del semplice me frequente anche da noi,

ma questa forma vi si trova sola in pienissimo uso (oltre quella in une), e non l’altra in me, che si conferma esser un troncamento (che io credo però utile e commoda), della prima. Talune cose nondimeno io trovo nella d(ett)a traduzione che non sarebbero da approvare nella lingua letteraria e corretta.

Datemi presto le v(ostr)e nuove, e quelle degli amici, nonché delle cose di comune interesse. Ditemi, se lo sapete, ove trovosi il Dorsa. Il bravo Sig.r Mosciaro, ex-deputato etc., continua nella sua comoda dimenticanza che lo dispensa dal pagare i debiti.

Vi abbraccio, pregandovi de’ miei particolari ossequi al Sigr Jenò, e mi dico sempre

Aff.mo

P. Demetrio Camarda

Dhimitër Kamarda është një shkrimtar arbëresh nga Hora e Arbëreshëvet (1821 – 1882) e studhjoji në Kolehjin Grek e në Propaganda Fide Romë. Prift i rritit bixantin shurbeu më parë në Horë, pra Napul dhe në fund shkoi Livorn, ku bëri skollë në Xhinasin dhe qe prift i Qishës greke. Është një intelektual shumë i përgatitur që u interesua për gjuhën, për të cilën shkruajti: Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese (Livorno 1864) e dy vite pas Appendice al Saggio di grammatologia comparata (Prato 1866), ku boton materiale gjuhësore të traditës shqiptare e arbëreshe. Bëri edhe përkthime, ndër të cilët mund të mbajm mend Vangjelin e Shën Matheut. Kjo literë na buthton lidhjet që ai pati me shumë intelektualë të atij moti e konfirmon se autorët arbëreshë ishin gjithë të lidhur një me jetrin e shkruashin për të komunikojin gjithë atë që bëjnë e që kishin besë se ish mirë për të qellinjin përpara kulturën arbëreshe. Te kjo literë sa zë e shkruan na thot mbjatu se ai kish komunikojuna me autorin nga Picilia, F. A Santorin, me G. Tocin, me V. Dorsen, me Noçitin dhe me Prinçipesën Dora D’Istria. Na thot edhe se dhjovasi rivistat që shkruanjin për kulturën arbëreshe, dhe kërkonjin një numer të rivistës Omnibus, e para rivistë arbëreshe, që botohej Anapul, e drejtuar nga Vinçenç

Torelli, arbëresh nga Varili (PZ), ku De Rada ka botuar dica artikuj.

Problemet gjuhësorë që janë sod ndë mes t’arbëreshvet ishin edhe dje, kur shkruanjin Dh. Kamarda: Xhirolam De Rada privilexonij të folmen arbëreshe të katundit të vet, saku Dh. Kamarda - ja shkruan qartë De Radës ndë këtë literë - privilexon një formë koinjë nga gjithë dialektet, ture mbajtur përpara syve më së shumti gjuhën e Shqipërisë dhe jo të folmet arbëreshe. Nga kjo pikëpamje Kamarda i drejtohet intelektualëve që mund dhjovasnjin jo vetëm një gjuhë të lartë dhe të rafinuar ndë lesikun, po i drejtohet intelektualëve që dinjin te dhjovasnjin gjuhën greke, pse aq ndë Saggio di grammatologia comparata, sa edhe ndë Appendice al Saggio di grammatologia comparata, ai përdorën alfabetin grek për të shkruanjin gjuhën arbëreshe.

Nj’etër aspet interesant është sesi Kamarda, kështu edhe skritorët e tjerë arbëreshë, ishin të informuar mbi atë që botohej ndë Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë. Kamarda ndë këtë literë i thotë De Radës se mori librat që përktheu Kostandin Kristoforidhi, nga Elbasani: katër Vangjëjtë dhe Atet e Apostujvet, dhe afermon se gjuha që përdori Kristoforidhi është më e bukur dhe më e mirë se ajo gege e veriut. Kamarda shprehën këtë opinion pse ka ndë mend e ndë dëshirë të arvohet të formohet një gjuhë unike që ai thërret “gjuhë letrare korrekte”. Mund të afermohet se ai anticiptari konkluzionat e Komisës Letrare të Shkodrës (1917) e cila zgjodhi si gjuhë të aministracionës së shtetit Shqiptar, sapo të pavarur, gjuhën e Elbasanit.

Si mund vëhet re, këto litera të shkritorëve arbëreshë kanë shumë rëndësi pse na buthojin jetën familiare, jetën kulturore me gjithë problemet, e vegjël dhe të mëdhenj, që ndodheshin ndë momentet private o publike të autorëve që kishin lidhje ndër ta, si edhe kishin lidhje me skritorët dhe studiozë të Europës. Këto litera na buthojin edhe se kultura arbëreshe ish e hapur ndë mes t’intellectualëve arbëreshë, të cilët dëshironjin të lidheshin edhe me studiozë europianë. Kjo literë sheh driten këtu per herën e parë, e orixhinali, dorëshkrim, gjëndet ndë Arkivin e Shtetit, Tiranë (Fondo 24, dosja 54/3, fletë 27-28)

Poetika e Vincens Belmonte-s

prof.dr. Klara Kodra

Universiteti shtetëror i Tiranës (Shqipëri)

Vincens Belmonte, bashkëvendësi i Serembes (lindi më 1945 në Strigari) është tepër i veçantë ndër poetët e sotëm arbëreshë prej të cilëve shkëputet në problematikë dhe në formë. Poezitë e tij dallohen nga konçiziteti dhe thellësia e nëntekstit. Belmonte është poeti arbëresh që afrohet më tepër me poezinë bashkëkohore italiane, po të përjashtojmë arbëreshin tjetër tepër të talentuar Kostantino Marko i cili shkruan italisht. Vincensi është një poet i mendimit, një poet filozof që u drejtohet më tepër problemeve ekzistenciale se sa problematikës patriotike ose sociale që parapëlqehet nga poetët e tjerë arbëreshë (në mënyrë e veçantë e fundit).

Megjithatë është thënë për të se “vjershat” e botuara më 1981 pasqyrojnë mjedisin e Strigarit. Ndofta vjershat e tij pasqyrojnë atë ndjenjë të dhimbshme të shtypjes që ushtron mjedisi i ngushtë dhe plot paragjykime mbi një shpirt të zjarrtë dhe një mendje të gjerë. Është po ai konflikt që ka përjetuar dikur me vështrimin e romantikut në shekullin e kaluar Zef Serembe.

Belmonte që i ka kushtuar këtij poeti një vëmendje të veçantë si studiues duke hedhur hipoteza të guximshme lidhur me krijimtarinë e tij, sikur e ka thithur edhe revoltën e brendshme që arrin në pesimizëm të paraardhësit të vet.

Veçse pesimizmi i Serembes, sipas nesh, është i lidhur më tepër me ndjenjën se sa me një botëkuptim të caktuar filozofik, ndërsa pesimizmi i Belmontes lidhet me një filozofi të ndërjegjshme, disi eklektike ku shkrihen sisteme të ndryshme filozofike. Poeti ka ditur ta bëjë filozofinë limfë të brendshme të poezisë së vet. Temat e mëdha, jeta, vdekja, dashuria, janë në qendër të

poezisë së tij. Ndonëse Belmonte nuk e prek konkretisht temën e mallit për atdheun e të parëve, në poezinë e tij ndihen dhimbja dhe shqetësimi për traditën e hershme të arbëreshëve që është në rrezik të zhduket. Ndofta tema e vdekjes që është e pranishme si leitmotiv tragjik në poezinë e tij, e ka burimin jo vetëm te pakënaqësia e heroit lirik për realitetin që e rrethon, po edhe te dhimbja e thellë për humbjen e traditave arbëreshe.

Heroi lirik i vjershave të Belmontes është më shpesh mendimtari që e sheh me sy kritik realitetin, pa iluzione. Nganjëherë me këtë mendimtar shkrihet fëmija shpirtpastër që e sheh të zhduket botën e ndritur dhe poetike të fëminisë në realitetin e vrazhdë. Herë-herë heroit lirik shndërrohet në një luftëtar që lufton për idealet e veta dhe është gati të flijohet për to.

Konçiziteti i poezisë së Belmontes është i theksuar, jo rrallë vetëm tri-katër vargje kanë një ngarkesë të fuqishme mendimesh dhe emocionesh.

Poeti parapëlqen midis figurave simbolin dhe kjo e ka ndihmuar t’i japë thellësi poezisë së tij, ndonëse nganjëherë hermetizmi që e dallon këtë poezi e kalon masën duke krijuar zona tepër të errta.

Belmonte ndikohet nga kultura antike greke, italice dhe indiane, po në ndonjë poezi si “Vdekja e trimoshit” i qëndron pranë edhe poezisë popullore arbëreshe. Gjuha e Belmontes është ajo e fshatit të tij, po poeti ka punuar shumë për ta pasuruar me neologjizma ose me fjalë të vjetra që, si të thuash, “rizbulohen” prej tij.

Belmonte e ka zërin e vet poetik ku shkrihen çuditërisht erudicioni dhe spontaneiteti dhe në poezitë më të mira

dallohet për konçizitet dhe thellësi mendimi.

Vincenzo Belmonte, da S. Cosmo Albanese, compaesano del Serembe, si differenza dagli altri poeti arbëreshë per forma e problematica; si avvicina, più degli altri, alla poesia contemporanea italiana. E' poeta del pensiero, poeta-filosofo: parla più di problemi esistenziali che di problematiche patriottiche o sociali. I suoi versi rappresentano il sentimento doloroso dell'oppressione che un ambiente piccolo e pieno di pregiudizi esercita su uno spirito ardente e una mente aperta. Belmonte ha dedicato al romantico Serembe una particolare attenzione come studioso e da lui ha ereditato la vena pessimistica. Ma, mentre il pessimismo del Serembe è legato piuttosto al sentimento, quello del Belmonte si accompagna ad una filosofia cosciente, eclettica, che il poeta trasforma in linfa per la propria poesia. La vita, la morte, l'amore sono al centro della sua poesia. Anche se non tratta il tema dell'amore per la Madrepatria, si avverte il dolore per il rischio di scomparire che corre la tradizione arbëreshe. L'eroe lirico della poesia del Belmonte è il pensatore che guarda la realtà con occhio critico, disilluso; a volte si trasforma in un combattente che lotta per i suoi ideali. Poesia concisa, simbolica, ermetica è quella del Belmonte, e questo le dà profondità; poesia che subisce l'influsso della cultura antica greca, italiana e indiana, ma anche, in qualche caso, della poesia popolare arbëreshe. La lingua usata dal poeta è quella del suo paese, ma arricchita di neologismi o termini antichi. Erudizione e spontaneità si fondono nella poesia del Belmonte. (Redaz.)

JETA ARBËRESHE

KËRKON KORRISPONDENTË
NDËR KËTA KATUNDE:

Sëndahstinë (Pa), Kastërnexh, Qan, Marr, Fermë, Shën Vasil, Strigar, Shën Mitër, Mbuzat, Shën Mërtir, Picili, Vakaric (Cs); Barill, Zhur, Shën Kostandin (Pz), Portkanun, Rur, Këmarin (Cb), Shën Koll, Karfic (Kr), Garrafë, Vinë, Andall (Cz)

KUSH DO TË SHKRUANJË, KA TË NJOHË MIRË TË FOLMEN E KATUNDIT ‘ TIJ

Telefononi o shkruani Drejtorit: 0981-32539

e-mail: jetarbreshe@libero.it

Bota Arbëreshe si esenca e Botës Shqiptare

dr. Laura Smaçi

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (Tiranë)

Sa herë përfytyrohet mjedisi arbëresh e flitet për të, kufijtë mes reales e poetikes shkrihen shumë më lehtë se për çdo argument tjetër. Kjo botë - ku ligjet e kohës kanë funksionuar në mënyrën më origjinale të mundshme, ku e tashmja e ka ruajtur më shumë se kudo të shkuarën, duke e konsideruar çelësin e ekzistencës e jo armikun e saj - ka qenë gjithmonë mahnitëse për shqiptarët e Shqipërisë. Kjo spjeron dhe lidhjen tonë të veçantë me krijimtarinë e autorëve arbëreshë. “*Rrallë herë një rracë paraqiti larg atdheut prova të tilla lidhjeje me trashëgiminë e lashtë të vendit të Parvet*” do të shkruante E.Koliqi tek “*Shejzat*”, (Ernest Koliqi, Vepra 6, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 291), i cili shprehet gjithashtu: “*Ndër Arbëreshë vepron instinkti i fisit arbnuer, shkasi i mshëftë i kujtimit të dheut të të Parvet. De Rada, Skiroj, Santori, Gavril Dara, tue gjurmue e rmue në grumbulli të dokeve stërgjyshore e tue thellue hulumtimit në mshëftit e instinktit fisnuer, ringjallën shpirtin e fjetun të Arbënit.*” (po aty, f.310).

Shumë vlerësimë të tilla do të bënte Koliqi për autorët arbëreshë, por akoma më të gjalla do të ishin përshtypjet e tij nga vizitat reale tek arbëreshët. Nuk kish si të mos frymëzohej një shkrimtar që i kishte kushtuar gjithnjë interes të madh zbulimit të anëve të ndryshme të mendësisë shqiptare e thelbit etnik të tyre, që tek arbëreshët gjente shprehjen më të gjallë të tipareve të lashta, të ruajtura me fanatizëm e dashuri. Por po t'i rikthehemi autorëve arbëreshë, interesi i Koliqit për De Radën është mjaft i dukshëm e i kuptueshëm. Në rast se përkatësia shqiptare e dëshmia e ekzistencës së një entiteti shqiptar dilte tërthorazi në veprat e autorëve të shek. XVI - XVII, në veprën e De Radës është parësore. Shpallja e ekzistencës së një kombi shqiptar me gjuhën, historinë e traditat e papërsëritshme bëhet prej tij në disa plane e nëpërmjet disa drejtimeve. Në këtë mënyrë përpjekje që në mënyrë jo të organizuar ishin bërë prej shekujsh, përmblihen në një figurë të vetme. De Rada krijoi nëpërmjet veprës së tij një Shqipëri ideale jo thjesht me virtytet e zakonit e saj karakteristike, por me një shtrirje të preکشme hapsinore.

Jo më kot është theksuar njëlloj shkrije mes një Shqipërie të përfytyruar dhe mjedisit Kalabrez në topomastikën e veprave të De Radës. Tek “*Milosao*” ai këtë mjedis arbëresh e transferoi në Shkodër. Ky imazh sintezë në planin hapsinor e kohor, Kalabria e Shqipëria, shek. XV me shek.XIX. dhe lidhja mes shqiptarëve brenda kësaj hapësire që qendërohet dhe në martesën e princeshës së Artës – Serafinës së Topiajve me Nikollë Dukagjinin, ishte imazhi që duhej përcuar tek shqiptarët e shek. XIX. Krijimi i një Shqipërie ideale jo thjesht me virtytet e zakonit e saj karakteristike, por me një shtrirje të preکشme hapsinore, i jepte vizionit ngjyrën e profecisë. “*Skanderbuku i pafan*” e çonte lexuesin nga Arta e Himara, në Krugë, Shkodër, Dibër, Mirditë, Elbasan, pra nëpër një territor gjeografik që ka ekzistuar si në vitet 1418 - 1440 të veprës, e vazhdohte të ekzistonte edhe në fundin e shek. XIX.

Po ashtu De Rada ka qenë mjaft i vetëdijshëm për rolin tepër të rëndësishëm që ka pasur, ka dhe do të ketë bota arbëreshe. Korrespondencat e tij me një varg figurash të kohës së tij, na bëjnë të kuptojmë menjëherë bindjen që ai kishte se vetëm një përfaqësues i një mjedisi që ka arritur të ruajë të paprekur prej pushtuesit më të mirën që ka në vetvete kombi shqiptar – siç ishte mjedisi i kolonive arbëreshe dhe ai vetë në rolin e këtij përfaqësuesi – do të luante rolin themelor për rilindjen e Arbrit. “*Gjuha shqipe duhet të jetë më pak e prishur në ngulimet arbëreshe të Italisë, të mbajtura, të mbyllura ndaj të huajve dhe me fetë e tyre të paprekura, se sa në Shqipërinë e shkelur e të bërë rasin nga turqit.Faktet kanë urdhëruar që, nëse populli ynë do të organizohet (do të ringjallet), do të flasë gjuhën e ngulimeve arbëreshe të Italisë.*”¹ Ndonëse pohimi i fundit që utopik, përpjekja e frutet e punës së De Radës në të gjitha fushat ku ai kontribuoi, tejkaluan ndjeshëm mundësitë e një njeriu².

¹ Nga korespondenca e De Radës me Dhimitër Kamardën. Vula e nisjes së postës Milano, Kalabri 22. I. 1866. Jeronim de Rada, Vepra letrare 3, “*Naim Frashëri*” 1987.

² “Unë ndërmora pa e kuptuar në një moshë shumë të re një veprë shumë më madhore se

mosha ime, larg tokës mëmë të cilën nuk e njihja aspak, lindur në një shtëpi të vogël, dhe në fshatin më të vogël arbëresh mendova të mëkëmb gjuhën e origjinës e t'i formoj ndjenjën e vetëdijës bashkëkombasve të mij. Emilia Giglio, Le lettere di Girolamo De Rada a Nicolò e Gerolamo Tommaseo e a De Gubernatis. Tesi di Laurea anno acc. 1963-64 della Fac. Lettere dell' Università di Roma, f.223. – Në G.Schirò “*L'Albania ideale di Girolamo De Rada*” Shëjzat 1964

Ogni volta che si immagina o si parla di ambiente arbëresh, i confini tra realtà e poesia svaniscono molto più facilmente che per ogni altro argomento. In terra arbëreshe le leggi del tempo hanno funzionato nel modo più originale possibile, e il presente ha difeso, più che altrove, il passato, considerandolo “chiave della vita” e non suo nemico; e questo ha sempre sbalordito gli albanesi d'Albania. Da qui il legame speciale che noi abbiamo con la creatività degli autori arbëreshë. E il primo a parlare in termini mirabili del mondo arbëresh fu Ernest Koliqi, che lo conobbe in modo profondo, studiando i loro poeti e visitando a più riprese i loro paesi. Negli Arbëreshë Koliqi scopriva un popolo attaccato in modo stupefacente alle proprie radici, al ricordo della propria Madrepatria. Dal mondo arbëresh trasse molta ispirazione e di molto amore lui lo ricambiò. E l'autore arbëresh più studiato e amato dal Koliqi fu il De Rada, perché nella sua opera l'appartenenza all'etnicità albanese è prioritaria e più sentita e vissuta che in altri autori. De Rada ha creato, attraverso la sua opera, un'Albania ideale, non solo con le sue virtù e tradizioni caratteristiche ma con una estensione spaziale commovente. In “Milosao” trasferisce l'ambiente arbëresh in Albania, fa una sintesi spazio-temporale tra Calabria e Albania, tra il sec.XV e il sec.XIX: un gemellaggio spirituale fra Arbëreshë e Shqiptarë. La creazione di una simile Albania ideale riveste quasi i toni della profezia. De Rada capisce il ruolo essenziale che il mondo arbëresh può rivestire per l'Albania, considerato che gli Arbëreshë hanno saputo conservare, in Italia, lingua e tradizioni più integre e genuine rispetto agli Albanesi, vessati in ogni modo dai Turchi; e quasi quasi vorrebbe consigliare agli Albanesi, nel giorno della loro Rinascita, di adottare la lingua arbëreshe. Un'idea utopica, che però fa capire fin dove si spingeva l'amore ideale del De Rada verso la Madrepatria. (Redaz.)

Tris(h)tia në kthim të pandalë

Baviola Shatro, M.A.

pedagoge e Letërsisë Shqipe në Universitetin Shtetëror të Durrësit (Shqipëri)

Ndryshe nga ç'ndodh në kontaktin realisht të vazhdueshëm me pjesën tjetër të letërsisë shqipe, sa herë lexoj poezinë e shkruar nga arbëreshët, përjetohet një tjetër përvojë. Nuk je më ti, lexuesi i etur, apo studiuesi i letërsisë që shkon drejt poezisë për të parë në ajo të ka përzgjedhur për të të folur (në rast se e kuptojmë se letërsi nuk bëhet me forcë vullneti, por me dhuntinë e lindur dhe disiplinën e pamëshirë të artit si i tillë). Në rastin e kësaj poezie është ajo vetë që duket se kërkon të kthehet dikund, të vijë për tek ti dhe para se të ulet, sikundër ndonjë shpend i mprehtë pas një udhëtimi tejpamësisht të gjatë, heton terrenin heshtur, pothuaj pa bëzajtur.

Besoj se poezia shqipe e arbëreshëve të Italisë njihet pak, për pasojë shijohet pak e çmohet pak. Për ta bërë më të rëndë peshën e këtij realiteti unë nuk nguroj të pohoj se mjafton një kontakt sado i kufizuar me të për të parë të vërtetën e një realiteti e përmase aspak të largët, aspak të mjegullt, dhe natyrisht as fare pak të huaj. Megjithatë ajo është kaq pak e pranishme në studimet e letërsisë shqipe përgjithsisht e unë mendoj se është ndër më të keqstudiuarat në jo pak raste edhe kur kanë tentuar t'i qasen. Zbehja e madhe e natyrës së saj ka nisur që me leximin e De Radës të përshtatur në shqipe letrare e jo të pajisur me aparat shpjegues e ndihmues. Dhe këtu hapet një diskutim i gjerë që vet ka degëzime të shumta, një pjesë e të cilave, jashtë letrare mendoj unë. Në këtë shkrim nuk do të qëndroj në këtë çështje pavarësisht rëndësisë së saj.

Gjuha shqipe ka një fat që ndoshta asnjë gjuhë tjetër nuk e ka. Ajo rron e gjallë në një trajtë të vjetër të saj. Pra, nëse kulturat e tjera mund të pohojnë me të drejtë se gjuhët e tyre janë shkruar mijëra vjet më parë dhe janë dokumentuar, ne shqiptarët vërtet që nuk shtyhem ende dot më tej se 5 shekuj në këtë drejtim, por ama ne shohim sot të flitet shqipja e Arbërit; jo të jetë e shkruar kund, por të flitet e gjallë e madje me të të shkruhet letërsi.

Nuk do të doja të hyja në analizat e pse-ve të një njohjeje kaq të kufizuar të kësaj krijimtarie, se në konceptin tim është vërtet një njohje e paplotë madje ndonjëherë pseudonjohje, por do të doja të qëndroja në një mbresë e një imazh që unë shoh se krijohet nga leximi i shtrirë në kohë i disa poetëve të mirënjohur të poezisë shqipe të arbëreshëve. Për shekuj të tërë poezia arbëreshe i ka kënduar atdheut të largët, dëshirës për kthim (mund të kujtojmë mes të tjerave një sërë poezish të Vorea Ujkos vonë në gjysmën e dytë të shek. XX) por tani duket se është kjo poezi që pret që dikush të shkojë tek ajo.

Them se jemi në lexuesit, studiuesit ca më tepër. Ajo nuk është mjegull legjende, por një poezi e hollë, (shpesh edhe poezia e traditës edhe ajo më e vonë më ka krijuar ndjesinë e një punë me filigranë) me simbole në një masë të konsiderueshme natyrorë të cilët lëvizin gradualisht në nivele më abstrakte dhe përgjithësues. Ato bëhen çelësa kuptimorë duke pranëvënë gjendje të përkundërta shpirtërore dhe ndjeshmëri të mprehta në buzë intensifikimi të vazhdueshëm. Duke lexuar ndër poezitë e Luka Perrones më bie në sy përdorimi i figurave mbi bazën e fjalëve-kyç yll, acar, hije, natë, akulli, kërcitje, zbrazëti, errësirë, erë, petalëz, flutura, lis etj. Ndërsa tek Vorea Ujko shikon burimin, shtegtimin përsëri erën, lirin etj. Duke u afruar më shumë në kohë tek Kate Xukaro shoh ngriren, kandilin, vargje akulli, burg, yjet, rrezet, ujën, thëllimin etj.

Ndërsa tek A. Giordano kalon përtej, në lot, ëndrrat, sytë, deti,

hëna, hijet, ulliri, era, etj. Është e thjeshtë të lexosh në poezinë e arbëreshëve një frymë tipike, një ndjeshmëri fort të trajtësuar, e cila si e tillë ka një mëvetësi të sajën dhe një interes të veçantë studimor. Më duket se në gjysmën e dytë të këtij shekulli në këtë poezi ka shtegtuar parreshtur shpirti poetik dhe thellësia njerëzore në harkun e kalimit nga bregu i ftohtë për në tokën ku mbijnë e mbeten shekujve ullinjë, ku rriten hardhitë, ku rrjedh, vaj, qumësht, mjaltë edhe mirrë. Trajtohet një imazh i tokës së premtuar që nuk është thjesht një tokë, një vend, por është destinacioni i një ndjeshmërie të tërë krijuar gradualisht me durim mbinatyror nga vet koha brenda njeriut. Ndërsa lexoj nga kjo poezi në mendje me shfaqet një imazh tepër fort i dashur i botës që ka ndërruar lisa, ujët që kaltëronte në dit' n e re. Porse një përjetësie tërë e ciklur brenda vetes paprajë duket se nuk ka mundur të plakë ullinjë dhe hardhitë që janë dy simbole të veçantë, të cilët i vërejtja në një poezi të A. Giordanos:

Mbi shkëmbinjtë shkretie
dëshira ime pushtimi
hie që kërkon një trup

Jam degë ulliri
që pret erën
se t'puth hardhinë.

Është fare e thjeshtë të lexosh një ligjërime psalmi në këto vargje. Mosgjetja e trullit të gjallë ku të vësh veten e thellë në prehe është si ravgimi idesë para se të aktualizohet e të banojë në një gjësend. Është e shkuara, një përjetësi e tërë pothuaj, që s'ka ditur të plakët, e cila kap çastet vrapuese të kohës duke dashur të gjejë burimin e jetës, ushqimin e të padukshmes që është thelbi ynë.

Pasi i lexon vargjet kupton se është krijuar vetiu një rreth domosdoshmërisht i mbyllur në vetvete, mes mallit dhe trishtimit pothuaj mitik të arbëreshit të largët, njeriut të gjetur dikund larg pikës së tij të gravitetit dhe mallit tim, që të njoh atë pjesë të vetes, të poezisë shqipe, të ndjeshmërisë së gjuhës që rron e vërtetë e jo në endra a palimpseste të lashta, por vetëm disa dhjetra kilometra larg në gadishullin përballë. Atëherë malli im është malli i lexuesit të etur, i njeriut që percepton të vërtetën e parandjerë që kur nuk dihet se në ç'kohë, por që ka ngelur përballë saj pa e prekur. E ky mall bëhet tris(h)tia (trishtim, erë, fëshfërimë... pa prajë).

Ogni volta che leggo poesia arbëreshe provo un'esperienza diversa. Non sei tu, lettore assetato o studioso di letteratura, che vai verso la poesia per vedere se essa ti ha scelto per parlarti; nel caso della poesia arbëreshe, è lei stessa che viene da te, come un uccello dopo un lungo viaggio. Credo che la poesia arbëreshe si conosca poco, perciò si gusta e si apprezza poco. E' poco presente negli studi di letteratura albanese ed è, secondo me, quella studiata peggio nelle poche occasioni in cui hanno tentato di avvicinarsi. Il grande pallore della sua natura è cominciato con la lettura del De Rada tradotto in lingua letteraria e non accompagnata da note esplicative; e qui si potrebbe aprire una lunga discussione. La lingua albanese ha un destino diverso dalle altre lingue, in quanto vive attualmente anche in una sua forma

(ec te faqja 25)

Disa vjërsha te Hjeronyme Dé Rades mé shénimé

dr. Edmond Çali

shqiptar, lektor në Universitetin "L'Orientale" të Napolit

"Milosao" është një nga veprat më të rëndësishme të letërsisë shqipe të shekullit të nëntëmbëdhjetë. De Rada e shkroi këtë vepër kur ishte shumë i ri. Aty gjejmë edhe temat e motivet e veprave të mëvonshme të autorit. Në shkrimin e "Albania-s" "Milosao" rradhitet në vend të parë: "Ner shkrimét é p- numerueshmé, si ne vjërshë si ne bisédë te xghidhun, ci krijoj mëndja piëlloré é é frytshmé é te ndierit De Rada, ner mâ sé 60 vjtë puné te pa-trështun, aj ci mériton vëndin é pare, áshit pa dyshim, poémi idylliak "Milosao", te tsilin é botoj me 1836 kuer ilosao vëtem 22 vjtësh".

Për të përfurcuar këtë tezë kujtojmë studiuesit e shumtë dhe të rëndësishëm që e kanë vlerësuar lart veprën. Bëhet fjalë për studiues shqiptarë, por edhe për të huaj: "Shkrimetare é dijëtare te medhâ é ne xa, si t'yne si te huej, dhaené per mî të gjikimé te nalte é te lavdueshme. Gni létruer frång, i thoté keshtu auktorit: "Votre jeune 'Milosao' a toute la fraîcheur et totes les beautés de l' 'Aminta' du Tasse", é Xoti N. Tommaseo i shkruet: "Del nuovo e dell'antico é nelle parole di Lei come Chi osserva e sente la verità".

Citimet e vlerësimeve mbyllen me Lamartinin: "Pa u-shtye mâ téper, me dukét sé per te gith mastojne fjalet é te ndíghuemit vjërshetuer Lamartine i tsili, mâssi é kendoj, désht mé i tfacésué De Rades ndérimin ci kish per té mé két létre:

"Monsieur, je suis heureux de ce signe de fraternité poétique et politique entre vous et moi. Le poésie est venue de vos rivages et doit y retourner...".

Elementi autobiografik është i pranishëm sepse dashuria e protagonistit të poemës është vetë dashuria e De Radës, dhe mjedisi i përshkruar në vepër është vendlindja e autorit, fshati i tij në Kalabri: "Ne poémin "Milosao" De Rada kendònte ndollunat é gñij djali, mé két émen, ci thote sé ish i biri i Sundimetarit te Shkodres ; por, ne te vertéte, nuk bân t'jétre véch mé diftué mé fjalet ne ndiemét é xémres se vét, ci, n'at kohe kuer shkruéte, ish é ndéxun ne dashtenie per gni vashex, ci aj therret é bija é Kologrées. –Edhë gnyrat é vëndit nuk jane te Shkodres as te Shcypenies se vertéte: ghithekush u-ghét ndo-gni hére, sikur uné ne Maki te Kalabries, ci áshit

katundi ku léu é moj vjërshetori, mujt mé é pamun ghasimin ci ky ka mé at vënt ci kendon De Rada ner varghé te vét".

Edhe pse artikulli që po shqyrtojmë është jo fort i gjatë, aty gjejmë të trajtuar edhe çështjen e gjuhës, kemi një vlerësim negativ për sintaksën dhe për rolin që ka rima sipas vetë De Radës: " 'Milosao' -ja áshit i shkruem shcyp: ghuha nuk áshit é rãnde, por permlédhja (sintassi) áshit é t'érreshmé é é vishtir ; varghét jane shtaterroktse é téterroktse te perxiem bashke, é te xghidhun dué me thãne pa ghasimramjé (similiter desinens, rima) é tsila, mas mëndimit De Rades, nuk ka kurrni vjéjfé né véti pos dãmít ci mé i hjéke xbukurim é fucie mëndimévét".

Vijmë kështu tek përkthimi italisht i tekstit : përkthimi i bërë nga autori nuk këshillohet, por propozohet përkthimi i bërë nga njëri prej studiuesve të parë të kualifikuar të De Radës, ai i Gualtierit : "Sikur gadi te ghittha véprat é véta édhë keté De Rada e perkethéj italisht, por ne gni mendyre mjéft te vishtir é te ngaterrueshmé ; pas tij é perkethyené édhë t'jére, por mué perkethimi mâ i bukri me dukét aj ci bân Xoti G. V. Gualtieri (Donatello Nive) gni djale i ri italkan, ci mét per 4 a 5 vjtë ne S. Demetrio Corone (Shen Miter) afer Makit, é keshtu u-shcypetaresué é nzûni te ndérojne De Raden".

Revista ka ndërmend që të vijojë edhe më tej me botimin e pjesëve më të mira të "Milosaos", të shoqëruara nga përkthimi në italishtë i Gualtierit, për lexuesit që dinë edhe italisht. Por në numrat e tjerë nuk e gjejmë këtë material të premtuar : "Ch' me sot po nzaem fille mé i dhãne mé shijué kendojtorevét t' "Albanies", tsopat mâ te bukrat é "Milosao-s", é, per atã ci dien italisht, ka gni hére kéna mé sjélle édhë perkethimin ne két ghuhe, ci e bân Xoti Gualtieri".

Shkrimi paraprind 36 vargje të "Milosao"-s (Kënga e parë), të pajisura me 34 shënime.

(1.Vijon nga numri i kaluar ; 2. Pjesa e paré e studimit në "Albania", 1905, 1, nuk e ka emrin e autorit; këtu firmoset nga Lek Gruda, pseudonim i Luigi Gurakuqit)

Rileggendo "Alcune poesie di De Rada" II, "Albania", nr. 2, anno 1905, pp. 43-45. "Milosao" é una delle opere piú

importanti della letteratura albanese del secolo XIX. De Rada ha scritto quest'opera quando era molto giovane. Vi troviamo i temi ed i motivi delle opere successive dell'autore. Nel saggio dell' "Albania" "Milosao" viene messo al primo posto: "Tra gli scritti innumerevoli, sia in versi, sia in prosa, che creò la mente prolifica del compianto De Rada, in più di 60 anni di lavoro ininterrotto, quello che merita il primo posto, è, senza dubbio, il poema idilliaco "Milosao", che lo pubblicò nel 1836 quando aveva solo 22 anni". Per rafforzare questa tesi ricordiamo i numerosi ed importanti studiosi che hanno valutato molto positivamente l'opera. Si tratta di studiosi albanesi, ma anche di stranieri: "Grandi scrittori e studiosi famosi, nostri connazionali e stranieri, hanno dato valutazioni positive. Un letterato francese scrive così all'autore: "Votre jeune 'Milosao' a toute la fraîcheur et toutes les beautés de l' 'Aminta' du Tasse", ed il signor N. Tommaseo gli scriveva: "Del nuovo e dell'antico è nelle parole di Lei come Chi osserva e sente la verità".

Le citazioni delle valutazioni date terminano con Lamartine: "Senza andare oltre, mi pare che siano sufficienti le parole del famoso poeta Lamartine, il quale, dopo averlo letto, volle manifestare a De Rada la stima che aveva nei suoi confronti tramite questa lettera: "Monsieur, je suis heureux de ce signe de fraternité poétique et politique entre vous et moi. La poésie est venue de vos rivages et doit y retourner...".

L'elemento autobiografico è presente perché l'amore del protagonista del poema è l'amore dello stesso De Rada, e l'ambiente descritto nell'opera è il paese natio dell'autore in Calabria: "Nel poema 'Milosao' De Rada cantava la storia di un giovane, che aveva questo nome, e ci dice che era il figlio del despota di Scutari; ma in verità, non fa nient'altro oltre al fatto che raccontare i sentimenti del suo cuore, che, nel momento in cui scriveva, era innamorato di una ragazza, che egli chiama "é bija é Kologrées". – Anche i colori del paesaggio non sono quelli di Scutari e dell'Albania reale: chiunque si è trovato qualche volta, come me a Macchia della Calabria, che é il

(ec te faqja 25)

Rrëfiemeza e gjindjes që kulton si zū t'paren hër ndë jet këshilli pjeqvet urt

transkriptoi Agostino Giordano

ka Purçilli (Cs)

Kjo poezi - *Rrëfiemez*, si e thërret autori -, e pabotuar, gjëndet mbrënda njëj fletorje, cm.10,5x15, që numëron 40 faqe, të panomurara ka autori, e që përmban këto poezi: faqe 1-20: *Rrëfiemeza e gjindjes që kulton si zū t'paren hër ndë jet këshilli pjeqvet urt*, datë 11-3-1898, 49 sekstina, dmth. 294 vargje, njëmbëdhjetërokësh, rimë ABABCC; faqe 21-27: *Rrëfiemeza të bgatit që kirkonej mos ish çafkuer ka Vdekja*, datë 13-3-1898, 15 sekstina, dmth. 90 vargje, njëmbëdhjetërokësh, rimë ABABCC; faqe 27-28: *Rrëfiemeza Noés që së stisnej për se kish vëdis e shpia s'i vlenej*, datë 13-3-1898, 2 sekstina, dmth. 12 vargje, njëmbëdhjetërokësh, rimë ABABCC; faqe 28-29: *Jëma Shën Pjetrit*, datë 13-3-1898, 4 sekstina, dmth. 24 vargje, njëmbëdhjetërokësh, rimë ABABCC; faqe 30-33: *Zoti e i jati*, datë 15-3-1898, 6 sekstina, dmth. 36 vargje, njëmbëdhjetërokësh, rimë ABABCC; faqe 33-40: *Uria di vlezervet*, datë 18-3-1898, 18 sekstina, dmth. 108 vargje, njëmbëdhjetërokësh, rimë ABABCC.

Një herë - na rrëfien kjo poezi - njerzit, si errëjen gjashtëdhjetë vjet kish të vdisjen ,sepse s'kishin më fuqi, s'vlejin më. E kështu i vëjnin tek varri prej s'gjalli, me një kravele bukë e një tarandine uj, njera kur vdisjen. Kjo ish lexha. Po njëj biri i dhisplëqei të vrit këshu të jatin, e e la të rronij. Kur erru një zi bukje (caestia), mbreti, për t'i jipë të ngrënë gjindjes së tij, i vu t'shërbejen e të piksjen për të një qerre, me kuel, guri, e pra edhe një ari : e këtë taksi t'ja jipë kuit i thonj sa rrij, ndë kish të shitej. Mosnjari e diji të ja thonij, po vetëm ai që kish mbajtur të jatin të gjallë...

1. Pjelashtit tån, që gjellen tire shkojen ktu-ktjë, māj stist si hūnj qanduer, e me gjindt, kuj pirpiqshin, kish luftojen nd'i mbararjen të shkojen, tue kirkuer jaxhīn gjetk, tek i ndit më mīr të rrijen, zakōn, që posht rrëfiejmi, t'eger kijen.

2. Për se pjeqet ndë t'luftuerit s'i vëlejen, po i mbararjen më shpejt, se s'kīn fuqit të ecjen e t'rrangarjen e ngrah t'qelljen, sa ngisjen trizetvjet pa lipisī pres 'gjalli ndë varrt të vdisjen i mbullijen me një kravele e nj'botez pjot të pijen.

3. Vdisjen kështu pahīr të mjerit pjeq, pār të furmnojen së ngrēni e së piri që mbān i vëjen t'bilt të egjer dreq. Ndër aq pa zëmer fare gjindsh të miri, u ndodh një bir, që s'dish me zëmer djalli të vëj ndë varrt të jatin po pre s'gjalli.

4. Se t'e mbanej, ndonj bute e vū t'rrij mīr Me ajer e me paq. Ndë shpizet tij E qellnej si t'i ngit një t'miri bir; mbrēnda atjē bēn e hāj si dōj e t'pāj. Trashigohshin kutjend të di si ishen e lesen eger fare mbrēj të kishen.

5. Qet e lē ndēnj i jati pjak shūm vjet nd'at bute t'rrujulluer sikur kish vēr. Si erth që buk s'u bē ndonj mot të shkret e gjindja të kalarej sāj kish vrēr, mbreti që ruenej lesen keq mbrej pjeqt, me gjindjen tij dish qellej si të dreqt.

6. T'bē t'shurbejen, të gjilljen gjindt do t'bējen një qerre guri t'madhe me kuel guri. U strostin tue shurbier gjith se t'errëjen t'e piksjen, kështu mos vëdisjen uri.

S'errun, si mbreti dōj, tue cambatuer të piksjen qerren madhe ndonj zop gūr.

7. Mbreti ahiera bēn e i lostin ndonj cop ār një qerre me gjith kuel, sāj së dihej vëlenej. Taksi kēt ai të jār kūj të gxarnej sāj rrij ndē kish të shitej. Valirat ku do kish ai gjind dirgōj të thojen, që për qerren mbreti dōj.

8. Rrangartin gjindja gjith ku mbreti I prit t'i gjegnej, që për qerren ari thojen. Nganjē ja vëj si zēmera e koca i fjit. Harē mbreti kish se shkarpalojen, e kështu qerrja aret i qindronej atj. që më se gjellen e sit donej.

9. "Dua t'vete edhe u, mōj tat, t'e shō Si është kjo qerre e bēn e bukur shūm; mund jipet të gëxarenj, nd'Inzot do, sa rrī, e u t'e marr të bëhem lum. Çë thua, ti tat? Të vete si gjith vān, e t'thom një fjal dhe u si gjith ç'e pān?"

10. Herehēr mund bjēr se u, si do pak dī, t'i bie mbē të e mbretit thom sa vlen. Si thua ti, tata im, që helmuer rrī Ktu mbillur, nengu t'ishe i eger qen? Dua t'vete, më sa vlen të thom t'e shoh, tek ē shurbes i math, që s'shtien me pjēh".

11. Ktu jati ju përgjegj:"Ti,bir, ç' do t'thucē mbi qerren aret, që po mosnjari ndër aq çë vān, që s'ishen një të mrrueç, mundtīn të gxarjen dreq po sāj ajo rrī. Ka shpia mos m'u tund e rri mbān mua, se ndē ti keq më kē, që t'rronj më dua?"

12. "Jo,tat, se u kam vete, po më mso si kam qellem e kam thom të dal mbē krie,

të vlerit qerres aret ' bie mbē të.

M'e thuej, se mos një i urt māj mund e die. Si ti m'e dī e për mandāj të mbānj sāj s'është petk ksāj gjellje mundē t'ndānj".

13. "U, bir, të thoja t'rrije e mos të veje... pa poka që t'e helq të duaç të veç, ti ec e qasu qerres e mīr vreje: pra ec mēnjān e fol me gjindjen veç. I piej sa e vūn kush më pār e pān, e si ka mbreti gjith të mbajtur jān.

14. Sa gjegjen të thēnet gjithve, ti t'u afrō mbretit e thueji:'Zot, si gjith, dua t'thom edhe u mbi qerren aret gjē, ndē do'. Nd'ai të mbjethet si kush atj s'mëshon, e t'thot 'Thuej që do, se dua të t'gjegjenj', ti ju përgjegj:'Ktu erdha të t'bēnj gjegjen.

15. Erdha ktu edhe u të shoh kēt hjē qerresh, që më s'u vrēj gjith pikst me ār. Njo sa e bukur shkiljen! Kam t'i vēr mīr, pār se t'thom sāj vlen e sāj denār duhej të mund paguhej si t'i nget, se është shurbes që më s'u piks ndē jett.'

16. Pra thuej:'Kjo qerre vlen sāj mund vëlejen Dī herez shī ndē Prill e një ndē Māj'. Bir, vet kjo e thēn për qerren thot të dreqen. Mos thuej më ndrishe, se mbē të ti māj mund i bieç, e kam bes, se vet kjo e thēn mbi t'thēnat tjera ngrēhet pa të rrōn".

17. Sa gjegj ka i urti pjak e prind ç'kish thōj të gavnjenej qerren aret, që vëlenej sāj mosnjari mund dīj, se mbretit mshōj shūm t'e piksjen, dish nisej se të venej tek qerrja aret ndējtur zburkonej, mbi të që prindi pjak i msōj të thonej. (...)

Viti 1968 dhe depërtimi i nocjonit Kosovë tek Arbëreshët

Zef Chiaramonte

nga Sëndahstina (Pa)

Në Kosovë studentët dalin në demonstrata. Policia lëndon dhe burgos.

Lajmi piku në "aula magna" të Fakultetit, ku, siç për çdo vit, Arbëreshët kremtonin Ditën e Flamurit.

Atë vit kremtonin edhe 500-vjetorin e vdekjes së Skënderbeut dhe mysafirë kishën ardhur me shumicë shqiptarët nga Amerika, të cilët në prill po të të njëjtit vit kishin marrë pjesë në kremtimet madhështore për Fatosin Kombëtar të organizuara në Romë e në Vatikan nga kërret e Kishës Arbëreshe.

Kësaj radhe programi shkencor në Palermo përfshinte edhe tre referues nga Jugosllavia¹.

Lajmi i demonstratave u prit me habitje nga pala amerikane ashtu si nga pala jugosllave, kurse arbëreshët mbetën pa emojone: nuk dinin se ç' ishte Kosova!

Gjatë verës së vitit 68 malli për një çupë më kishte sjell prej Romë në Milano, ku në sheshin para katedrales gotike, Duomo di Milano, e kishim lënë takimin.

Si përherë isha në vend shumë më herët dhe shëtisja duke parashijuar momentin e përqaimit.

Një i ri m'u afrota duke më folur anglisht. Ishte ai viti i dukurisë "hipi" dhe aty për aty e ndjeva vetën të bezdisur nga një i panjohur që më largonte nga mendimet në të cilat isha zhytur. Por ai nguli këmbë, dhe kur e pyeta se kush ishte m'u përgjigj: "I am an albanian jugoslav!"

Si në ëndërr m'u kujtua se nga priftërinjtë arbëreshë dhe nga profesor Koliqi² kisha dëgjuar se në Jugosllavi jetuakan shqiptarë. Menjëherë ia filluam shqip, unë, me të vërtetë, arbërisht.

"Por pse - e pyeta - m'u jeni drejtuar pikërisht mua në mes kësaj tollovie?"

"Pse ju keni kokë shqiptare - m'u përgjigj - dhe me shokët e mi kemi bërë bast se kush ishte më i zoti ta diktojë një arbëresh përbrenda këtij sheshi".

Pastaj më njohton me shokët e tij, të gjithë studentë nga Shkolla e Lartë Pedagogjike në Pejë, në mos gabo, në mes të cilëve, vite më vonë, do të ndeshesha me profesor Memduh Begollin, kësaj radhë si ushtrues i gjuhës shqipe.

Nga ky takim filloi një shkëmbim letrash me të riun që kishte fituar bastin.

Prej tij mora edhe një pako me molla dhe këshenja dhe me dy romanet: *Kur pranvera vonohet* dhe *Sikur t'isha djalë*.

As në Milano as në letra nuk u fol kurrë për popullatën shqiptare në Jugosllavi, por nga fillimi i '69-es letrat nuk vinin më nga Kosova por nga Banja Luka. Atje miku im vazhonte studimet universitare sepse në Kosovë, më thoshte, situata nuk ishte e volitshme.

Me të u takova edhe një herë në 76-en, vitin e parë kur erdha në Kosovë. Kësaj radhe ai më foli haptas për problemet e rënda që i brengosnin shqiptarët e këtuajt dhe më parafytyroi sa do të ndodhte. Këtë e bëri me sigurinë e një profeti për fitoren e fundit. Dhe tani lindet pyetja: çka po dinin shumica e arbëreshëve për Kosovën në vitin e ngjarjeve që sot jemi këtu për t'i kremtuar?

Para se t'i përgjigjem kësaj pyetjeje më lejoni të kujtoj shkurtimisht lidhjet e pandërprera e Arbëreshëve me botën shqiptare nënë.

Siç dihet shpërnguljet arbëreshe në Itali patën dy vija kryesore.

Njëra, ajo e fisnikëve, u vendos nëpër qytete dhe oborre princore të Italisë dhe shpejt u shkri. Tjetra themeloi ishuj shqipfolës aty këtu në mbarë Italinë e Jugut dhe në Siqeli. Ato koloni arbëreshe, që sot i quajmë pakica gjuhësore, u mbështetën në dy elemente identifikuese: gjuha e tradita zakonore dhe tradita kishtarë bizantine.

Elementi i dytë, përbrenda politikës mbarë krishterë të Kishës së Romës, i ngriti arbëreshët në rangun e ambasadorëve, karshi Lindjes, të idealit për njësimin e kishave.

Për mes misionëve në Shqipërinë e Jugut të murgjeve dhe priftërinjve arbëreshë, lidhjet me trungun nënë nuk u ndërpreën gjatë shekullit 17 e 18.

Në këtë kuadër arqipeshkëvi Kazazi, e njoftoi atë Gjergj Guxetën mbi kopjen e *Mesharit* që kishte parë në Romë. Ky njoftim, siç dihet, përfundoi me zbulimin e veprës së Buzukut nga Imzot Pal Sqiroi në vitin 1910.

Tërë koha e Rilindjes, duke filluar nga De Rada, përshkohet nga frymëzimi arbëresh, kurse politikanë italianë të rangut të lartë që rridhnin nga radhat e Arbëreshëve, siç është Frano Krispi (Francesco Crispi), mendonin për pavarësinë e Shqipërisë, kur këndej flitej për autonomi brenda Perandorisë osmane.

Dhjetë vjet para shpalljes së pavarësisë, Ismail Qemali pati bërë një udhëtim në Palermo ku u mirëprit nga Arbëreshët me në krye Fran Muzakën (Francesco Musacchia), kryetarin e lidhjes Italo-Shqiptare. Ky i fundit mori pjesë me poetin Zef Sqiroin dhe arbëreshë të tjerë në Kongresin e Triestes (1913), ku u shqyrtua platforma shqiptare për Konferencën e Londrës.

Pas Konferencës së Londrës interesimi i Arbëreshëve u përqendrua te trojet e Shtetit shqiptar, duke lënë në hije Kosovën. Kjo bëri që për ato troje informimi u dobësua ose mungoi krejtësisht ndër arbëreshët gjatë pjesës së parë të shekullit të kaluar.

Sidomos pas fashizmit dhe instaurimit të diktaturave komuniste në Jugosllavi e në Shqipëri nuk u fol më për Kosovën. Kontaktet ishin të ralla midis arbëreshëve dhe shqiptarëve, përveç ftesave zyrtare që vinin nga Shqipëria vetem për persona të caktuara ose për grupe folkloristike.

Rrugën e Kosovës do ta hapte Vorea Ujko, prifti-poet arbëresh Mink Belici (Domenico Bellizzi), me udhëtimin e tij të parë këndej Adriatikut.

Atë do ta ndjekën në mënyrë ideale, dhe më pakë me udhëtime personale, shumica e poetëve arbëreshë, kurse për inteligjencën arbëreshe në përgjithësi, rrugën e Kosovës do ta hapte trenjësisht Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, që nga viti 1974 e këndej.

Pra, si i ndoqën arbëreshët ngjarjet e studentëve kosovarë që përpiqeshin ta ruajnë identitetin e tyre shqiptar?

Ndryshe nga ngjarjet e '81-shit, ato të '68-tës në Kosovë pothuajse nuk janë ndjekur fare nga mjedisi arbëresh në përgjithësi.

Përveç qarqeve kishtarë, akademike dhe të emigracionit politik shqiptar, në fillim të vitit '68, shumë pakë ndër arbëreshët dinin për ekzistencën e Kosovës e jo më për çështjet e lirisë që e brengosnin popullatën shqiptare e rajonit.

Kur gjatë verës së '68-tës televizjoni Italian dha me vazhda filmin

Ulisse, aktori Bekim Fehmiu që luante rolin kryesor, u mor si jugoslav dhe pakkush vëri re se emri Bekim e dëftonte arbër. Ata pakë që e kuptuan nuk e kishën lehtë t'i bindnin të tjerët se ai ishte shqiptar, kështu që më në fund u pajtuan me një kompromis: Bekimi ishte shqiptar po banonte në Jugosllavi!

Jo vetëm tek arbëreshët ngjarjet e atij viti në Kosovë mbetën nën hie. Edhe shtypi italian, i zënë me protestat e studentëve brenda dhe jashtë Italisë si shprehje të kundërthënieve ideologjike, nuk e shënoi si duhet protestën e studentëve kosovarë, problematika e të cilëve ngjyrosej me elemente të natyrës etnike, politike dhe socio-ekonomike. Poashtu vepruan lajmet televizive, atë vit të prirura ndaj ngjarjeve në Çekosllovakë.

Përndryshe, roli iç në Jugosllavi në ekuilibrin botëror të kohës dhe traktatet me Italinë nuk lejojnë hapërsyryrë për të vështuar situatën e brendëshme të Federatës, e cila nga jashtë bënte bujë prej monoliti rreth Mareshalit.

Vetëm në vitin 1966 Franko Benanti, në vëllimin e tij "Lufta më e gjatë: Shqipëri 1943-1948"⁴ sqaronte disa aspekte lidhur me kompromisin shqiptaro-jugoslav rreth Kosovës.

Sot mund themi se ndërkombëtarizimi i njohurive mbi Kosovën u arrit me anë të Seminarit Ndërkombëtar për Gjydhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare të organizuar vit për vit nga Universiteti i Kosovës, dhe prandaj ngjarjet e '81-shit , fal edhe pranisë në Prishtinë të studentit arbëresh Dhimitër Patituçi (Demetrio Patitucci), ndryshe nga ngjarjet e '68-tës, patën jehonë të madhe tek arbëreshët.

Para hapjes së Seminarit agjensitë prej së cilave arbëreshi i rendomt kishte mundësi ta hapë perdën drejt botës së etërve mbeteshin priftërinjt, katedrat e Shqipës në Romë e në Palermo dhe grupe të emigracionit politik shqiptar, poashtu të përqendruara në Romë e në Palermo⁵.

Personalisht u jam mirënjohës këtyre tri agjensive, me të cilat hyra në kontakt shumë herët. Ato patën ushtruar ndaj meje dhe ndaj rinisë studentore arbëreshe të asaj kohe "edukimin sentimental" ndaj mëmëdheut, ashtu që, prej 1968-tës e këndej, gjeneratat e reja kanë luajtur rolin e stafetës kulturore për njohjen dhe dashurinë ndaj Kosovës.

NOTE

¹ Tefik Geci, Olivera Nasteva, Hasan Kaleshi

² Në nderthurje me njoftime të ndryshme për Shqipërinë, i pari që me pati folur për Kosovën ishte i ndjeri papa Gjergji Sqirop. Isha 13 vjeçar.

³ Prof. Ernest Koliqi ka luajtur një rol vendimtar në Itali për përhapjen e njohurive mbi trojet shqiptare. Përveç studentëve të Katedrës së Shqipës, ai ushqente kulturën arbëreshe me anë të ligjirave që u mbante çdo të shtunë pasdite nxënësve arbëreshë të Kolegjit Grek në Romë. Nga frymëzimi i Prof.Koliqit rrjedhin shumica e revistave arbëreshe që dalin edhe sot e kësaj dite.

⁴ Përkthimi është imi, kurse bibliografia italisht e bie: Franco Benanti, *La guerra più lunga: Albania 1943-1948*, Milano: Mursia, 1966.

⁵ Kisha Arbëreshe, me shkollat e saj lokale (kujtohen Kolegjet në Shën Mitër Korone të Kalabrisë dhe në Palermo të Sicilisë), me Gjymnazin në Manastirin e Grotaferratës dhe me Kolegjin Grek të Romës, ka mbajtur gjithnjë të gjall kujtimin e Moresë si toposin shpirtëror të prejardhjes arbërore dhe bizantine.

Poashtu: Universiteti i Romës me në krye Prof. Ernest Koliqin dhe Prof. Zef Sqiropin (albanolog dhe bizantinolog); Universiteti i Palermos me në krye Prof. Papas Gaetano Petrotan dhe Prof. At Zef Valentini-n; Emigracioni politik në Romë me në krye Prof. Vasil Andonin, Dr. Nos Qirjakun, Sulejman Meçon; Emigracioni politik në Palermo me në krye Vëllezërit Gjokmarkaj,

Kolonel Lazër Bojaxhiun (të vellaun e Nën Terezës) dhe Dr.Maxhunin.

Rol të veçantë ka luajtur me 1968 Qendra Ndërkombëtare për Studime Shqiptare pranë Universitetit të Palermos në përgatitjen e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Ato kretime hapën horizonte të reja për arbëreshët dhe ndërkombëtarizuan identitetin e tyre.

Të trashëgimi e ringjallies së ndjenjave arbëreshe, që i patën zgjuar kremtimet e Skënderbeut, duhet vështuar angazhimi kulturor që ushtron gjithnjë, prej atij viti dhe deri sot e kësaj dite, rrethi Besa në Romë, nën udhëheqjen e mons. Elefter Fortino-s, famullitar për arbëreshët e kryeqitëtit dhe zyrtar i lart i Vatikanit.

Era il 1968. nell'aula magna dell'Università di Palermo gli Arbëreshë celebravano il Giorno della Bandiera, nonché il 500° anniversario della morte di Skanderbeg. Erano stati invitati molti albanesi d'America e tre relatori jugoslavi. Arrivò la notizia che in Kosova gli studenti protestavano e la polizia incarcerava. Jugoslavi e albanesi-americani si stupirono; gli Arbëreshë no: non conoscevano la Kosova.

Nell'estate del '68 mi trovavo a Milano, davanti al Duomo: dovevo incontrarmi con una ragazza. Li conobbi un albanese kosovaro, e i suoi compagni, tutti studenti della Scuola Superiore Pedagogica di Peja; e qualche anno dopo avrei conosciuto prof. Begolli, esercitatore di lingua albanese.

Da quell'incontro iniziò uno scambio di lettere col kosovaro che mi aveva contattato a Milano. Dal quale seppi, nel '69, che in Kosova la situazione andava complicandosi. Con lui mi incontrai poi nel '76, quando venni per la prima volta in Kosova e seppi della reale situazione in cui versava.

Cosa sapevano gli Arbëreshë di quello che stava succedendo qui in Kosova, succedendo nel '68? Prima di rispondere a questa domanda, vorrei fare un po' di storia. Gli insediamenti arbëreshë in Italia seguirono due linee. Quella dei signori si sistemò nelle città e corti principesche d'Italia e presto scomparve; l'altra fondò isole albanofone in tutto il meridione; e si basarono su due elementi identitari: lingua-tradizioni etniche e rito bizantino.

E da allora gli Arbëreshë servirono alla Chiesa di Roma come ambasciatori di ecumenismo con l'oriente: lungo i secoli XVII e XVIII i contatti con la madrepatria non si interruppero. Poi gli arbëreshë cominciarono a pensare all'indipendenza dell'Albania, mentre gli Albanesi pensavano, sì, alla propria indipendenza, ma all'interno dell'impero ottomano.

Dopo la Conferenza di Londra, l'interesse degli Arbëreshë si concentrò sull'indipendenza dell'Albania, escludendo la Kosova. Questo comportò un black-out sulla Kosova nella prima metà del Novecento. Dopo il fascismo e l'instaurazione delle dittature comuniste in Jugoslavia e Albania, non si parlò più di Kosova. I contatti, tra gli arbëreshë e gli albanesi, erano rari e solo attraverso inviti ufficiali o per gruppi folk.

La strada della Kosova l'avrebbe aperta Vorea Ujko (papas Domenico Bellizzi), sacerdote-poeta, negli anni '60, a cui seguiranno altri poeti arbëreshë; ma la strada della Kosova l'avrebbe aperta radicalmente il Seminario Internazionale sulla Lingua e la Cultura Albanese di Prishtina, dal 1974 in qua. Le dimostrazioni degli studenti kosovari dell'81 furono seguiti dagli Arbëreshë, a differenza di quelli del '68.

A parte i circoli ecclesiastici e dell'emigrazione politica albanese, all'inizio del '68 gli Arbëreshë non sapevano neanche dell'esistenza della Kosova. Bekim Fehmiu, il protagonista kosovaro del film Ulisse (1968) dai più si conosceva come albanese della Jugoslavia. Ma la stessa stampa italiana - distratta dalle proteste studentesche italiane e dai fatti di Cecoslovacchia - non seguì le proteste degli studenti kosovari.

Nel 1966 Franco Benanti, nel suo libro "La guerra più lunga: Albania 1943-48" aveva chiarito alcuni aspetti del compromesso albanico-jugoslavo sulla Kosova. Oggi possiamo dire che si arrivò all'internazionalizzazione delle notizie sulla Kosova, nell'81, attraverso il Seminario di Prishtina e grazie allo studente Demetrio Patitucci. Questo sì che ebbe grossa eco tra gli Arbëreshë.

Sono comunque personalmente riconoscente ai preti, alle cattedre di albanese delle Università di Roma e Palermo a gruppi di emigranti politici albanesi se ho conosciuto, prima e meglio di altri, le reali condizioni della Kosova. Sia verso di me, sia verso la gioventù studentesca dell'epoca, esercitarono un'educazione sentimentale verso la Madrepatria e mi fecero conoscere e amare la Kosova. (Redaz.)

Kosova dhe letërsia shqipe

Fatmir Halimi

shkrimtar dhe gazetar nga Prishtina (Kosove)

Duke i anashkualuar shkrimet e para në gjuhën shqipe si letërsinë filobiblike, letërsinë e bejtegjinjëve etj., letërsia e mirëfillt shqipe zhvillohet në periudhën e rilindjes kombëtare apo në periudhën e romantizmit shqiptar. Kjo letërsi që zhvillohet në këtë kohë mund të themi se përfshin Shqipërinë brenda kufijve të vet dhe letërsinë e diasporës shqiptare. Tema bosht e kësaj letërsie ishte çlirimi kombëtar, ngritja e vetëdijes kombëtare, ngritja e ndjenjës së atdhedashurisë etj, ide këto të nxjerrura nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Pas kësaj kemi periudhën e independencës, që kritikët letrarë e quajnë realizmi kritik. Është koha kur populli shqiptar e fiton pavarësinë, e jashtë kësaj pavarësie mbeten shumë troje të saj, si Kosova, shqiptarët e Maqedonisë, të Malit të Zi etj. Për herë të parë këtu zhvillohet edhe historia e letërsisë dhe kritika letrare. Kurse poezia është e niveleve evropiane dhe thuhet se kemi elementet e para të letërsisë moderne, sidomos te poezia e Lasgush Paradecit dhe të Migjenit. Ndërsa Kosova në këtë kohë, pra në periudhën e Realizmit kritik apo si quhet ndryshe edhe letërsia moderne, ishte pa letërsinë e vet. Por si temë, ajo dhe viset e tjera shqiptare do të paraqiten ndoshta për herë të parë në vargjet e Gjergj Fishtes te "Lahuta e Malcis". Pra, Kosova frymon nën okupim, pa krijues të letërsisë, dhe pa letërsi të shkruar, por me një krijimtari shumë të pasur popullore që përcillet tek njerëzit në formë të këngës.

Dy paralelet e letërsisë shqipe: Kosovë, Shqipëri

Duke përfshijtur disa raste individuale si Esad Mekulin e ndonjë tjetër, të cilët me krijimtari letrare ishin marrë edhe me herët, letërsia shqipe në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare që mbeten jashtë shtetit të tyre etnik, u zhvillua pas luftës së dytë botërore. Ajo zë fill me veprën poetike "Një fyell ndër male" të Martin Camajt, më 1953, të botuar në Prishtinë, ku u pasua edhe nga veprat poetike të Esad Mekulit "Per ty" më 1955, e të Enver Gjergjekut "Gjurmët e jetës" më 1957. Kësaj i parapriu edhe dalja e gazetës "Rilindja" dhe e revistës letrare "Jeta e Re", të cilat u bënë promotor për zbulimin e talentëve të rinj në

krijimtarinë letrare. Kjo letërsi zhvillohet krejt e ndarë dhe e shkëputur nga letërsia që zhvillohet matan kufirit. Në Shqipëri, duke përfshijtur dramën "Halili e Hajria" të Kolë Jakovës, të botuar menjëherë pas çlirimit të vendit më 1947, që për ngjarje ka një periudhë historike jo shumë të largët, që trajton temën e flijimit, veprat e tjera që do të botohen në këtë kohë për temë më nuk kanë heroin mitologjik, heroin kombëtar a historik, por një hero të ri të prodhuar nga pushteti, heroin socialist. Pra kemi dy paralele krejtësisht të ndara të letërsisë shqipe. Mirëpo piktakimi i tyre do të arrihet në vitet e 70-ta, ku do të bëhet edhe unifikimi i gjuhës standarde shqipe. Gjatë kësaj periudhe në Prishtinë do të botohet komplet krijimtaria letrare e të gjithë autorëve të periudhës së romantizmit, të realizmit kritik, pa Gjergj Fishtën e Konicën, pasi që ata ishin të përfshijtur edhe në Shqipëri nga historia e letërsisë shqipe. Pos kësaj do të botohen edhe veprat letrare të letërsisë Shqipe bashkëkohore si të Jakov Xoxës, Ismail Kadares, Dritro Agollit etj. që krijonin në Shqipëri. Kështu lexuesi dhe studiuesi kosovar kishte një qasje të gjerë mbi letërsinë që zhvillohej në të dy anët e kufirit.

Fenomenet shoqërore që goditën letërsinë tonë

Në fund të viteve të nëntëdhjeta të shekullit XX, letërsinë tonë e godasin dy fenomene të mëdha shoqërore: në Shqipëri shembja e regjimit diktatorial dhe vendosja e sistemit demokratik në shoqëri harxhoi energjinë e shumë krijuesve, por që pati rezultatet e veta, pasi që aty më nuk do të kemi letërsi të angazhuar nga pushteti por një letërsi të mirëfilltë, me vlera të larta artistike, një letërsi moderne që do të korrespondojë me letërsitë e tjera evropiane. Ndërsa në Kosovë përpjekja dhe lufta për pavarësinë e vendit që rreth vetes mbledhi tërë ajkën e krijuesve letrarë, që për disa individ ishte edhe ndërprerje e krijimtarisë, siç ishte rasti i kritikut letrar Ibrahim Rugovës, i cili për njëzet vitet e ardhshme nuk u muar më me kritikë letrare. Për kundër një komunikimi të gjerë të të dy vendeve në dekatën e fundit të shekullit XX, letërsia shqipe që zhvillohet në Kosovë dhe në trevat e tjera

shqiptare prapë mbeti e panjohur për lexuesin dhe studiuesin e Shqipërisë. Këtë e dëshmon edhe përpjekja e historianve dhe studiuesve të letërsisë nga Kosova që t'i përpilonin tekstet e përbashkëta shkollore për letërsinë shqipe për të dy vendet. Studiuesit nga Shqipëria u pajtuan për tërë letërsinë deri te lufta e dytë botërore, por jo edhe për atë që u zhvillua pas saj. Kjo tregon edhe njëherë për mosnjohjen, apo mosdëshirën për ta njohur letërsinë shqipe të krijuar në Kosovë. Pra, ky është fenomen apo paradoks kulturor që është ende duke vazhduar për fatin e keq të letërsisë shqipe. Mirëpo duke jetuar dhe krijuar në një shekull të ri, me rrethana kulturore e shoqërore krejt të reja, shpresojmë që edhe letërsisë shqipe t'i krijohet një rrethanë e re, një ndërkomunikim i ri, që nxënësi, ashtu si në shkollat e Kosovës, edhe në shkollat e Shqipërisë të mëson njësoj si për poezitë e Agollit, Spahiut, Londos, ashtu edhe për poezitë e Dedajt, Podrimjes, Shkrelit; si për romanet e Xoxës, Kadares, Markos, ashtu edhe për romanet e Rrahmanit, Qosjes e Buxhovit.

La vera e propria letteratura albanese si sviluppa nel periodo della Rinascita nazionale e del romanticismo albanese, e abbraccia sia quella nazionale che quella della diaspora. E il tema centrale di questa letteratura è la Liberazione Nazionale. Poi abbiamo il periodo dell'indipendenza, denominato dai critici "realismo critico". L'Albania raggiunge l'indipendenza, ma Kosova, Macedonia e Montenegro ne restano fuori. La letteratura moderna albanese si esprime attraverso le voci del Poradeci e del Migjeni. La Kosova è senza letteratura, ma di lei parla il Fishta nella sua "Lahuta e Malcisë"; ed è ben rappresentata da dalla poesia popolare. A parte Esad Mekuli e qualche altro, che avevano iniziato già prima, la letteratura albanese in Kosova, e nelle altre zone albanesi fuori dai confini etnici, ha inizio dopo la seconda guerra mondiale. Con M. Camaj, E. Mekuli ed E. Gjergjeku, negli anni '50; senza dimenticare il giornale "Rilindja" e la rivista "Jeta e Re", che si fecero promotori della scoperta di nuovi talenti in campo letterario. Le opere prodotte in questo periodo non hanno per tema l'eroe mitologico, l'eroe

Tris(h)tia në kthim të pandalë

Baviola Shatro, M.A.

(vjen ka faqja 19)

antica, l'arbëreshe appunto: con la quale non solo si parla, ma si scrive letteratura. Non vorrei analizzare qui da che dipende una conoscenza/pseudo-conoscenza così limitata della creatività arbëreshe, ma vorrei soffermarmi su una immagine che si crea dalla lettura, nel tempo, di alcuni noti poeti arbëreshë. Per secoli la poesia arbëreshe ha cantato la Madrepatria lontana e il desiderio di tornarci, ma adesso sembra che sia questa poesia ad aspettare che qualcuno vada da lei. Non è nebbia di leggenda ma una poesia sottile, con molti simboli presi dalla natura che gradualmente si muovono verso livelli più astratti, trasformandosi in chiavi semantiche. Nelle poesie di L.Perrone le parole-chiave delle immagini sono: stella, ombra, notte, ghiaccio, vento, oscurità, farfalla...; In Vorea Ujko sono: sorgente, migrazione, vento, quercia...; e in Kate Zuccaro: freddo, candela, carcere, stelle, raggi, acqua... In A.Giordano si va oltre: lacrime, sogni, occhi, mare, luna, ombre, ulivo, vento... Nella poesia arbëreshe c'è una sensibilità fortemente tratteggiata, con una sua propria indipendenza. In questa poesia della seconda metà del sec.XX mi sembra che venga trattata un'immagine della terra promessa che non è necessariamente una terra, un luogo, ma è la destinazione di una sensibilità creata gradualmente con pazienza soprannaturale dallo stesso tempo dentro l'uomo, e che sembra non riesca a far invecchiare gli ulivi e le viti, simboli particolari, che ho osservato in una poesia di A.Giordano: "Srupi di solitudine/il mio desiderio di conquista/ombra che va cercando un corpo / Sono ramo d'ulivo/che aspetta il vento/per baciare la vite". Sembra di leggere parole di un salmo. E' il passato, una totale eternità, che non ha saputo invecchiare, che afferra gli attimi sfuggenti del tempo desiderando trovare l'origine della vita. Un cerchio chiuso in se stesso, in mezzo all'amore e alla tristezza quasi mitica dell'arbëresh lontano. Il mio desiderio è quello di conoscere quel pezzo di me stessa, di quella poesia albanese, di quella sensibilità di una lingua che vive veramente, e non in sogno o palinsesti antichi. A pochi chilometri da me, nella penisola di fronte. (Redaz.)

Kosova dhe letërsia shqipe

nazionale o storico, ma un eroe nuovo, prodotto dal potere, l'eroe socialista. Negli anni '70 abbiamo poi l'unificazione della lingua standard albanese. In questo periodo, a Prishtina, si pubblica tutta l'opera letteraria degli autori del periodo romantico, ma senza Fishta e Konica, esclusi anche in Albania dalla letteratura albanese. Vengono invece pubblicate le opere di Xoxa, Kadare e Agolli, autori d'Albania. Alla fine degli anni '90 del sec.XX, la letteratura kosovara fu colpita da due grandi fenomeni sociali: il crollo in Albania del regime dittatoriale e l'istituzione del sistema democratico consumò l'energia di molti creativi, in quanto dovevano misurarsi con gli alti valori artistici della letteratura moderna europea. In Kosova la lotta di liberazione nazionale portò molti letterati a

interrompere quasi completamente la loro creatività, come fu il caso di Ibrahim Rugova. Nell'ultima decade del XX secolo la letteratura albanese della Kosova rimase quasi sconosciuta al lettore e allo studioso d'Albania. E questo lo testimoniano anche i libri comuni scolastici sulla letteratura d'Albania e Kosova. Un paradosso culturale inspiegabile che penalizza la letteratura albanese kosovara. Speriamo che in futuro ciò non accada più, e sia nelle scuole kosovare che in quelle albanesi, i libri riportino non solo le poesie di Agolli, Spahiu e Londo ma anche le poesie di Dedaj, Podrimja e Shkreli; non solo i romanzi di Xoxa, Badare e Marko ma anche i romanzi di Rrahmani, Qosja e Buxhovi. - (Redaz.)

Disa vjërsha te Dé Rades

dr. Edmond Çali

(vjen ka faqja 20)

paese dove è nato e dove è vissuto il poeta, può notare la somiglianza che hanno questi luoghi con i luoghi che canta Da Rada nei suoi versi".

Anche se l'articolo che stiamo esaminando non è troppo lungo, vi troviamo trattata anche la questione della lingua, abbiamo una valutazione negativa sulla sintassi e sul ruolo della rima secondo lo stesso De Rada: " 'Milosao' è stato scritto in albanese: la lingua non è molto difficile, ma la sintassi sì; i versi sono settenari e ottonari misti, e sciolti, vorrei dire, senza rima, la quale secondo il parere di De Rada, non ha nessun valore di per sé oltre al danno che toglie la bellezza e la forza dei pensieri".

Veniamo così alla traduzione italiana del testo: non viene consigliata la traduzione eseguita dallo stesso autore, ma viene proposta quella fatta da uno dei primi studiosi qualificati di De Rada, la traduzione di Gualtieri: "Come tutte le altre opere, anche questa, De Rada l'ha tradotta anche in italiano, ma in un modo molto difficile e confuso; dopo di lui l'hanno tradotta anche altri, ma a me la traduzione migliore sembra quella che ha fatto il signor G. V. Gualtieri (Donatello Nive) un giovane italiano, che rimase per 4-5 anni a S. Demetrio Corone, vicino a Macchia, così divenne quasi albanese ed iniziò a stimare De Rada".

La rivista ha l'intenzione di continuare la pubblicazione delle parti migliori del "Milosao", seguite dalla traduzione italiana di Gualtieri, per i lettori che conoscono anche l'italiano. Ma nei numeri successivi non troviamo l'argomento: "Da oggi iniziamo a dare ai lettori dell' "Albania" le parti migliori del "Milosao", e, per coloro che sanno l'italiano, qualche volta forniremo anche la traduzione in questa lingua, fatta dal signor Gualtieri".

Il saggio precede 36 versi del "Milosao" (Primo Canto) muniti di 34 note.

(1.Segue dal numero precedente; 2. La prima parte del saggio in "Albania", 1905, 1, non porta il nome dell'autore; qui il saggio è firmato da Lek Gruda, pseudonimo di Luigi Gurakuqi)

JETA
ARBËRESHE
(abonim)
+
FJALOR
i Emanuele Giordano-s
=
40 €

Gjurmë të Arvanitishtes në greqishte

dr. Dhori Q. Qirjazi

lektor i gjuhësisë historike, Universiteti i Selanikut (Greqi) kyrdoris@lit.auth.gr

Në këtë shkrim, në frymën e shkollës *Fjalë dhe Sende* (sivjet mbushen plot njëqind vjet nga numri i parë i revistës *Wörter und Sachen*), do të rrekemi të shohim si është pasqyruar bota shqiptare, përkatësisht arbërore, në botën greke, kryesisht në gjuhë dhe nëpërmjet gjuhës.

Prof. A. Xhuvani (*Vepra*, II, f. 369) vërente me të drejtë se “*Shqiptarët nuk formuen ndonjëherë në histori një shtet unitar, pra nuk ushtruen kurrë një zotnim mbi popujt përfaq, i cili të sillte me vehte edhe një përhapje të gjuhës shqipe; pastaj nga pikëpamja kulturore shqiptarët nuk zhvilluen gjatë historisë së tyre një kulturë ma të naltë nga të fqinjëve, prandaj edhe elementet e shqipes te këta nuk janë të shumta*”.

Megjithatë, në të folmet e greqishtes së sotme ka ende lëndë të pazbuluar të shqipes, kryesisht të sferës materiale, rrjedhojë e kontakteve të drejtpërdrejta dhe të kahmotshme të këtyre gjuhëve në territoret ku ato ndërkalen pa e humbur vazhdimësinë me trungun mëmë, si dhe në ngulimet e arbërve të Greqisë, ku arvanishtja haset në formë enklavash rrethuar prej mjedisi greqishtfolës.

Mbërritëm kësaj në dy burimet kryesore prej nga lënda e shqipes ka hyrë në trup të greqishtes. Nga i pari (të folmet toske të Shqipërisë së jugut) kanë depërtuar fjalët kryesisht të sferës blegorale (κουρίζα *kuriza* ‘shtylla kurizore e kafshëve të imta’, σιλίρα *silira* ‘shëllirë’, μπρούτσα *brúca* ‘bërruc’ etj.), por ajo që e dallon këtë grup janë fjalët gramatikore (vot *dot*, vtóti *dóti*, vtótis *dótis* etj.). Ja edhe disa shembuj të tjerë: në Náusa një lloj shege quhet αλμπασάνικα *albasánika* (<Elbasan), ndërsa një lloj orpinge quhet λιάπικου *liápiku* (<lab). Në Janinë πίγγες *pingjes* quheshin orpingat e shqiptarëve dhe shpeshherë vetë shqiptarët. Në Pílion αρβανίτης *arvanítis* quhet një varietet molle; në Pieri μπιράτ’κος *birátkos* (<Berat) është emri i një lloj valleje, kurse αλβασάν’κος *albasánkus* i thonë kasolles së ndërtaur me dërrasa dhe jo me shufra të thurrura. Në anët lindore të Pindit (Thesali, Maqedoni) gjejmë fjalët τουντς *tunds* ‘tundës, vegël që përdoret në mulli’, κομπόρα *kombóra* ‘këmborë’, αρναούτι *arnaúti* ‘grurë me hala të dendura’, γκούρα *gúra* ‘gurrë’, μπρίμι *brími* ‘burimth në anë të lumit’ etj. etj...

Grupi i dytë, me një numër më të kufizuar fjalësh, paraqet megjithatë interes të madh, ngaqë si të thuash përbën portretin moral të shqiptarëve. Ndaj nuk është e rastit që fjalët μπέσα *bésa* dhe μπαμπέσης *babésis* (<i>pabesë) i takojnë sot mbarë greqishtes. Ajo që grekët prej kohësh e kanë quajtur arvanitiko κεφάλι *arvanitiko qefáli* ‘kokë shqiptari’ duket në shprehjet άστου ντούε *ástu dúe* (<ashtu due) dhe με το παίρι *me to páiri*. (<me pahir). E para ka shtrirje më të gjerë, e hasim edhe në ishujt

e Egjeut, kurse *me to páiri* ndeshet më tepër në anët e Epirit, si edhe në Korfuz. Përmbri këtyre radhitet edhe fjala γκέγκε *gégge* ‘kuptove, more vesh’ (< gjegjem), e shpeshhtë në zona me prani arvanitësh.

Nga një rajon jo aq i eksploruar për gjurmë të shqipes, nga zona e Thesalisë dhe e Maqedonisë, na vjen fjala τεγκόρδε *tenkórdhe* ‘vdekje’ (<të ngordhë), që mund të përfshihet në të njëjtën sferë. Këtu hyjnë edhe fjalët παγκόι *pagóι*, παγκούι *pagúι* dhe παγκούι *pagúι* ‘paguaj me para në dorë’ (<pagoj, paguej). Fjala κourβελέσι *kurvelési* ‘shamatë, zallamahi’ dhe κourβελιό *kurvelió* ‘zhurmë, potere’ duket se kanë lidhje me krahinën e Kurveleshit, prej nga lebërit zbritnin për të plaçkitur në trojet greke. Një shprehje tjetër është edhe μάλε βράσε *mále vrásē* ‘zallamahi, e keqe e madhe’, me shtrirje të gjerë, që shpjegohet kënaqshëm me mjetet e shqipes (< arvanitist e *malle vrasje* < shqip *vrasje e madhe*).

Stereotipi i shqiptarit pasqyrohet edhe në kuptimet metaforike të fjalëve αρβανίτης *arvanítis*, γκέγκας *gégas*, λιάπης *liápis* etj. Fjalori Historik i Greqishtes së Re (FHGR) për Arvanitët *Arvanítis* jep kuptimet ‘shqiptar’ dhe (fig.) ‘sherrxhi, gjaknxehtë, kokë mushkë, dinak etj.’, ndërsa Γκέγκας *Gjékas* ‘banor i Shqipërisë së Veriut’, gjithnjë sipas FHGR, përdoret për ‘të pagdhendurin, kokëshkëmbin, hakmarrësin. Ka gjithashtu kuptimin e njeriut të besës, të shtatllartit, të të pastrait etj. Kështu quhet edhe një lloj qeni gjuetie’. Në të folmet e Epirit γκέγκας *gjékas* quhej edhe personi që gatiste dhe shiste sheqerka. Pranë këtyre gjejmë edhe disa emra karakteristikë si Γιουλέκας *Gjulékas* ‘i panështruar, i pamposhtur’, por shprehja κάνει το Γιουλέκα *káni to Gjuléka* ‘hiqet si Gjoleka’ përdoret për burracakët. Emri Βελιγέκας *Veligjékas* (<Veligega) në mendësinë greke është sinonim i njeriut kokëtrashë.

Duhet thënë ndërkaq se në folklorin grek e në të folme të veçanta këto fjalë apo të tjera të ngjashme me to i gjejmë edhe me kuptime a ngjyrimet pozitive: μούρας *búras* (<burrë) i thonë trimit; ndërsa σκιπετάρι *sqipetári* (<shqiptar) quhet ‘burri i hijshëm’. Në një fjalor të së folmes së Kosturit shënohet se *gegët* njiheshin si ‘punëtorë, të ndershëm e të padjallëzuar’, kurse në anët e Volosit γκέγκας *gjékas* i thonë atij që punon shumë dhe është këmbëngulës. Në fshatin Livadheró (Mókro) të Kozanit, njëra nga këngët që i këndohet nuses është edhe kjo: -Κόριν, αρβανιτοπούλα// κι αρβανιτοθυγατέρα,// πού τα βρήκες τόσα κάλλη// κι άλλην τόση ουμουράδα; (*Kórin arvanitopúla// q’ arvanitothighatéra,// pu ta vrikes τόσα κάλλι// q’ álin τόσι umurfáda?*) [Ti, moj vashëz arvanite// arvanitase, moj bij// ku i gjete, vall’, kaq hire// atë nur e bukuri?].

*Il prof. A.Xhuvani osservava come il popolo albanese non avesse storicamente mai formato uno stato unitario e mai dominato sui popoli vicini, e ciò comportò la poca diffusione della lingua albanese; e, non avendo sviluppato una cultura superiore ai popoli vicini, poco presenti sono, in questi popoli, gli elementi di lingua albanese. Ciononostante, nella lingua greca, specie nella sfera materiale, ci sono tracce albanesi, conseguenza dei contatti tra i due popoli e dei molti insediamenti albanesi in terra greca. Perciò sono penetrate nel greco parole della sfera pastorale. (Per es.: κουρίζα *kuriza* ‘shtylla’, colonna vertebrale dei piccoli animali; σιλίρα *silira*, ‘shëllirë’, salamoia; oppure κομπόρα *kombóra* ‘këmborë’, campana; αρναούτι *arnaúti*, ‘grurë me hala të dendura’, grano con lische folte; γκούρα *gúra* ‘gurrë’, sorgente). Un numero più ridotto di parole albanesi le troviamo nella descrizione morale degli albanesi (Per es.: μπέσα *bésa*, giuramento; μπαμπέσης *babésis* <i>pabesë, infedele) oppure lo stereotipo dell’albanese in senso figurativo, ma peggiorativo (Per es.: Αρβανίτης *Arvanítis*, ‘shqiptar’, albanese, (fig.) rissoso, attaccabrighe, furbo). Ma ci sono anche parole che mantengono significato positivo (Per es.: μούρας *búras* (<burrë), valoroso; σκιπετάρι *sqipetári* (<shqiptar), albanese, nel senso di uomo avvenente). (Redaz.)*

Shqiptarët e Ukrainës

dr. Larisa Kaminskaja, Aleksandër Novik

Universiteti i Petroburgut (Rusi)

Përshkrimi i sistemit fonologjik të të folmeve të shqiptarëve të Ukrainës përfaqëson një rendësi të veçantë në kuadrin e studimit të përgjithshëm të fshatrave shqiptarë të Priazovjes, të rrethit të Zaporozhjes të Ukrainës. Këta fshatra janë: Gamovka (ish Xhandran), Devninskoje (ish Taz) dhe Georgievka (ish Tyshki). Historia e studimit të anës tingullore të të folmeve të Priazovjes (dhe me gjerë – të Ukrainës) filloi në vitet 50 – 60 të shekullit të kaluar. Përshkrimin e sistemit fonetik dhe fonologjik të të folmeve të shqiptarëve të Ukrainës, që e pasqyrore situatën gjuhësore të viteve 50 – 60 të shekullit XX, mund ta gjejmë në punimin e L. Demkosë (Demko 1972) dhe të Kotovës (Kotova 1956).

Në studimet e tyre ishin vënë në dukje veçoritë fonetike e të folmeve, tipare të përbashkëta dhe dallime midis të folmeve të shqiptarëve të Ukrainës dhe të folmeve shqipe të Shqipërisë dhe të Bullgarisë. Një krahasim i tillë ishte lidhur me çështjen e lidhjes gjenetike e të folmeve të Priazovjes me ndonjë zonat përkatëse dialektologjike të Shqipërisë.

Kështu N.V. Kotova (Kotova 1956: 254 – 255) dhe Shirokovi vërejnë se shqiptarët në fshatin Karakurt (me vonë një pjesë e tyre shkoi në Priazovje) mbërritën nga zona veri-lindore e Bullgarisë. Ndërsa në Bullgari – nga zona toske jug-lindore (Shirokovi 1964: 53).

Duhet vërejtur, se A.V. Desnickaja (Desnickaja 1968: 375) e lidh të folmen e shqiptarëve të Ukrainës, që shfaq disa tipare të reja, me tipin dialektor të zonës veriore toske në gjendjen e tij arkaik. Si tipare relevante arkaike Desnickaja e dallon ruajtjen e grupave të bashkëtingëlloreve kl', gl', l'k, l'g, dhe l'-në e palatalizuar në pozitën intervokale: klumësht, gjuhë, ulk, ndëlgon, bile, gole. Po ashtu ajo dallon ruajtjen e rregullt të tingullit 'ë' /«/ në rrokje të patheksuara.

Si tipare të reja inovative Desnickaja vë në dukje monoftongizimin e diftongjeve: ua>u, ye>y, ie>i: gru (<grua), du (<dua), muj (<muaj), kry (<krye), dyr (<dyer), pys (<pyes), diill (<diell), mill (<smiell), vihër (<vjehër), dhitë (<dhetë). Procesi i monoftongizimit të diftongjeve përfaqëson rezultatin e zhvillimit të brendshëm të sistemit fonetik të se folmes. Një tipar tjetër, lidhur me ndikimin e gjuhëve në kontakt, është alternimi f>h: hort (fort), hurrë (furrë).

Kështu që gjithë përshkrime të mëpastajme të sistemit fonologjik

të të folmeve të shqiptarëve të Ukrainës ishin bazuar mbi këto punime të lartpërmendura.

Mirëpo, siç e kemi vërejtur, nën ndikimin e një kompleks faktorësh ekstralinguistikë, brenda 40 – 50 viteve të fundit në ato të folme po zhvillohen procese të reja në të gjitha nivele të sistemit gjuhësor, duke përfshirë në rradhë të parë nivelin fonetik.

Vitet e fundit nga pala jonë gjatë studimit kompleks të fshatrave shqiptare ishte mbledhur, sistemuar dhe studiuar një sasi e madhe të materialit gjuhësor, etnografik dhe etnolinguistik. Kështu që tani sistemimi, përshkrimi dhe analizimi i materialit fonetik mbledhur nga informantët e ndryshëm në fshatra të Priazovjes gjatë një periudhe duke filluar nga viti 1998 dhe deri në kohën e tashme ka dalë përpara si detyra kryesore e studimeve tona.

Për një studim sistematik dhe të hollësishëm shkencor të të folmeve të shqiptarëve të Ukrainës kërkohet krijimi i një programi fonetik të veçantë, që do të bazohet në parime të përgjithshme të krijimit të programeve të tilla, në përvojën shkencore të autorëve të programit, veç kësaj duhet marrë parasysh veçoritë e funksionimit të sistemit fonetik e të gjithë të folmeve në kontakt.

Shpresojmë se puna jonë do ta heq “njollën e bardhë” nga harta dialektologjike shqipe dhe do të jetë kontributi ynë në punën e përbashkët mbi studimin e dialekteve shqipe.

Literaturë

Demko L.J. Albanskij govor s.Karakurt (Fonetika, morfologija imenji i glagola). Kandidatskaja dissertacija na soiskaniye uchenoj stepeni kandidata filologicheskich nauk. Leningrad. 1972.

Desnickaja A.V. Albanskij jazyk i ego dialekty. Leningrad: Nauka, 1968. C. 374 – 376.

Kotova N.V. Materialy po albanskoj dialektologiji: albanskije govory Ukrainy // Uchenyje zapiski instituta slavianovedeniya. 1956. T. 13. C. 254 – 287.

Shirokov O.S. O sootnosheniji fonologicheskoy sistemy i chastotnosti fonem. Na materiale albanskogo literaturnogo jazyka i jego bessarabskogo narechija// Voprosy jazykoznanija. 1964. № 1. C. 53 – 60.

La descrizione del sistema fonologico delle parlate degli albanesi dell'Ucraina rappresenta una grande importanza nel quadro dello studio generale dei paesi albanesi della Priazovja. Questo studio fonologico iniziò negli anni 50-60 del secolo scorso e lo troviamo negli scritti di Demko e di Kotova, in raffronto alle parlate albanesi d'Albania e di Bulgaria.

Shirokovi osserva che gli albanesi arrivarono in Bulgaria dalla zona toska sud-orientale, mentre la Desnickaja collega la parlata degli albanesi dell'Ucraina al tipo dialettale della zona nord toska nel suo stato arcaico. Come caratteristica rilevante arcaica, la Desnickaja individua la conservazione dei gruppi delle consonanti kl', gl', l'k, l'g, e la l' palatalizzata in posizione intervocale, e contemporaneamente individua la conservazione regolare del suono 'e' /«/ in sillabe non accentate. Come caratteristiche innovative la Desnickaja mette in evidenza la monoftongazione dei dittonghi ua>u, ye>y, ie>i, nonché l'alternanza f>h. Però, negli ultimi 40-50 anni, in quelle parlate si vanno sviluppando processi nuovi in tutti i livelli del sistema linguistico, compreso innanzitutto quello fonetico. Tutto il materiale da noi raccolto, nei paesi della Priazovje dal 1998 in qua, e la sua trascrizione, sistemazione e analisi, rappresenta il compito principale dei nostri studi. Per uno studio sistematico e minuzioso scientifico delle parlate degli albanesi dell'Ucraina andrebbe creato un programma fonetico particolare. Si spera che il nostro studio possa contribuire ad arricchire l'Atlante dialettologico albanese. - (Redaz.)

Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe

Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Universitë degli Studi di Napoli L'Orientale, Dipartimento di Studi dell' Europa Orientale, Napoli, Vëllimi I. 2007, Vëllimi II, 2008.

prof. dr. Bahri Beci

Universiteti "Inalco" i Parisit (Francë)

Historia e hartimit dhe botimit të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe është tetëdhjetëvjeçare, pra, ka filluar më 1929 dhe mbaron, do të thosha në mënyrë simbolike, me botimin e tij në dy vëllime, përkatësisht në vitet 2007-2008.

ADGJSH mbyll fazën e dytë të studimeve dialektologjike shqiptare të periudhës së Pasluftës.

Në periudhën e parë që shtrihet nga vitet pesëdhjetë deri në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar u bë vëzhgimi i përgjithshëm në gjerësi i veçorive të të folmeve të shqipes, përcaktimi i kufijve të përhapjes territoriale të tyre dhe përshkrimi i dukurive më pak të njohura. Në vitet shtatëdhjetë përfundoi hetimi i përgjithshëm i të folmeve pothuajse në gjithë territorin e Shqipërisë. Po në vitet shtatëdhjetë, mbi bazën e përvojës së fituar dhe, pas një pune intensive për njohjen e bazave teorike e zgjidhjeve praktike të metodës së gjeografisë gjuhësore, u hodhën bazat për fillimin e punës për hartimin ADGJSH, që shënon edhe fillimin e fazës së dytë të studimit të dialekteve të shqipes.

Në themelet e kësaj veprimtarie qëndron kontributi i profesorëve tanë të nderuar, E. Çabej e M. Domi që hartuan së bashku pyetësinorin e parë për studimin e dialekteve të gjuhës shqipe¹, kontributi i prof. S. Floqit që e çoi më tej punën e tyre përmes një pyetësinori të ri më të plotë² që shërbeu si bazë për studimin e dialekteve të shqipes për 20 vite me radhë. Përmes këtyre pyetësinorëve u përcaktuan problemet dhe materialet konkrete me interes dialektor që duheshin mbledhur, si edhe metoda që duhej zbatuar për mbledhjen dhe regjistrimin e përpunimin e tyre në monografi përshkruese diferencuese. Si vijim e përgjithësimi i kësaj përvoje njëzetvjeçare ku, përveç autorëve e bashkëpunëtorëve të atlasit, kanë dhënë kontributin e tyre edhe studiues të tjerë, u hap rruga për fillimin e punës për hartimin e ADGJSH. Në procesin e hartimit të ADGJSH tre kanë qenë momente kryesore: hartimi i kritereve, hartimi i pyetësinorit dhe grumbullimin e parashtrimin e materialeve në harta. Vlerat shkencore të kësaj vepre janë të shumta dhe të shumanshme. Ne do të ndalem në pak prej tyre.

I. Materialet e reja që sjell

ADGJSH për sa i përket materialeve që sjell do të thosha se është, ndoshta, vepër e vetme që vë në dispozicion të shkencës gjuhësore shqiptare, për sot dhe për të ardhmen, të dhëna kaq të pasura për gjuhën dialektore shqipe në një periudhë të caktuar të zhvillimit të saj.

Dhe konkretisht në ADGJSH parashtrihen të dhëna për shtrirjen e dukurive kryesore fonetike të gjuhës dialektore shqipe, si edhe të dukurive morfologjike e sintaksore dialektore. Përveç këtyre sillen të dhëna edhe për shtrirjen territoriale të 274 fjalëve me interes dialektor. Materialet e parashtruara janë mbledhur në një territor të gjerë brenda dhe jashtë kufijve të sotëm politik të Shqipërisë, në Kosovë, në Serbinë jugore (Peshter, Jablanicë, Preshevë), në Mal të zi, në Maqedoni, në Greqi (Çamëri), si edhe në diasporë (Itali, Greqi, Dalmaci).

Janë gjithsej 634 harta, 134 harta për problemet e fonetikës së gjuhës dialektore shqipe, 217 harta për problemet e morfologjisë plus 9 harta për problemet e sintaksës dhe 274 harta për problemet e leksikut.

Materialet e grumbulluara për Atlasin janë regjistruar të gjitha në magnetofon. Për pasojë është krijuar edhe fonoteka e ADGJSH që përbën një pasuri më vete materialesh dialektore me interes që duhen ruajtur e, pse jo, edhe botuar si vazhdim e konkretizim i punës së bërë për ADGJSH.

II. Metoda që është zbatuar

Lidhur me metodën e hartimit të ADGJSH dy ishin përvojat që mund të zbatoheshin, ose ajo përfundimore ose ajo lindore, pra, ose një atlas sipas modeleve të atlaseve të Francës dhe të Italisë ose një atlas sipas modeleve të atlaseve të gjuhës ruse dhe bullgare.

Atlaset e Francës dhe Italisë në thelbin e tyre ishin të tipit leksikor, kishin vetëm fjalë të veçuara. Pyetësinori i Atlasit gjuhësor të Francës kishte 2000 fjalë dhe shprehje të cilat do të ktheheshin në dialektet territoriale, kurse ai i Italisë kishte një pjesë të përgjithshme, ku përfshihej leksiku bazë (3630 fjalë) dhe një pjesë të veçantë (3324 fjalë), ku përfshiheshin koncepte a nocione të njohura nga një rreth më i gjerë folësish. Pra, në këto dy atlase vëmendja përqendrohej tërësisht në fjalë të veçanta. Dukuritë gjuhësore që kishin të bënin me sistemin fonetik, morfologjik dhe sintaksor të gjuhës nuk pasqyroheshin në harta të veçanta. Pjesa e fundit e pyetësinorit të Atlasit gjuhësor italian kishte edhe një shtojcë morfologjike.

Atlasi i gjuhës ruse, po edhe ai i gjuhës bullgar, i kushtonin kujdes të barabartë të gjitha sferave të gjuhës, fonetikës, morfologjisë sintaksës dhe leksikut. Në këto atlase, në dallim nga ai frëng dhe italian, hartografohej fenomeni gjuhësor si hallkë e plotë ose si element i sistemit gjuhësor. Në këto atlase u kushtohej kujdes i barabartë si faktit a elementit të veçuar ose individual, ashtu edhe faktit a elementit të përbashkët ose të përgjithshëm si pjesë të sistemit.

E vërteta është se atlaset e tipit të Zhilëronit ishin hartuar në periudhën e gjuhësisë parastrukturore ose jostrukturore të shekullit XIX, kurse atlasit i gjuhës ruse dhe ai i bullgarishtes, u hartuan shumë më vonë, në periudhën e gjuhësisë strukturore ose dialektologjisë moderne të shekullit XX, sipas së cilës dialekti shikohej si një sistem i veçantë i ndërlikuar që përfshin elemente që i përkasin gjuhës në tërësi, si edhe elemente të veçanta dalluese, që lidhen me territoret të veçanta.

Në pajtim me përvojën e atlaseve të rusishtes e bullgarishtes u vendos që edhe në ADGJSH të paraqiten të gjitha sferat e gjuhës dialektore shqipe, fonetika, morfologjia, sintaksa dhe leksiku.³ Në vitet 70 përmes studimit të fonetikës të së folmes së qytetit të Shkodrës,⁴ depërtuan për herë të parë tek ne metodat strukturore në studimin e gjuhës dialektore shqipe. J. Gjinarit, duke dashur të zbatojë në ADGJSH metodën strukturore që u zbatua në këtë punim dhe në dy punime të tjera pas tij, e shtriu atë edhe në pyetësinorin e ADGJSH.⁵

Në pyetësinorin e ADGJSH, ndryshe nga përvoja e deriatëhershme, pyetjet për fonetikën dhe morfologjinë nuk bëheshin për veçoritë dalluese të dialekteve të shqipes, po për veçoritë e inventarit, të sistemit dhe të funksionit të fonemave, për variantet fonetike të fonemave dhe dallimet etimologjike ose dallimet në përbërjen fonematike të fjalëve, si edhe për veçoritë

e inventarit dhe të formave gramatikore, të varianteve të morfemave, të shpërndarjes së varianteve të morfemave dhe të varianteve fonetike të mbaresave të të folmeve të gjuhës shqipe.⁶ Pra, kërkohet të zbatohet në ADGJSH metoda strukturore, ndonëse në studimet e deriatëhershme, mbi të cilat ishte mbështetur ose kishin shërbyer si bazë e pyetësorit, përjashtuar studimet për fonetikën e të folmes së Shkodrës, Rranzave të Shkodrës dhe të Elbasanit, nuk ishin të tilla. Në këto rrethana vlerësimi shkencor i shkallës dhe i mënyrës së zbatimit të metodës “strukturore”, si edhe i përfundimeve që do të mund të nxirren si rezultat i zbatimit të tyre, është një punë që do të duhet të bëhet në të ardhmen, pasi të vështrohet Atlasi më për së afërmi e të konfrontohet me realitetin e shqipes dialektore.⁷

III. Rezultatet e arritura

ADGJSH mund të vlerësohet si pasqyra më e gjerë dhe më e plotë deri tani e dialekteve të shqipes të viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar, si dokumenti më autentik i shqipes dialektore të atyre viteve që tani më është zhdukur.

Po, për mua vlera e një vepre nuk përcaktohet vetëm nga materialet që sjellë, nga metoda që zbaton, nga rezultatet që arrin, po edhe nga perspektivat që hapë.

IV. Perspektivat që hapë

a) Për studimet dialektore

ADGJSH hap perspektiva të reja në fushën e studimeve të ardhme dialektore të cilat, qofshin dialektologjike të mirëfillta, qofshin sociolinguistike, atlasin do ta kenë si pikë referimi të domosdoshme në kuptimin që do të nisen prej tij ose do t'i referohen atij për shpjegimin e zhvillimeve të mëtejshme të dukurive dialektore e sociolinguistike në etapën e sotme.

Ai di të jetë gjithashtu një mbështetje e re për studimin, përcaktimin dhe argumentimin e mëtejshëm të strukturës dialektore të shqipes.

b) Për historinë e gjuhës

Atlasi përbën një mbështetje e pikë referimi edhe për përcaktimin e historisë së strukturës dialektore të shqipes. Të dhënat e Atlasit në kombinim me të dhënat e historisë së gjuhës së shkruar, do të mund të hapin perspektiva për shpjegime e argumentime të reja në këtë fushë.

Po kështu edhe në fushën e historisë së gjuhës shqipe në përgjithësi, po edhe të fonetikës historike, morfologjisë historike dhe studimeve etimologjisë etj.

c) Për gjuhën letrare

Atlasi do të jetë edhe një bazë e mirë për studimin e mëtejshëm edhe të bazës dialektore të gjuhës letrare, po edhe një mjet i domosdoshëm për vlerësimin e zgjidhjeve normative.

Gjithsesi duhet ta themi se ADGJSH do të jetë një vepër referimi për studimet gjuhësore shqiptare në përgjithësi.

Studiuesit e ri dhe studentët kanë mundësinë që duke iu referuar kësaj vepre të ndërmarin studime të llojeve të ndryshme (referime, diploma, tema magjistrature, doktorata) në fushën e studimeve gjuhësore, po edhe jo gjuhësore. Koha do t'ja rrisë gjithnjë e më shumë vlerën kësaj vepre.

c) Për studimet krahasuese

Atlasi do të jetë vepër referimi edhe për studimet krahasuese në fushën e ballkanologjisë, po edhe më gjerë, në ato të gjuhësisë evropiane e indoevropiane.

Duke e gjykuar ADGJSH nga historia e projektimit, e realizimit dhe e vlerave të saj do të thosha se është një vepër madhore e gjuhësisë shqiptare.

Shënime

¹ M. Domi-E. Çabej, *Kuestionar dialektologjik (I. Kuestionar i përgjithshëm, II. Kuestionar i veçantë)*, Tiranë 1953, botuar pa emër autori nga M. Lamberc në *Lehrgang des Albanischen*, III, Halle, 1959, f. 53-58.

² S. Floqi, *Pyetësor për mbledhjen e materialit dialektor të gjuhës shqipe*, Dialektologjia shqiptare, I, Tiranë, 1971

³ Kjo vlerësohet në atë kohë si zbatim i metodologjisë marksiste në gjuhësi (J. Gjinari, *Kursi i dialektologjisë shqiptare*, Tiranë, 1969, f. 36; *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1975, f. 30; *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë 1988, f. 33; *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 18-19.

⁴ Shih B. Beci, *Le système vocalique et consonantique du parler de la ville de Shkodra (Albanie du Nord)*, Tome I (f. 1-392), Tome II (f. 393-670), Thèse pour le doctorat d'Université, Directeur: M. R. Gsell, Paris, 1977. *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik I së folmes së Shkodrës*, Tiranë 1995, f.79-601

⁵ *Pyetësori i Atlasit Dialektologjik të Gjuhës Shqipe, fonetikë, morfologji, sintaksë, leksik*, hartues: J. Gjinari (drejtues) fonetikë, morfologji, redaktim i përgjithshëm, Gj. Shkurtaj, leksik, Xh. Gosturani, sintaksë Tiranë, 1979, botuar në Dialektologjia shqiptare; Tiranë, 1990, f. 523-558. Shih edhe J. Gjinari (drejtues).

⁶ J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, Xh. Gosturani, *Pyetësori (Fonetikë, Morfologji, Sintaksë, Leksik)*, Atlasi Dialektologjik i Gjuhës shqipe, V. I., Napoli 2007, f.438-463.

⁷ B. Beci, *Rreth inventarit të fonemave zanore të gegërishtes*, Hylli i Dritës, Shkodër, 2007, Nr. 4, f. 20-36; Giovanni Belluscio, *Nuovi materiali per la fonetica della parlata ghega di Vermosh (Albania settentrionale) confrontati con i dati dell'Atlante dialettologico della lingua albanese (ADGJSH)*, botuar në librin Nordalbanien-L'Albania del Nord, Hamburg, 2009, f. 21-34.

La storia della compilazione e pubblicazione dell'Atlante Dialettologico della lingua albanese iniziò nel 1929, e chiuse la seconda fase degli studi dialettologici albanesi del periodo del dopoguerra. Negli anni 50-70 si ricercarono le peculiarità delle parlate albanesi, la definizione delle loro confini territoriali, la descrizione dei fenomeni meno conosciuti. Negli anni '70 si concluse l'indagine generale in tutto il territorio d'Albania, e si gettarono le basi per l'inizio della compilazione dell'Atlante, cioè l'inizio della seconda fase dello studio dei dialetti albanesi. Fondamentali restano, in questo studio, i contributi dei proff. Çabej e Domi, che compilarono insieme il primo Questionario per lo studio dei dialetti della lingua albanese. Per 20 anni il Questionario servì come base per lo studio succitato, a cui, oltre agli autori e collaboratori, contribuirono tanti altri studiosi. L'Atlante, per i materiali che contiene, forse è l'unica opera che fornisce dati così ricchi per la lingua dialettale albanese. Vengono presentati dati su fenomeni fonetici, morfologici e sintattici dialettali, dati su 274 parole di interesse dialettale. Materiali raccolti in Albania, Kosova, Serbia meridionale, Montenegro, Macedonia, Grecia e nella diaspora (Italia, Grecia e Dalmazia). 634 carte: 134 per i problemi fonetici, 217 per quelli morfologici, 9 per quelli sintattici, 274 per i problemi del lessico. Materiali tutti registrati su nastro. Sul metodo della compilazione, due erano le esperienze che potevano essere applicate: o di tipo occidentale o orientale. Si studiarono gli Atlanti della Francia e dell'Italia. Qui l'attenzione si concentrava tutta sulle parole peculiari; e le particolarità linguistiche che avevano a che fare con il sistema fonetico, morfologico e sintattico della lingua non venivano rispecchiate in carte particolari. L'Atlante della lingua russa, come quello bulgaro, invece, dedicavano interesse uguale a tutte le sfere della lingua: fonetica, morfologia, sintassi e lessico. In effetti gli Atlanti occidentali erano stati compilati nel periodo della linguistica prestrutturale del sec.XIX, mentre quelli orientali erano molto posteriori, del periodo strutturale o della dialettologia moderna del sec.XX. Si decise quindi di seguire

Integrimi kishtar i emigrantëve shqiptarë në Itali

don Paskuale Ferraro

arbëresh ka Ferma (Cs)

koordinator kombëtar i baritorisë për shqiptarët në Itali

Në raste të ndryshme, është analizuar procesi i integrimit të emigrantëve shqiptarë në Itali e nga përfundimet e konferencave të fundit të Fondazione Migrantes të Konferencës Ispeshkvnore Italiane kanë dalë disa risi pozitive e, për shumë aspekte, edhe ngushëlluese për punën e përkushtimin e shumë veprimtarëve baritorë në bashkësitë e ndryshme etnike të pranishme në Itali. Përsa i përket etnisë shqiptare, risitë kanë të bëjnë, së pari, me shërbimin e rregullt liturgjik në gjuhën shqipe, në të cilin marrin pjesë grupe të rinjsh e familje të reja të sapoformuara, saqë tashmë azhurnohen në mënyrë të rregullt regjistrat për sakramentet e fillimit të jetës së krishterë dhe për martesat; praktikisht, sot, mund të themi se mund ta ndjekim nga afër familjen shqiptare, që formohet e zgjerohet, si edhe rrënjësohet në indin shoqëror të vendit pritës. Por, të dhënat e para statistikore na ftojnë të reflektojmë mbi një aspekt baritor më radikal e më të

rëndësishëm, i cili, në fillim të punës sonë, rreth tetë vjet më parë, na pati shqetësuar shumë, mbi mundësinë e mbushjes efektive të boshllëkut kulturorofetar që kishte lënë regjimi i egër komunist. Përkatësia fetare e deklaruar fillimisht nga secili, vetëm sepse i asaj feje ishte një familjar i largët, sot deklarohet si personale, pasi, brenda bashkësitë të lindura në Itali, është bërë me maturi një përzgjedhje, që ka rrjedhur e është mbështetur nga kurse të rregullta katekizmi e nga propozime konkrete për ta jetuar fenë. Me të vërtetë, edhe këtë vit, vërejmë me entuziazëm një grup prej dymbëdhjetë vetash, të cilët, në kishën e shën Gjonit të Malvës në Trastevere, që i është caktuar bashkësisë shqiptare nga sakramentet e fillimit të jetës së krishterë. E njëjta gjë ndodh në gati të gjitha bashkësitë e emigrantëve shqiptarë të pranishme në Itali, duke e bërë kështu natën e Pashkëve edhe më të gëzueshme e

të pasur me elementin e krishterë të shpësës, që duhet të shoqërojë gjithnjë çdo besimtar, e aq më shumë emigrantin, i cili duhet të jetë gjithnjë gati për t'u konfrontuar e për të vlerësuar para të tjerëve identitetin e vet kulturor. Shpesh është diskutuar mbi identitetin kulturor në dhe të huaj, mbi vështirësitë që janë hasur sa herë personat janë deklaruar shqiptarë, pasi paragjykime të pamotivuar e kishin pështjelluar e bërë të vështirë integrimin edhe në vendin e punës. Sot, këto paragjykime janë kapërcyer pak a shumë e në shumë raste, janë shndërruar në lavdërimë për ta, aq sa në shumë vende ata duhen e falenderohen. Krenaria dhe shpresa pra, zgjedhohen së bashku me foljen "integroji", aq sa ta bëjnë bartëse të një limfe të re jetësore në Kishën italiane, e cila, në dëshmimin e Krishtit të ngjallur, është gjithnjë gati t'i hapë dyert dhe t'i presë të huajt si vëllezër.

Dalle conclusioni delle ultime conferenze della Fondazione Migrantes della Conferenza Episcopale Italiana, sono emerse alcune novità positive. Per quanto riguarda l'etnia albanese, c'è da segnalare il regolare servizio liturgico in lingua albanese, a cui prendono parte gruppi di giovani e famiglie appena formate, e vengono regolarmente registrati i sacramenti dell'inizio della vita cristiana e dei matrimoni. Insomma, possiamo seguire da vicino la famiglia albanese, che si forma e si allarga e mette radici nella realtà italiana. Ma i dati statistici ci devono far riflettere su un aspetto pastorale più radicale e importante, che otto anni fa, all'inizio del nostro lavoro, ci aveva molto preoccupato: sulla possibilità di riempire il vuoto culturale-religioso che aveva lasciato il feroce regime comunista. L'appartenenza religiosa dichiarata in principio da ciascuno, giusto perché a quella fede apparteneva un parente lontano, oggi è diventata personale: perché maturata da una scelta sostenuta da corsi regolari di catechismo e proposte concrete di fede vissuta. Quest'anno c'è un gruppo di 12 persone, che, nella Chiesa di San Giovanni della Malva, in Trastevere, si preparano a ricevere i primi sacramenti della vita cristiana. La stessa cosa avviene in tutte le comunità degli emigranti albanesi presenti in Italia, rendendo così la notte di Pasqua ancora più gioiosa e ricca dell'elemento cristiano della speranza, che deve sempre seguire ogni credente, e maggiormente l'emigrante, il quale dev'essere sempre pronto a confrontarsi con gli altri e valorizzare la propria identità culturale. Fino a poco tempo era difficile dichiararsi albanesi, perché vecchi preconcetti immotivati avevano reso difficile la loro integrazione nel mondo del lavoro. Oggi questi preconcetti sono quasi un ricordo, e anzi si sono tramutati in lodi. Orgoglio e speranza si coniugano insieme alla parola "integrazione": portatori di una nuova linfa di vita nella Chiesa Italiana. (Redaz.)

Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe

(vjen ka faqja 29)

l'esempio degli atlanti russo e bulgaro. Negli anni '70 per la prima volta venivano applicati in Albania i metodi strutturali nello studio della lingua dialettale albanese. Nel Questionario dell'Atlante, a differenza del passato, le domande per la fonetica e morfologia non si facevano sulle particolarità distintive dei dialetti albanesi, ma sulle particolarità dell'inventario, del sistema o della funzione dei fonemi. L'Atlante si può valutare come lo specchio più ampio e più completo dei dialetti albanesi, fino agli anni '70 del sec.XX; come il documento più autentico dell'albanese dialettale. Ma, secondo me, il valore di un'opera non si determina solo dai materiali che presenta o dal metodo che applica e dai risultati che raggiunge, ma anche dalle prospettive che apre. L'Atlante apre prospettive nuove nel campo degli studi futuri dialettali, che lo avranno come punto di riferimento: da lì partiranno. Sarà un nuovo sostegno per lo studio, la definizione e l'argomentazione ulteriore della struttura dialettale della lingua albanese. L'Atlante costituisce un sostegno e punto di riferimento per la determinazione della storia della struttura dialettale della lingua albanese. E nel campo della storia della lingua albanese in generale. L'Atlante sarà anche un mezzo indispensabile per la valorizzazione delle scelte normative della lingua letteraria. Sarà un'opera di riferimento per gli studi linguistici albanesi in generale. I giovani studiosi e gli studenti potranno fare riferimento a quest'opera per i loro diplomi, temi di magistratura e dottorati. Il tempo accrescerà il valore di quest'opera. L'Atlante sarà anche opera di riferimento per gli studi comparativi nel campo della balcanologia, ma anche in quelli della linguistica europea e indoeuropea. Per me l'Atlante è un'opera grandiosa della linguistica albanese. (Redaz.)

La contestata Dottrina Altimariana

Në s'pari, duami të ju thomi se, në dushim se jo gjithë atë që djavasnjanzgledhënjanz ket artikull din të a bënjan mbë gluh arbëreshe, edhë ndë na dishpëlqen, kimi të a shkruami mbë tallian.

Dobbiamo premettere che, quando per motivi culturali, si contrappongano diversi teoremi, chi è chiamato in causa dovrebbe avere capacità di argomentazione che vada ad invalidare il teorema avverso! Bisognerebbe che questi fosse in possesso di argomenti per la civile dialettica e non abbandonarsi all'azione violenta e/o intimidatoria. Quanto fin qui detto, vale in special modo per chi, ricoprendo incarichi culturali di docenza, dovrebbe essere avvezzo al dibattito ed in possesso degli strumenti necessari: altrimenti, questi risulterebbe perdente in partenza!

Stimati signori, cultori arbëreshë, ritenendo che l'argomento trattato in queste righe siano di Vostra pertinenza, in quanto, a diverso titolo, coinvolti con l'argomento lingua arbëreshe e la relativa minoranza, Vi informiamo su quanto segue e, coerentemente con il tema, al fine di creare il dibattito, Vi chiediamo di esprimervi al proposito.

Potrete inviare i vostri documenti per la discussione a: jetarbreshe@libero.it - info@vatrarberesh.it - oppure a: "Vatra Arbëreshe" C. P. 182, 10023 Chieri (TO).

Come molti di Voi sapranno, l'Associazione Culturale di Minoranza Linguistica "Vatra Arbëreshe" di Chieri (TO), dall'anno 2000 è attiva ed opera per la tutela dell'identità, cultura e lingua arbëreshe. Alla realizzazione degli scopi anzidetti sono state indirizzate tutte le nostre attività associative ed i finanziamenti per esse ottenuti dalle varie istituzioni del Piemonte: con larghezze di vedute, negli anni, abbiamo ottenuto contributi da Istituzioni che arbëreshe non sono, per destinarli, con il Concorso Nazionale di Poesia in lingua Arbëreshe "Principe Giorgio Castriota Skanderbeg" ed altre attività culturali, agli Arbëreshë del centro e sud Italia:

Per altre notizie inerenti a "Vatra Arbëreshe", sul Sito: www.vatrarberesh.it

In relazione a quanto espresso nel titolo,

in comunanza con gli indirizzi culturali perseguiti, al fine di creare l'interesse ed aprire la discussione, l'Associazione "Vatra Arbëreshe" di Chieri si è anche espressa sul versante linguistico: il tema linguistico ed il suo insegnamento, come anche l'interpretazione più corretta da applicare sulla L. 482/99, sono tra i problemi della nostra minoranza più sentiti dai soci di "Vatra Arbëreshe" il cui Direttivo è composto da arbëreshë originari dei vari paesi autoctoni. Concordemente con quanto appena detto, non condividendo l'interpretazione della L. 482/99 espressa dal prof. F. Altimari (cfr. Altimari in "L'eteroglossia arbëreshe" - interventi su Arbatia 2006) e le prese di posizione palesate dallo stesso sull'insegnamento della lingua nelle scuole della nostra minoranza, nel mese di giugno 2007, la nostra Associazione elaborava uno studio sull'interpretazione più adeguata da adottare per la L. 482/99 (cfr. "Lo standard d'Albania: lingua madre o lingua figlia?").

Nel detto studio, mettendo in luce l'esistenza dell'incongruenza consistente dalla mancanza di contraddittorio, per cui, ad un solo docente - nel caso l'Altimari - è, di fatto, consentito dettare legge a riguardo delle tematiche arbëreshe, potendosi ravvisare in tutto ciò, un'ipotesi di comportamento oligarchico, si ipotizzava l'incoerenza delle posizioni personalistiche espresse dal prof. Altimari.

Forse, con eccessiva enfasi "patriottica", nel nostro documento si descriveva il prof. Altimari come succube della personalità hoxhana e dei dettami linguistici provenienti da oltre Adriatico; si provava inoltre come gli scritti dell'Altimari denotassero una scarsa conoscenza della lingua arbëreshe. Tutto ciò, con l'unico intento di evidenziare l'infondatezza delle posizioni altimariane, indirizzate all'introduzione dell'albanese standard (lo shqipo) nelle scuole arbëreshë d'Italia.

Il prof. Altimari, in dispregio alla volontà dello stesso Legislatore, dà per scontato l'introduzione dell'albanese standard. Di questo è così certo che, nel suo documento, si permette di ridicolizzare qualsiasi tentativo di standardizzazione

dell'arbërisht: in questo caso, da lui è stato preso ad esempio negativo il pregevole tentativo di standardizzazione realizzato dall'A.I.A.D.I. (cfr. "ALFABETIZZAZIONE ARBËRESHE" - Edizioni il Capitello, Torino 2001.

Noi di "Vatra Arbëreshe, dal prof. Altimari e dalla sua consapevolezza sulle tematiche linguistiche, ci aspettavamo quelle quattro parole che - dette a chi si ritiene non edotto in materia - ci facessero arrossire per l'ardire dimostrato. Contrariamente alle aspettative, deludendoci, il prof. Altimari ha preferito fare l'offeso: ha querelato, per delle parole ritenute offensive, il Prof. Agostino Giordano, Direttore di "Jeta Arbëreshe" (che, per l'editoriale del n° 54, riprendeva una sintesi del nostro studio) e, conseguentemente, l'Associazione "Vatra Arbëreshe", rea di aver contestato le direttive altimariane.

Il prof. Altimari ha deluso: come docente non ha saputo contrapporre una tesi che invalidasse lo studio da noi espresso. Riteniamo che le posizioni assunte dal prof. Altimari: 1) tendano ad essere intimidatorie verso chiunque interferisca con i suoi dettami (cfr. Altimari in "L'eteroglossia arbëreshe" - interventi su Arbatia 2006), 2) presentino un rifiuto al confronto con altre posizioni, rifiuto al dialogo che non sarà di alcun aiuto per ciò che ancora resta dell'Arbëria e degli Arbëreshë!

Per quanto sopra, ritenendoVi, come detto ad inizio di articolo, a vario titolo interessati al problema minoranza e lingua arbëreshe, Vi chiediamo di esprimerVi su quanto suddetto, inviando le vostre relazioni a:

jetarbreshe@libero.it
info@vatrarberesh.it

oppure a:

"Vatra Arbëreshe"

C. P. 182, 10023 Chieri (TO).

Auspiciando da tutti Voi una presa di posizione, ci rendiamo disponibili al confronto.

Ju përshëndesmi nga zëmra, rrimi mir e pafshit shëndet ndë fëmil.

per l'Associazione "Vatra Arbëreshe"

Il Presidente

Prof. Vincenzo Cucci

Bruni Pierfranco, *La Puglia Arbëreshe, grecanica, franco-provenzale* – Beni Culturali tra minoranze linguistiche ed eredità etniche -, Centro Studi e Ricerche Francesco Grisi, Tiemme srl., Manduria (Ta) 2009

Ky është i sprasmi libër - si ngaherë shumë interesant - i P. Brunit mbi Pakicat Italiane, i shkruar bashkë me të bilën Micol; një libër që flet për tre Pakicat e Pules: Arbëreshët, Grekrat e Franko-Provençalët. Mbi Arbëreshët gjëni këta shkrime: *Dall'Arbëria alla cultura del Mediterraneo* (P. Bruni), *L'eredità arbëreshe nel Tarantino* (A.Giordano) e *Le realtà italo-albanesi della provincia di Foggia* (M. Bruni).

Meyer Gustav, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Botime Çabej, Tirana, 2007.

Me përkthimin e Anila Omarit, botohet shqip në kollanën "Excipere", të drejtuar nga Ledi Shamku, "Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe", të botuar të parën herë gjermanisht në 1891, në Strassburg. Ky fjalor intereson edhe arbëreshët pse përmban shumë fjalë që shpjegohen me arbërishten, dhe citohen shpesh fjalë të të folmeve arbëreshe. Njo një shembull: folja "digjonj" ndë katundin Greçi thuhet "dëlgonj"; ndë Kundisë: "glegonj"; ndë Barile: "dilëgonj"; ndë Palac Adriani: "ndlëgonj".

Dado Floresha, *Intuite dhe vetedije kritike*, Onufri, Tirana 2006

Ky libër i Floresha Dados mirret me kritikën letrare dhe flet, tek e para pjesë, për teorinë e kritikës, dhe te pjesa e dytë për autorët dhe veprat e tyre. Te një pjesë që ka titullin "Nga letërsia e traditës" ka katër tema që interesojnë letërsinë arbëreshe: 1) "Letërsia arbëreshe dhe horizonti i pritjes në kulturën shqiptare", 2) "De Rada midis poezisë dhe teorisë letrare", 3) Nivelet e metodës studimore të M. Markianoit në veprën "Shqipëria dhe vepra e De Radës", 4) "Takimi i studiuesit Matteo Mandala me krijimtarinë komplekse të Giuseppe Skiroit".

Matzinger Joachim, *Der Altalbanische Text Mbsuame e Krështerë (Dottrina cristiana) des Lekë Matrënga von 1592*, J.H. Röhl, 2006.

Ky studim i Matzingerit merr parasysht gjuhën e Lukë Matrëngës, një shkrimtar arbëresh nga Hora e Arbëreshëve, që botoi ndë vitin 1592 Katekizmin "E mbësua e Krishterë", përkthim i tekstit të Ledesmës ndë të folmen e Horës. Matzingeri përshkruan gjithë

elementet kryesorë të fonologjisë, të morfologjisë dhe të leksikut.

Di Miceli Maria Francesca (a cura di), *Costumi nostri o sia le antichità di Palazzo Adriano. Memorie di Andrea Dara*, Mirror, Palermo 2007

Autorja, profesoreshe e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Palermit, paraqet një vepër të pabotuar të Andrea Darës, e cila flet për katundin arbëresh Palac Adrianin. Dorëshkrimi i vepërës gjendet ndë Bibliotekën Kombëtare të Kopenagenit, ku shumë libra dhe dorëshkrime i ka sjellë Zef Gangale që nga vitet '50 e njëra te vitet '70. Kjo vepër paraqet mësimë traditat kulturore të Palac Adrianit: ritin, gjuhën, veshjet, martesën, lindjen, vdekjen, Krishtlindjen, Kreshmen, Pashkën etj.

Berisha Anton Nikë, *Njëmendësia e fjalëve - Mundësi interpretimesh letrare*, Shpresa e Faik Konica, Prishtinë 2006

Berisha ka vjet mirret me letërsinë arbëreshe dhe te ky libër na flet për disa argumente shumë interesantë: 1) Mbi parimin krijues poetik të De Radës, 2) Rreth poezisë së Nikollë Ketës, 3) Për "Neomenia" të F. A. Santorit, 4) Për "Harpa arbnore" të Atë Lleonard De Martinit, 5) Mbi krijimtarinë poetike të Zef Skiroit, 6) Mbi poetin Zef Serembe përballë poetëve të tjerë arbëreshë.

Paternoster Renato, *L'arbëresh e l'italiano a Barile - Il patrimonio lessicale*, EdiMaior, Venosa 2008

Është një libërth me 35 faqe, me të shquarit e një albumi fotografish, po tërheq vëmendjen e lektorit pse jep etimologjinë e dica fjalëve, ture u lidhur me latinishten, me greqishten, me sanskritishten, me gotishten, me celtishten etj. Fjalët që autori merr parasysht janë ato më të vjetra: bukë, dorë, fjalë, gjarpër, gluhë, kal, klicë, klumësh, motër, shpi etj.

AA.VV., *Studime për Autorë të ndaluar*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2008.

Është një vëllim shumë interesant pse përmban studime për disa autorë që, gjatë kohës së komunizmit, ndë Shqipëri qenë të ndaluar, për arsye politike. Autorët që gjenden ndë këtë libër janë: Gj. Fishta, F. Konica, E. Koliqi, Zef Skiroi, M. Kuteli, M. Camaj. Klara Kodra ka studiuar veprën e autorit arbëresh Zef Skiroit, i parë nga pikëpamja e poetikës. Ajo pohon se, njëra sot, gjithë ata që kanë shkruar për

këtë autor (R. Qosja, M. Mandala, A. Xhiku) kanë përballuar problemet e mesazhit të veprave dhe jo formën.

Oriente Cristiano, *Indici Quarantennali (1961-2000)*, rivista trimestrale dell'Associazione Culturale Italiana per l'Oriente Cristiano, Palermo 2008

Rivista e famshme që u botua ndë Siçillje paraqet me këtë vëllimth përbajtjen e 40 vjetëve, që nga viti 1961 e njëra te viti 2000. Parëhënien e bëri Imzot E. Fortino, i cili flet për artikujt që qenë kushtuar Konçilit Vatikan II dhe Qishës Orientale, ortodokse dhe katolike; pra për artikujt të kushtuar lidhjeve ndër katolikët dhe ortodoksët, ekumenizmit dhe, në fund, Qishës Arbëreshe.

Vicchio Filomena, *Dall' "Omnibus" all' "Albanese d'Italia"*, in "Studi sull'Oriente Cristiano", Accademia Angelica-Costantiniana di Lettere Arti e Scienze, Roma, 12/2008, pp. 119-152

Ky numër i rivistës "Studi sull'Oriente Cristiano", të botuar nga G. Passarelli, ka një studim të Filomena Vicchio që flet për rivistën e parë të drejtuar nga një arbëresh (Vincenzo Torelli nga Barilli), "Omnibus". Pra studiuesja zbuloi dica numra të rivistës të drejtuar nga De Rada - "L'Albanese d'Italia" - e për të cilën na flet këtu për herën e parë. Kjo Rivistë pati një jetë të shkurtur, që nga fjavari i vitit 1848 njëra te theristiu i të njëjtit vit.

Stratigò Anna, *Luleborë (Bucaneve)*, Canti d'Arbëria e d'Albania, in "Amadeus", Gennaio 2009

Suplementi i n. 12/08 (Janar 2009) i rivistës muzikore "Amadeus" është i kushtuar Arbëreshëve dhe ka një CD me tetë këngë, dica arbëreshe e dica shqiptare. I këndon Anna Stratigò, arbëreshe nga Ungra, e shoqëruar nga grupi muzikor "Luleborë Ansamble". Është një eksperiment interesant pse interpreton, me xhec-in, ritmet e muzikës arbereshe dhe shqiptare. Një shënim: këngën "Luleborë" libërthi, që shoqëron CD-në, thotë se e ka kompozuar autori shqiptar Simon Gjoni, bashkë me P. Gallina, F. Pallone dhe G. Sergi.

Sulça Nijazi, *De Rada - pinjoll arbëresh - poezi* - Ankara 2008

Autori - shtatëdhjetëvjeçar që u lind në Pejë (Kosovë) dhe rron në Ankara (Turqi) - ka shkruar dhjetra e dhjetra libre: romane, vjersha, tregime, novela, drama e poema, e do shumë mirë Arbëreshët. Këtë libër ja kushton De Radës: 28 poezi, që krahasojnë tërë jetën e tij, që ka lindja njëra te vdekja.